

**KODI PENAL**  
**I**  
**REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**Miratuar me ligjin nr.7895, datë 27.1.1995**

**Ndryshuar me ligjin nr.144/2013, datë 2.5.2013**

*Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare*

**2013**

**CIP Katalogimi në botim BK Tiranë**

Kodi penal: i përditësuar.-Tiranë:  
Qendra e Botimeve Zyrtare, 2013  
...f, ...cm.

ISBN 978-9928-01-030-8

## PËRMBAJTJA

### **PJESA E PËRGJITHSHME**

#### **KREU I**

Ligji penal dhe zbatimi i tij..... 1-11 9

#### **KREU II**

Përgjegjësia penale ..... 12-21 20

#### **KREU III**

Tentativa ..... 22-24 23

#### **KREU IV**

Bashkëpunimi i personave për kryerjen e veprës penale ..... 25-28 24

#### **KREU V**

Dënimet ..... 29-46 27

#### **KREU VI**

Caktimi i dënimit ..... 47-57 38

#### **KREU VII**

Alternativat e dënimit me burgim ..... 58-65 43

#### **KREU VIII**

Shuarja e ndjekjes penale, të dënimeve dhe mosekzekutimi  
i tyre..... 66-72 50

### **PJESA E POSAÇME**

#### **KREU I**

Krime kundër njerëzimit ..... 73-75 57

#### **KREU II**

Vepra penale kundër personit

Krime kundër jetës..... 76-133 59

#### **SEKSIONI I**

Krime kundër jetës të kryera me dashje..... 76-84 59

#### **SEKSIONI II**

Krime kundër jetës shkaktuar me pakujdesi ..... 85 62

#### **SEKSIONI III**

Veprat penale të kryera me dashje

kundër shëndetit..... 86-90 63

#### **SEKSIONI IV**

Vepra penale kundër shëndetit të kryera nga pakujdesia..... 91-92 66

#### **SEKSIONI V**

Vepra penale që rrezikojnë jetën dhe shëndetin nga

ndërprerja e shtatzanisë ose mosdhënia e ndihmës.....	93-99	66	
<b>SEKSIONI VI</b>			
Krime seksuale .....	100-108	69	
<b>SEKSIONI VII</b>			
Vepra penale kundër lirisë së personit .....	109-112		73
<b>SEKSIONI VIII</b>			
Vepra penale kundër moralit dhe dinjitetit .....	113-123	77	
<b>SEKSIONI IX</b>			
Vepra penale kundër fëmijëve, martesës dhe familjes.....	124-130	83	
<b>SEKSIONI X</b>			
Vepra penale kundër lirisë së besimit .....	131-133	88	
<b>KREU III</b>			
Vepra penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike .....	134-200	89	
<b>SEKSIONI I</b>			
Vjedhja e pasurisë.....	134-142	89	
<b>SEKSIONI II</b>			
Mashtrimet.....	143-149	95	
<b>SEKSIONI III</b>			
Shkatërrimi i pronës.....	150-162	102	
<b>SEKSIONI IV</b>			
Vepra penale të kryera në shoqëritë tregtare.....	163-170/b	106	
<b>SEKSIONI V</b>			
Krime në fushën e doganave.....	171-179/a	111	
<b>SEKSIONI VI</b>			
Veprat penale në lidhje me taksat dhe tatimet .....	180-182	117	
<b>SEKSIONI VII</b>			
Falsifikimi i monedhave dhe letrave me vlerë.....	183-185	118	
<b>SEKSIONI VIII</b>			
Falsifikimi i dokumenteve .....	186-192/b	119	
<b>SEKSIONI IX</b>			
Vepra penale në fushën e falimentimit .....	193-196	124	
<b>SEKSIONI X</b>			
Zhvillimi i palejuar i lojërave të fatit.....	197-198	125	
<b>SEKSIONI XI</b>			
Vepra penale që cenojnë regjimin juridik të tokës.....	199-200	126	
<b>KREU IV</b>			
Vepra penale kundër mjedisit .....	201-207	127	
<b>KREU V</b>			
Krime kundër pavarësisë dhe rendit kushtetues.....	208-225	131	
<b>SEKSIONI I</b>			
Krime kundër pavarësisë dhe integritetit .....	208-218	131	
<b>SEKSIONI II</b>			
Krime kundër rendit kushtetues.....	219-225	134	

<b>KREU VI</b>		
Krime që cenojnë marrdhëniet me shtetet e tjera.....	226-229	136
<b>KREU VII</b>		
Aktet terroriste.....	230-234/b	137
<b>KREU VIII</b>		
Krime kundër autoritetit të shtetit.....	235-299	146
<b>SEKSIONI I</b>		
Vepra penale kundër veprimtarisë shtetërore të kryera nga shtetasit .....	235-247	146
<b>SEKSIONI II</b>		
Vepra penale kundër veprimtarisë shtetërore të kryera nga punonjësit shtetërorë ose në shërbim publik .....	248-260	152
<b>SEKSIONI III</b>		
Vepra penale kundër rendit dhe sigurisë publike.....	261-293	158
<b>SEKSIONI IV</b>		
Vepra penale kundër sekretit dhe kufijve shtetërorë.....	294-299	179
<b>KREU IX</b>		
Vepra penale kundër drejtësisë.....	300-324	183
<b>KREU X</b>		
Vepra penale që prekin zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve.....	325-332	197
<b>KREU XI</b>		
Vepra penale të kryera nga banda e armatosur dhe organizata kriminale.....	333-335	202

**LIGJ**  
**Nr.7895, datë 27.1.1995**

**KODI PENAL I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**  
*(I përditësuar)*

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, me propozim të Këshillit të Ministrave

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

**I**  
**PJESA E PËRGJITHSHME**

**KREU I**  
**LIGJI PENAL DHE ZBATIMI I TIJ**

**Neni 1**

**Ligji penal dhe ndarja e veprave penale**

Ligji penal përcakton veprat penale, dënimet dhe masat e tjera që merren ndaj autorëve të tyre.

Veprat penale ndahen në krime dhe në kundërvajtje penale. Dallimi i tyre bëhet në çdo rast në dispozitat e pjesës së posaçme të këtij Kodi.

**Neni 1/a**

**Bazat e legjislacionit penal**

*(Shtuar me ligjin nr.8733, datë 24.1.2001, neni 1)*

Kodi Penal bazohet në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, në parimet e përgjithshme të së drejtës penale ndërkombëtare, si dhe në marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara nga shteti shqiptar.

Legjislacioni penal përbëhet nga ky Kod dhe ligje të tjera që parashikojnë vepra penale.

**Neni 1/b**

**Detyrat e legjislacionit penal**

*(Shtuar me ligjin nr.8733, datë 24.1.2001, neni 1)*

Legjislacioni penal i Republikës së Shqipërisë ka për detyrë të mbrojë pavarësinë e shtetit dhe tërësinë e territorit të tij, dinjitetin e njeriut, të drejtat dhe liritë e tij, rendin kushtetues, pronën, mjedisin, bashkëjetesën dhe mirëkuptimin e shqiptarëve me pakicat kombëtare, si dhe bashkëjetesën fetare nga veprat penale, si dhe parandalimin e tyre.

Neni 1/c

**Parimet e Kodit Penal**

*(Shtuar me ligjin 8733, datë 24.1.2001, neni 1)*

*(Shtuar me ligjin 144/2013, datë 2.5.2013, neni 1)*

Kodi Penal bazohet në parimet kushtetuese të shtetit të së drejtës, të barazisë përpara ligjit, të drejtësisë në caktimin e fajësisë dhe të dënimit, të mbrojtjes së interesit më të lartë të fëmijëve, si dhe të humanizmit.

Zbatimi i ligjit penal me analogji nuk lejohet.

Neni 2

**Mosdënimi pa ligj**

Askush nuk mund të dënohet penalisht për një veprë që më parë nuk është e parashikuar shprehimisht në ligj si krim ose kundërvajtje penale.

Askush nuk mund të dënohet me një lloj dhe masë dënimi të paparashikuar në ligj.

Neni 3

**Veprimi në kohë i ligjit penal**

Askush nuk mund të dënohet për një veprë që, sipas ligjit të kohës kur është kryer, nuk përbënte veprë penale.

Ligji i ri që nuk dënon veprën penale ka fuqi prapavepruese. Në rast se personi është dënuar, ekzekutimi i dënimit nuk mund të fillojë dhe, në qoftë se ka filluar, pushon.

Kur ligji i kohës kur është kryer vepra penale dhe ligji i mëvonshëm janë të ndryshëm, zbatohet ai ligj dispozitat e të cilit janë më të favorshme për personin që ka kryer veprën penale.

---

**Vendim i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë nr.4,  
datë 27.3.2003**

*Nisur nga fakti që ligjvënësi shqiptar në një dispozitë të vetme, sikurse është ajo e nenit 3 të Kodit Penal, ka përcaktuar veprimin e ligjit penal në kohë, jo vetëm në përgjithësi, sipas parimit që askush nuk mund të dënohet për një veprë që sipas ligjit të kohës kur është kryer, nuk përbënte veprë penale, por edhe duke dhënë përjashtimet nga ky parim, Kolegjet e Bashkuara çmojnë se lidhje me çështjen objekt shqyrtimi, ka përmbajtja e paragrafëve të dytë dhe të tretë të kësaj dispozite, në të cilat parashikohen*

*përbashkëtimet nga rregulli i përgjithshëm i veprimit në kohë të ligjit penal dhe brenda tyre, lidhje më të drejtpërdrejtë me këtë çështje, pa dyshim, që ka paragrafi i tretë i saj.*

*Nga përmbajtja e këtij paragrafi, sipas të cilit, kur ligji i kohës kur është kryer vepra penale dhe ligji i mëvonshëm janë të ndryshëm, zbatohet ai ligj, dispozitat e të cilit janë më të favorshme për personin që ka kryer veprën penale, arrihet në përfundimin se, në rastet kur, ligji që ka qenë në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale, është më i disfavorshëm se ligji që është në fuqi në kohën e gjykimit të çështjes penale në ngarkim të personit që e ka kryer atë, gjykatat detyrohen të zbatojnë këtë të dytin d.m.th. ligjin e mëvonshëm, i cili është në fuqi në kohën e gjykimit të çështjes.*

*Ky detyrim rrjedh nga fakti që, në rastin konkret, ligji i mëvonshëm përmban dispozita, të cilat janë më të favorshme për personin që ka kryer veprën penale ose, duke përdorur terminologjinë kushtetuese, duhet thënë se ligji i mëvonshëm është ligj penal favorizues dhe pikërisht për këtë arsye, ai ka fuqi prapavepruese.*

*Megjithatë, duhet vënë në dukje fakti që fuqia prapavepruese e ligjit penal favorizues, në raport me momentin kohor të zbatimit të tij, nuk është e pakufizuar, pasi ky moment është i kushtëzuar nga faza në të cilën gjendet procedimi penal, që i përket personit të akuzuar për kryerjen e veprës penale, fazë e cila, duke u bazuar në sa u thanë me hollësi më lart, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, arrijnë në përfundimin se nuk mund të jetë tej momentit kohor kur vendimi i dënimit penal të personit të akuzuar, ka marrë formë të prerë, gjë që vlen edhe për personat e dënuar me vendim penal të formës së prerë të gjykatave të huaja penale, sikurse është rasti objekt gjykimi.*

*Të gjitha çështjet e tjera, që mund të lindin pas këtij momenti, i përkasin një faze tjetër, asaj të ekzekutimit të vendimit penal.*

*Dihet se ndryshe nga fuqia prapavepruese e ligjit penal, që përfshihet në institutin e veprimit penal në kohë, institut, i cili rregullimin e tij ligjor e gjen në normat e ligjit penal material, faza e ekzekutimit të vendimeve penale rregullohet nga normat e ligjit procedural penal, nocione këto që konfondohen në kërkesën e paraqitur nga mbrojtësi i kërkuarit Juan.*

*Bazuar në sa u parashtrua me hollësi në pjesët e përparshme të këtij vendimi, Kolegjet e Bashkuara arrijnë në përfundimin e përgjithshëm se paragrafi i tretë i nenit 3 të Kodit Penal është i zbatueshëm në procedimet penale të vëna në lëvizje pas hyrjes në fuqi të ligjit favorizues, si dhe në procedimet penale, të cilat, megjithëse janë vënë në lëvizje para hyrjes në fuqi të ligjit favorizues, gjykimi për to nuk ka përfunduar ende me vendim të formës së prerë.*

*Kështu që, personat, vendimi i dënimit penal për të cilët ka marrë formë të prerë, sikurse është rasti i kërkuarit Juan, nuk mund të përfitojnë nga ligji i mëvonshëm, edhe pse ai mund të jetë favorizues në raport me ligjin penal që u zbatua nga gjykatat në kohën e dënimit të tyre.*

*I vetmi përjashtim nga ky rregull, në kushtet e zakonshme të zbatimit të Kodit Penal, bëhet vetëm për personat e dënuar me vendim të formës së prerë, kur ligji i ri, veprën për të cilën ata janë deklaruar fajtorë dhe dënuar, nuk e konsideron më vepër penale.*

*Dhe këtë përjashtim e ka bërë vetë ligjvënësi në paragrafin e dytë të nenit 3 të Kodit Penal, sipas të cilit, ligji i ri që nuk dënon veprën penale ka fuqi prapavepruese dhe në rast se personi është dënuar, ekzekutimi i dënimit nuk mund të fillojë dhe në qoftë se ka filluar, pushon.*

*Thuhet, “në kushtet e zakonshme të zbatimit të Kodit Penal”, pasi ligjvënësi, mbas miratimit të ligjit nr.7895, datë 27.1.1995 “Për Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë me dy ligje të veçanta, të miratuara ad`hoc me nr.7942 dhe 7984 të datave, respektivisht, 31.5.1995 dhe 28.7.1995, miratuar për hyrjen në fuqi të Kodit Penal, ka parashikuar shprehimisht që personave të cilët janë dënuar me vendim të formës së prerë për një ose më shumë vepra penale me masa dënimi, për një ose më shumë prej tyre, më të larta sesa maksimumi që parashikon për to Kodi i ri Penal, ju mbetet për secilën prej tyre, ky maksimum (nenet 2 dhe 1 të ligjeve respektive).*



*Nëpërmjet këtyre dy ligjeve, kanë përfituar vetëm personat që ishin dënuar para hyrjes në fuqi të Kodit të ri Penal, d.m.th. me kodet e mëparshme penale dhe një gjë e tillë ishte jo vetëm e domosdoshme, por edhe e kuptueshme, për shkak të disa ndryshimeve jo pak të rëndësishme, që pësoi instituti juridik i përgjegjësive penale dhe elemente përbërëse të tij në Kodin e ri Penal, në krahasim me të mëparshmet.*

---

Neni 4  
**Mosnjohja e ligjit**

Mosnjohja e ligjit që dënon veprën penale, nuk përbën shkak për përjashtim nga përgjegjësia penale, veç rasteve kur mosnjohja është objektivisht e paevitueshme.

Neni 5  
**Territori i Republikës së Shqipërisë**

Territori i Republikës së Shqipërisë, në kuptim të ligjit penal, quhet hapësira tokësore, gjerësia e ujërave territoriale dhe të brendshme detare, hapësira ajrore që shtrihet mbi hapësirën tokësore dhe të ujërave territoriale dhe të brendshme detare, si dhe çdo vend tjetër ku shtrihet sovraniteti i shtetit shqiptar, si selitë e përfaqësive diplomatike dhe konsullore shqiptare, anijet që mbajnë flamurin e Republikës së Shqipërisë, anijet e marinës luftarake, të aviacionit ushtarak ose civil kudo që ndodhen.

Neni 6  
**Zbatimi i ligjit penal për vepra penale të kryera nga shtetas shqiptarë**  
*(Shtuar fjali me ligjin nr.23/2012, datë 1.3.2012, neni 1)*

Për vepra penale të kryera nga shtetas shqiptarë brenda territorit të Republikës së Shqipërisë zbatohet ligji penal i Republikës së Shqipërisë.

Ligji penal i Republikës së Shqipërisë është i zbatueshëm edhe për shtetasin shqiptar që kryen krim në territorin e një shteti tjetër, kur krimi është njëkohësisht i dënueshëm dhe derisa nuk është dhënë për të një vendim përfundimtar nga një gjykatë e huaj. Kushti për dënueshmërinë e njëkohshme në territorin e shtetit tjetër nuk zbatohet në rastet e krimeve të korrupsionit në sektorin publik ose privat, si dhe të ushtrimit të ndikimit të paligjshëm.

Në kuptim të këtij neni shtetas shqiptarë do të konsiderohen edhe ata persona që përveç shtetësisë shqiptare gëzojnë edhe shtetësi tjetër.

Neni 7  
**Zbatimi i ligjit penal për vepra penale të kryera nga shtetas të huaj**  
*(Ndryshuar shkronja “d” me ligjin nr.8733, datë 24.1.2001, neni 2;  
shtuar shkronja “h” me ligjin nr.9086, datë 19.6.2003, neni 1;  
shtuar shkronja “i” me ligjin nr.9275, datë 16.9.2004, neni 1;  
ndryshuar shkronja “c” me ligjin nr.9686, datë 26.2.2007, neni 1;  
shtuar shkronja “j” me ligjin nr.10 023, datë 27.11.2008, neni 1;  
hequr shkronja “e” dhe ndryshuar shkronjat “h” dhe “i”  
me ligjin nr.23/2012, datë 1.3.2012, neni 2)*

Shtetasi i huaj, që kryen veprë penale në territorin e Republikës së Shqipërisë, përgjigjet në bazë të ligjit penal të Republikës së Shqipërisë.

Ligji penal i Republikës së Shqipërisë është i zbatueshëm edhe për shtetasin e huaj që jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë kryen në dëm të interesave të shtetit ose të shtetasit shqiptar një nga krimet e mëposhtme:

- a) krime kundër njerëzimit;
- b) krime kundër pavarësisë dhe rendit kushtetues;
- c) vepra me qëllime terroriste;
- d) organizimi i prostitucionit, trafikimi i jashtëligjshëm i njerëzve, fëmijëve dhe grave, prodhimi dhe trafikimi i jashtëligjshëm i armëve, drogës, substancave të tjera narkotike e psikotrope, i substancave bërthamore, i materialeve pornografike, si dhe trafikimi i jashtëligjshëm i veprave të artit dhe i objekteve me vlerë historike, kulturore dhe arkeologjike;
- f) falsifikimi i vulës së shtetit shqiptar, parave dhe letrave me vlerë shqiptare;
- g) krime që cenojnë jetën dhe shëndetin e shtetasit shqiptar, për të cilat ligji parashikon dënim mbi pesë vjet burgim ose çdo lloj dënimi më të rëndë;
- h) pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale;
- i) krimet e korrupsionit në sektorin publik ose privat, si dhe të ushtrimit të ndikimit të paligjshëm;
- j) vepra penale në fushën e teknologjisë së informacionit.

Neni 7/a

#### **Juridiksioni universal**

*(Shtuar me ligjin nr.9686, datë 26.2.2007, neni 2;*

*Shtuar shkronja "dh" me ligjin nr.23/2012, datë 1.3.2012, neni 3)*

Ligji penal i Republikës së Shqipërisë është i zbatueshëm edhe për shtetasin e huaj, që ndodhet në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe nuk është ekstraduar, i cili jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë ka kryer njërën nga veprat e mëposhtme:

- a) krime kundër njerëzimit;
- b) krime lufte;
- c) gjenocid;
- ç) vepra me qëllime terroriste;
- d) torturë;
- dh) financim terrorizmi.

Ligji penal i Republikës së Shqipërisë është i zbatueshëm edhe për shtetasin e huaj, që jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë kryen ndonjëherë nga veprat penale, për të cilat ligje të veçanta ose marrëveshje ndërkombëtare, ku Republika e Shqipërisë është palë, përcaktojnë zbatueshmërinë e legjislacionit penal shqiptar.

Neni 8

#### **Zbatimi i ligjit penal për vepra penale të kryera nga personi pa shtetësi**

*(Ndryshuar me ligjin nr.9686, datë 26.2.2007, neni 3)*

Për personin pa shtetësi që kryen veprë penale në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe krim jashtë këtij territori, vlejnë rregullat e neneve 7 e 7/a të këtij Kodi.

Neni 9

**Personat e mbrojtur ndërkombëtarisht**  
(Shtuar me ligjin nr.23/2012, datë 1.3.2012, neni 4)

Dispozitat e këtij Kodi zbatohen edhe për vepra penale të kryera ndaj personave të mbrojtur ndërkombëtarisht.

Person i mbrojtur ndërkombëtarisht, përveçse kur marrëveshjet ndërkombëtare, të ratifikuara nga shteti shqiptar, parashikojnë ndryshe, është:

a) kryetari i një shteti, përfshirë edhe anëtari i organit kolegjial që kryen funksionet e kryetarit të shtetit, sipas kushtetutës së atij shteti, kryetari i qeverisë ose ministri i punëve të jashtme, kur këta ndodhen në një shtet tjetër, si dhe anëtarët e familjes që i shoqërojnë;

b) çdo përfaqësues a zyrtar i një shteti ose çdo zyrtar apo agjent i një organizate ndërkombëtare me karakter ndërqeveritar, i cili, në kohën dhe vendin e kryerjes së veprës penale kundër tij, zyrës, banesës private ose mjeteve të tij të transportit, gëzon, në përputhje me të drejtën ndërkombëtare, mbrojtje të posaçme nga çdo sulm mbi personin, lirinë dhe dinjitetin e tij, si dhe anëtarët e familjes së tij.

Neni 9/a

**Përgjegjësia për personat e huaj që gëzojnë imunitet**

Çështja e përgjegjësisë për shtetasit e huaj që kryejnë veprë penale në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe që gëzojnë imunitet në bazë të së drejtës ndërkombëtare, zgjidhet me rrugë diplomatike.

Neni 10

**Fuqia e vendimeve penale të gjykatave të huaja**

Vendimet penale të dhëna nga gjykatat e huaja ndaj shtetasve shqiptarë që vërtetojnë kryerjen e një veprë penale, kur nuk është parashikuar ndryshe nga marrëveshjet dy ose shumpalëshe, vlejnë në Shqipëri brenda kufijve të ligjit shqiptar edhe përsa vijon:

- a) për efekt të cilësimit përsëritës të personit që ka kryer veprën penale;
- b) për zbatimin e vendimeve që përmbajnë dënime plotësuese;
- c) për zbatimin e masave të sigurimit;
- d) për shlyerjen e dëmit ose efekteve të tjera civile.

Neni 11

**Ekstradimi**

Ekstradimi mund të lejohet vetëm kur është parashikuar shprehimisht në marrëveshjet ndërkombëtare në të cilat Republika e Shqipërisë është palë.

Ekstradimi lejohet kur vepra penale që përbën objektin e kërkesës për ekstradim është e parashikuar si e tillë njëkohësisht si nga ligji shqiptar dhe ai i huaj.

Ekstradimi nuk lejohet:

a) në qoftë se personi që do të ekstradohet është shtetas shqiptar, veç rasteve kur në marrëveshje është parashikuar ndryshe;

b) në qoftë se vepra penale që përbën objektin e kërkesës për ekstradim ka një karakter politik ose ushtarak;

c) kur ka arsye për të dyshuar që personi i kërkuar të ekstradohet do të persekutohet, dënohet ose kërkohet për arsye të bindjeve të tija politike, fetare, kombëtare, racore ose etnike.

d) në qoftë se personi që kërkohet të ekstradohet është gjykuar nga një gjykatë kompetente shqiptare për veprën penale për të cilën kërkohet ekstradimi.

## KREU II PËRGJEGJËSIA PENALE

Neni 12

### **Mosha për përgjegjësi penale**

Ka përgjegjësi penale personi që në kohën e kryerjes së një krimi ka mbushur moshën katërmëdhjetë vjeç.

Personi që kryen një kundërvajtje penale ka përgjegjësi kur ka mbushur moshën gjashtëmëdhjetë vjeç.

Neni 13

### **Lidhja shkakësore**

Askush nuk ka përgjegjësi penale kur midis veprimit ose mosveprimit të tij dhe pasojave apo mundësisë së ardhjes së tyre, mungon lidhja shkakësore.

Neni 14

### **Faji**

Askush nuk mund të dënohet për një veprim ose mosveprim të parashikuar nga ligji si vepër penale, në qoftë se vepra nuk është e kryer me faj.

Quhet me faj personi që e kryen veprën me dashje ose me pakujdesi.

Neni 15

### **Dashja**

Vepra penale kryhet me dashje, kur personi i parashikon pasojat e veprës penale dhe dëshiron ardhjen e tyre ose, megjithëse i parashikon dhe nuk i dëshiron ato, me ndërgjegje lejon ardhjen e tyre.

Neni 16

### **Pakujdesia**

Vepra penale kryhet me pakujdesi kur personi, megjithëse nuk i dëshiron pasojat, e parashikon mundësinë e ardhjes së tyre dhe me mendjehetësi shpreson t'i shmangë ato, ose nuk i parashikon, megjithëse sipas rrethanave duhej dhe kishte mundësi t'i parashikonte.

Neni 17

### **Papërgjegjshmëria për shkak të gjendjes mendore**

Nuk ka përgjegjësi penale personi që në kohën e kryerjes së veprës vuante nga një turbullim psikik ose neuropsikik që ka prishur tërësisht ekuilibrin e tij mendor dhe për pasojë nuk ka qenë në gjendje të kontrollojë veprimet apo mosveprimet e tij dhe as të kuptojë se kryen vepër penale.

Personi që në kohën e kryerjes së veprës penale vuante nga një turbullim psikik ose neuropsikik, që ka ulur ekuilibrin e tij mendor për të kuptuar dhe kontrolluar plotësisht veprimet apo mosveprimet e tij, është i përgjegjshëm, por kjo rrethanë mbahet parasysh nga gjykata në caktimin e masës dhe llojit të dënimit.

#### Neni 18

### **Kryerja e veprës penale në gjendje të dehur**

Nuk përjashtohet nga përgjegjësia personi që ka kryer veprën penale në gjendje të dehur.

Kur dehja është shkaktuar në rrethana të rastit dhe ka sjellë uljen e ekuilibrit mendor, kjo rrethanë mbahet parasysh për zbutjen e dënimit ndaj tij.

Kur dehja është bërë me paramendim për të kryer veprën penale, kjo rrethanë mbahet parasysh për rëndimin e dënimit.

Rregullat e mësipërme zbatohen edhe kur vepra penale kryhet nën efektin e narkotikëve apo stimulantëve të tjerë.

#### Neni 19

### **Mbrojtja e nevojshme**

Nuk ka përgjegjësi penale personi që ka kryer veprën duke qenë i detyruar të mbrojë jetën, shëndetin, të drejtat dhe interesat e tij ose të një tjetri, nga një sulm i padrejtë, i vërtetë dhe i çastit me kusht që, karakteri i mbrojtjes të jetë në proporcion me rrezikshmërinë e sulmit.

Mospërputhja haptazi ndërmjet tyre përbën kapërcim të kufijve të mbrojtjes së nevojshme.

#### Neni 20

### **Nevoja ekstreme**

Nuk ka përgjegjësi penale personi që ka kryer veprën nga nevoja për të përballuar një rrezik real dhe të çastit që e kërcënon atë, një person tjetër apo pasurinë nga një dëmtim i rëndë dhe i pashmangshëm me mënyra të tjera, me kusht që të mos jetë i provokuar prej tij dhe dëmi i shkaktuar të mos jetë më i madh së dëmi i zmbarsur.

#### Neni 21

### **Ushtrimi i një të drejte apo përmbushja e detyrës**

Nuk ka përgjegjësi penale personi që vepron për të ushtruar të drejta apo përmbushur detyra të caktuara nga ligji ose nga një urdhër i dhënë prej një personi kompetent, veç rastit kur urdhri është haptazi i paligjshëm.

Kur vepra penale është kryer si rezultat i urdhrimit të paligjshëm, për të përgjigjet personi që ka dhënë urdhrin.

## KREU III TENTATIVA

Neni 22  
**Kuptimi i tentativës**

Vepra penale quhet e mbetur në tentativë kur, megjithëse personi ndërmerr veprime të drejtpërdrejta për ta kryer atë, vepra ndërpritet e nuk përfundohet për rrethana të pavarura nga vullneti i tij.

Neni 23  
**Përgjegjësia për tentativën**

Personi që tenton të kryejë një krim përgjigjet për të.

Gjykata, në varësi të shkallës së afërsisë së pasojës, si dhe të shkaqeve për të cilat krimi mbeti në tentativë, zbut dënimin dhe mund ta ulë atë nën minimumin e parashikuar nga ligji ose të caktojë një lloj dënimi më të butë nga ai i parashikuar në ligj.

Neni 24  
**Heqja dorë nga kryerja e veprës penale**

Personi që më vullnetin e tij dhe në mënyrë përfundimtare heq dorë nga kryerja e veprës penale, me gjithë mundësitë që ka për kryerjen e saj, nuk ka përgjegjësi penale.

Kur veprimet e gjeratëhershme përmbajnë elementët e ndonjë vepre tjetër penale, personi përgjigjet për veprën e kryer.

KREU IV  
BASHKËPUNIMI I PERSONAVE PËR KRYERJEN  
E VEPRËS PENALE

Neni 25  
**Kuptimi i bashkëpunimit**

Bashkëpunim quhet kryerja e veprës penale nga dy ose më shumë persona me marrëveshje ndërmjet tyre.

Neni 26  
**Bashkëpunëtorët**

Bashkëpunëtorë për kryerjen e veprës penale quhen: organizatorët, ekzekutorët, shtytësit dhe ndihmësit.

Organizatorë quhen ata persona që organizojnë dhe drejtojnë veprimtarinë për kryerjen e veprës penale.

Ekzekutorë janë personat që kryejnë veprime të drejtpërdrejta për realizimin e veprës penale.

Shtytës quhen personat që nxisin bashkëpunëtorët e tjerë për kryerjen e veprës penale.

Ndihmës quhen personat që me këshilla, udhëzime, dhënie mjetesh, largim të pengesave, dhënie të premtimit për fshehjen e bashkëpunëtorëve, të gjurmëve apo të sendeve që rrjedhin nga vepra penale, ndihmojnë për kryerjen e saj.

Neni 27  
**Përgjegjësia e bashkëpunëtorëve**

Organizatorët, shtytësit dhe ndihmësit kanë përgjegjësi si edhe ekzekutorët për veprën penale të kryer prej tyre.

Në caktimin e dënimit për bashkëpunëtorët, gjykata duhet të mbajë parasysh shkallën e pjesëmarrjes së secilit dhe rolin e luajtur në kryerjen e veprës penale.

---

### **Vendim i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë nr.1, datë 26.3.2002**

*Marrëveshja, që është një nga elementët e domosdoshëm për të patur bashkëpunim në kryerjen e veprës penale, madje më kryesori, mund të vendoset jo vetëm midis organizatorit, ekzekutorit, shtytësit dhe ndihmësit që përbën formën klasike të bashkëpunimit. Ajo mund të vendoset edhe midis vetë ekzekutorëve të veprës penale, (në rastet kur ata janë dy ose më shumë persona) dhe në këtë rast do të ndodhemi para bashkëpunimit për të kryer veprën penale në formën e bashkekzekutimit të saj.*

*Për të pasur këtë formë bashkëpunimi, kërkohet që secili nga personat që marrin pjesë në realizimin e veprës penale ose, thënë ndryshe, secili nga bashkekzekutorët, të kryejë veprime që të kenë lidhje të drejtë përdrejtë shkaksore me pasojën e dëshiruar nga të gjithë të tjerët dhe që vjen si rezultat i këtyre veprimeve të kryera nga secili prej bashkekzekutorëve d.m.th. secili nga bashkekzekutorët me veprimin apo veprimet e tij, të marrë pjesë direkt në realizimin e anës objektive të veprës penale.*

*Në të njëjtën kohë, kërkohet që veprimet e secilit prej bashkekzekutorëve të jenë rezultat i realizimit jo i dëshirave individuale të tij, por të jenë rezultat i realizimit të vullnetit të përbashkët të të gjithë bashkekzekutorëve të një veprimtarie të caktuar, konkrete, kriminale.*

*Kur vepra penale kryhet në bashkëpunim në formën e bashkekzekutimit, midis bashkëpunëtorëve nuk ka më ndarje rolesh, në kuptimin klasik të kësaj fjale (ndarje në rolet organizator, ekzekutor, shtytës dhe ndihmës), por ka një lloj ndarjeje tjetër, e cila ka të bëjë me ndarjen e punëve direkte që duhet të kryejë secili nga bashkekzekutorët për realizimin e vullnetit të përbashkët kriminal, vullnet ky që, në fund të fundit, manifestohet në botën e jashtme, veç veprimeve të secilit, edhe me arritjen e rezultatit kriminal të dëshiruar prej tyre.*

---

Neni 28

#### **Forma të veçanta të bashkëpunimit**

*(Ndryshuar me ligjin nr.9275, datë 16.9.2004, neni 2; shfuqizuar paragrafi i dytë i pikës 1, ndryshuar pika 2 me ligjin nr.9686, datë 26.2.2007, neni 4)*

1. Organizata kriminale është forma më e lartë e bashkëpunimit, në të cilën bëjnë pjesë tre ose më shumë persona dhe që dallohet nga shkalla e veçantë e organizimit, strukturimit, qëndrueshmërisë, kohëzgjatjes, si dhe nga qëllimi për kryerjen e një a më shumë veprave penale, për të realizuar përfitime materiale dhe jomateriale.

2. Organizata terroriste është një formë e veçantë e organizatës kriminale, e përbërë nga dy ose më shumë persona, që kanë një bashkëpunim të qëndrueshëm në kohë, me synim kryerjen e veprave me qëllime terroriste.

3. Banda e armatosur është një formë e veçantë bashkëpunimi që, duke zotëruar armë, municione luftarake dhe mjete të tjera të nevojshme, synon kryerjen e veprave penale, të parashikuara në krerët V, VI dhe VII të pjesës së posaçme të këtij Kodi.

4. Grupi i strukturuar kriminal është formë e veçantë bashkëpunimi, në të cilin bëjnë pjesë tre ose më shumë persona, për kryerjen e një a më shumë veprave penale, për të realizuar përfitime materiale dhe jomateriale.

Grupi i strukturuar kriminal për kryerjen e një vepre penale nuk formohet rastësisht e nuk është e nevojshme të dallohet për anëtarësi të qëndrueshme, ndarje detyrash, organizim dhe strukturim të zhvilluar.

5. Krijimi dhe pjesëmarrja në një organizatë kriminale, organizatë terroriste, bandë të armatosur ose grup të strukturuar kriminal cilësohen si vepra penale dhe dënohen sipas parashikimeve të pjesës së posaçme të këtij Kodi ose të dispozitave të tjera penale të veçanta.

6. Anëtarët e organizatës kriminale, të organizatës terroriste, bandës së armatosur ose grupit të strukturuar kriminal janë përgjegjës për të gjitha veprat penale, të kryera prej tyre, në përbushjen e qëllimeve të veprimtarisë së tyre kriminale.

7. Pjesëtari i organizatës kriminale, organizatës terroriste, bandës së armatosur ose i grupit të strukturuar kriminal, përfiton përjashtimin nga dënimi ose uljen e tij, kur jep ndihmesë, që gjykohej vendimtare për njohjen e veprimtarisë së tyre, të bashkëpunëtorëve të tjerë, pasurive të zotëruara drejtpërdrejt ose jo prej tyre, si dhe për veprimtaritë hetimore, që zhvillohen ndaj organizatave kriminale, organizatave terroriste, bandave të armatosura dhe grupeve të strukturuar kriminale.

## KREU V DËNIMET

### Neni 29

#### **Dënimet kryesore**

*(Ndryshuar me ligjin nr.8733, datë 24.1.2001, neni 79;*

*shtuar paragrafi i fundit me ligjin nr.9086, datë 19.6.2003, neni 2, shfuqizuar paragrafi I fundit me vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.47, datë 26.7.2012)*

Për personat që kanë kryer krime jepen këto dënime kryesore:

1. Me burgim të përjetshëm
2. Me burgim
3. Me gjobë

Për personat që kanë kryer kundërvajtje penale jepen këto dënime kryesore:

1. Me burgim
  2. Me gjobë
- Shfuqizuar.

### Neni 30

#### **Dënime plotësuese**

*(Ndryshuar pika 2, me ligjin nr.9086, datë 19.6.2003, neni 3;*

*ndryshuar pika 1 me ligjin nr.9275, date 16.9.2004, neni 3;*

*shtuar pika 10 me ligjin nr.23/2012, datë 1.3.2012, neni 6)*



Për personat që kanë kryer krime ose kundërvajtje penale, bashkë me dënimin kryesor, mund të jepen edhe një ose disa nga këto dënime plotësuese:

1. Ndalimi i të drejtës për të ushtruar funksione publike.
2. Konfiskimi i mjeteve të kryerjes së veprës penale dhe produkteve të veprës penale.
3. Ndalimi për të drejtuar automjete.
4. Heqja e dekoratave, titujve të nderit.
5. Heqja e së drejtës të ushtrimit të një veprimtarie ose mjeshtërie.
6. Heqja e së drejtës për të ushtruar detyra drejtuese pranë personave juridikë.
7. Ndalimi për të qëndruar në një ose disa njësi administrative.
8. Nxjerrja jashtë territorit.
9. Detyrimi për publikimin e vendimit gjyqësor.
10. Humbja e përgjegjësisë prindërore.

Gjykata, në raste të veçanta, kur dhënia e dënimeve kryesore çmohet e papërshtatshme dhe kur ligji parashikon dënim me burgim deri në 3 vjet ose dënime të tjera më të lehta për veprën e kryer, mund të mjaftohet vetëm me caktimin e dënimit plotësues.

Neni 31

### **Dënimi me burgim të përjetshëm**

*(Ndryshuar paragrafi i I, II dhe titulli me ligjin nr.8733, datë 24.1.2001, neni 79; shfuqizuar paragrafi i fundit me ligjin nr.9686, datë 26.2.2007, neni 5)*

Dënimi me burgim të përjetshëm jepet me vendim të gjykatës për kryerjen e një krimi të rëndë.  
Dënimi me burgim të përjetshëm nuk jepet ndaj personave që në kohën e kryerjes së krimit nuk kanë mbushur moshën tetëmbëdhjetë vjeç, si dhe për gratë.

Neni 32

### **Dënimi me burgim**

*(Ndryshuar me ligjin 144/2013, datë 2.5.2013, neni 2)*

Dënimi me burgim për krimet jepet për një kohë nga pesë ditë deri në tridhjetë e pesë vjet.  
Për kundërvajtje penale dënimi me burgim jepet për një kohë nga pesë ditë deri në dy vjet.

Neni 33

### **Mënyra e vuajtjes së dënimit me burgim të përjetshëm dhe me burgim**

Dënimi me burgim të përjetshëm dhe dënimi me burgim vuhet në institucione të caktuara posaçërisht për këtë qëllim.

Rregullat mbi mënyrën e vuajtjes së dënimeve, të drejtat dhe detyrat e të dënuarve caktohen me ligj.  
Të miturit e kryejnë dënimin me burgim në vende të veçanta nga të rriturit.  
Gratë e kryejnë dënimin me burgim në institucione të veçanta nga burrat.

Neni 34

### **Dënimi me gjobë**

*(Ndryshuar paragrafi i III dhe IV, shtuar paragrafi i V, ndryshuar paragrafi*

*i VII, me ligjin nr.8733, datë 24.1.2001, neni 3; ndryshuar paragrafi IV me ligjin nr.9275, datë 16.9.2004, neni 4; shfuqizuar paragrafi 8 me vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.19, datë 1.6.2011; ndryshuar me ligjin nr.23/2012, datë 1.3.2012, neni 8)*

*(Ndryshuar paragrafi i V me ligjin 144/2013, datë 2.5.2013, neni 3)*

Dënimi me gjobë konsiston në pagimin në favor të shtetit të një shume të hollash brenda kufijve të parashikuar në ligj.

Dënimi me gjobë jepet për personat që kryejnë krim ose kundërvajtje penale.

Për personat që kryejnë krim gjoba jepet nga 100 mijë gjer në 10 milionë lekë.

Për personat që kryejnë kundërvajtje penale, gjoba jepet nga 50 mijë gjer në 3 milionë lekë.

Për personat që kryejnë krime për motive fitimi të pasurive ose të sigurimit të çdo lloj përfitimi tjetër material, gjykata vendos sipas nenit 36 të këtij Kodi, konfiskimin e mjeteve të kryerjes së veprës penale dhe produkteve të veprës penale ose, në mungesë të tyre, dënim me gjobë në masën nga 100 mijë deri në 5 milion lekë.

Gjykata jep dënimin me gjobë, pasi ka hetuar rreth aftësisë paguese të personit. Aftësia paguese përcaktohet nga gjendja personale dhe pasurore e personit, si dhe nga rrethana të tjera që lidhen me to. Dënimi me gjobë paguhet në afatin e caktuar në vendimin e gjykatës.

Gjykata, duke marrë parasysh gjendjen ekonomike të të dënuarit, mund të lejojë që gjoba të paguhet me këste, duke caktuar këstet dhe afatin e pagimit të tyre.

Kur i dënuari nuk e paguan gjobën dhe gjoba nuk mund të vilet nëpërmjet ekzekutimit të detyrueshëm, gjykata vendos zëvendësimin e gjobës me burgim, duke llogaritur pesë mijë lekë për një ditë burgim.

Kur i dënuari nuk mund të paguajë gjobën në afat pa fajin e tij dhe nëse kriteret, mbi të cilat është caktuar gjoba, kanë ndryshuar pas dhënies së vendimit dhe nuk e justifikojnë haptazi pagimin e gjobës, atëherë i dënuari mund të kërkojë:

a) shtyrje të afatit të pagesës së gjobës gjer në gjashtë muaj;

b) kryerjen e një pune me interes publik.

Nëse gjykata urdhëron kryerjen e një pune në interes publik zbatohen rregullat e nenit 63 të këtij Kodi.

Nëse gjoba nuk paguhet edhe pas shtyrjes së afatit ose nëse i dënuari nuk e kryen punën në interes publik, gjykata vendos zëvendësimin e gjobës me burgim.

Kur gjoba është dhënë për kryerjen e një krimi, zëvendësimi i saj me burgim nuk mund të kalojë tre vjet, ndërsa kur ajo është dhënë për kryerjen e një kundërvajtjeje penale, zëvendësimi nuk mund të kalojë një vit burgim, por gjithmonë pa kaluar maksimumin e dënimit me burgim që parashikon dispozita përkatëse. Nëse dispozita penale nuk parashikon dënim me burgim, maksimumi i dënimit me burgim konsiderohet gjashtë muaj.

Kur i dënuari si më sipër gjatë zbatimit të burgimit paguan gjobën, gjykata revokon vendimin, duke bërë llogaritjet sipas kriterit të paragrafit të 8 të këtij neni.

Neni 35

### **Heqja e së drejtës për të ushtruar funksione publike**

*(Riformuluar me ligjin nr.9275, datë 16.9.2004, neni 5)*

Heqja e së drejtës për të ushtruar funksione publike, për një kohë jo më pak se pesë vjet, jepet detyrimisht ndaj personit që ka kryer një krim, që lidhet me detyrën, duke shpërdoruar funksionin publik ose ka kryer një krim, për të cilin gjykata ka caktuar një dënim me burgim jo më pak se dhjetë vjet.

Heqja e së drejtës për të ushtruar funksione publike mund të jepet për një kohë nga tre deri në pesë vjet, kur gjykata ka caktuar një dënim nga pesë deri në dhjetë vjet burgim, dhe nga një deri në tre vjet, kur është caktuar dënimi deri në tre vjet burgim.

#### Neni 36

### **Konfiskimi i mjeteve të kryerjes së veprës penale dhe produkteve të veprës penale**

*(Ndryshuar me ligjin nr.9086, datë 19.6.2003, neni 4)*

1. Konfiskimi jepet detyrimisht nga gjykata dhe ka të bëjë me marrjen dhe kalimin në favor të shtetit:

- a) të sendeve që kanë shërbyer ose janë caktuar si mjete për kryerjen e veprës penale;
- b) të produkteve të veprës penale, ku përfshihet çdo lloj pasurie, si dhe dokumentet ose instrumentet ligjore që vërtetojnë tituj ose interesa të tjerë në pasurinë që rrjedh ose fitohet drejtpërdrejt ose tërthorazi nga kryerja e veprës penale;
- c) të shpërblimeve, të dhëna ose të premtuara, për kryerjen e veprës penale;

ç) të çdo pasurie tjetër, vlera e së cilës i korrespondon asaj të produkteve të veprës penale;

d) të sendeve, prodhimi, përdorimi, mbajtja ose tjetërsimi i të cilave përbëjnë vepër penale, edhe kur nuk është dhënë vendim dënimi.

2. Nëse produktet e veprës penale janë transformuar ose shndërruar pjesërisht ose plotësisht në pasuri të tjera, këto të fundit i nënshtrohen konfiskimit.

3. Nëse produktet e veprës penale janë bashkuar me pasuri të fituara në rrugë të ligjshme, këto të fundit konfiskohen deri në vlerën e produkteve të veprës penale.

4. Konfiskimit i nënshtrohen edhe të ardhurat ose përfitimet e tjera nga produktet e veprës penale, nga pasuritë në të cilat janë transformuar ose shndërruar produktet e veprës penale ose nga pasuritë me të cilat janë përzier këto produkte, në të njëjtën masë dhe mënyrë sikurse produktet e veprës penale.

#### Neni 37

### **Ndalimi për të drejtuar automjete**

Ndalimi për të drejtuar automjete jepet nga gjykata, për një kohë nga një gjer në pesë vjet, kundër personave që kanë kryer vepër penale, kur çmohet se do të ketë efekt parandalues apo pajtohet me natyrën e veprës së kryer.

#### Neni 38

### **Heqja e dekoratave dhe e titujve**

Heqja e dekoratave dhe titujve të nderit vendoset për personat që kanë kryer një vepër penale që dënohet me burgim dhe çmohet se mbajtja e tyre nuk pajtohet me natyrën e veprës penale të kryer.

Heqja e dekoratave dhe titujve të nderit është e përhershme kur personi dënohet për një krim mbi dhjetë vjet dhe nga një gjer në pesë vjet, kur dënohet gjer në dhjetë vjet burgim.

Neni 39

**Heqja e së drejtës të ushtrimit të një profesioni ose të një veprimtarie**

*(Ndryshuar neni me ligjin 144/2013, datë 2.5.2013, neni 4)*

Heqja e së drejtës të ushtrimit të një profesioni ose të një veprimtarie e ndalon të dënuarin të ushtrorë profesionin ose veprimtarinë, për të cilën është dhënë leje e veçantë, dëshmi, autorizim apo licencë nga organi kompetent.

Heqja e së drejtës së ushtrimit të një veprimtarie ose të një profesioni jepet për një kohë nga një muaj deri në pesë vjet dhe është rrjedhojë e çdo dënimi për vepra penale që kryhen duke i shpërdoruar ato, ose kur vlerësohet se ushtrimi i mëtejshëm i veprimtarisë apo profesionit bie ndesh me marrëdhënien juridike që synon të mbrojë vepra penale konkrete.

Neni 40

**Heqja e së drejtës të ushtrimit të detyrave drejtuese**

*(Shtuar paragrafi i fundit me ligjin nr.9275, datë 16.9.2004, neni 6)*

Heqja e së drejtës të ushtrimit të detyrave drejtuese pranë personave juridikë, i heq mundësinë të dënuarit të ushtrorë detyrat e drejtorit, të administratorit, sipërmarrësit, likuidatorit, si dhe çdo detyrë tjetër që ka të bëjë me cilësinë e përfaqësuesit të personit juridik.

Heqja e së drejtës të ushtrimit të detyrave drejtuese pranë personave juridikë është rrjedhojë e çdo dënimi për vepra penale dhe jepet për një kohë nga një muaj gjer në pesë vjet, kur i dënuari ka shpërdoruar funksionet apo ka vepruar në kundërshtim me rregullat që lidhen me detyrën.

Kur dënimi i dhënë nga gjykata është jo më pak se pesë vjet burgim, kjo e drejtë mund të hiqet për një kohë nga pesë deri në dhjetë vjet.

Neni 41

**Ndalimi për të qëndruar në një apo disa njësi administrative**

Ndalimi për të qëndruar në një apo disa njësi administrative jepet nga gjykata për një kohë nga një gjer në pesë vjet, kur çmohet se qëndrimi i të dënuarit në këto vende përbën rrezik për sigurimin publik.

Neni 42

**Nxjerrja jashtë territorit**

Nxjerrja jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë jepet nga gjykata ndaj shtetasit të huaj dhe atij pa shtetësi që kryen një krim dhe çmohet se qëndrimi i mëtejshëm i tij në territorin e Republikës së Shqipërisë nuk duhet të vazhdojë më në të ardhmen.

Vendimi revokohet nga gjykata, me kërkesën e të dënuarit, kur shtetasi i huaj apo pa shtetësi fiton shtetësinë shqiptare.

Neni 43

**Publikimi i vendimit gjyqësor**

Publikimi i vendimit gjyqësor jepet nga gjykata kur çmon se njohja e përmbajtjes së vendimit ka interes për persona juridikë e fizikë.

Publikimi i vendimit gjyqësor konsiston në detyrimin e të dënuarit që me shpenzimet e veta të publikojë në një apo disa gazeta ose stacione radiotelevizive tërësisht apo pjesërisht vendimin gjyqësor, sipas urdhërimit të bërë nga gjykata.

Data e publikimit dhe kohëzgjatja e tij caktohen nga gjykata.

Organet e shtypit dhe të radiotelevizionit janë të detyruar të bëjnë publikimin e vendimit gjyqësor të dërguar nga gjykata.

Publikimi i vendimit gjyqësor nuk jepet kur rrezikohet përhapja e sekretit shtetëror, cenohet jeta intime e personave ose preket morali shoqëror.

Neni 43/a

### **Humbja e përgjegjësisë prindërore**

*(Shtuar me ligjin nr.23/2012, datë 1.3.2012, neni 7)*

Humbja e përgjegjësisë prindërore jepet nga gjykata ndaj personit që e ushtron përgjegjësinë prindërore, kur ai dënohet si autor ose bashkëpunëtor në një vepër penale ndaj fëmijës ose si bashkëpunëtor me fëmijën në kryerjen e një veprë penale.

Neni 44

### **Mënyra e vuajtjes së dënimeve plotësuese**

Kur gjykata, së bashku me një dënim me burgim, jep edhe një ose disa nga dënimet plotësuese të përmendura në nenin 30 të këtij Kodi, zbatimi i tyre fillon së bashku me vuajtjen e dënimit kryesor.

Për numrat 1, 3, 5, 6, 7 dhe 8 të nenit 30 të këtij Kodi zbatimi i tyre fillon pas vuajtjes së dënimit me burgim. Të drejtat e cenuara nga dënimet plotësuese i dënuari nuk mund t'i ushtrojë gjatë kohës së vuajtjes së dënimit me burgim.

Neni 45

### **Zbatimi i ligjit penal ndaj personave juridikë**

*(Shfuqizuar me ligjin nr.8733, datë 24.1.2001, neni 4;*

*shtuar me ligjin nr.9275, datë 16.9.2004, neni 7)*

Personat juridikë, me përjashtim të institucioneve shtetërore, përgjigjen penalisht për vepra penale, të kryera në emër ose në dobi të tyre nga organet dhe përfaqësuesit e tyre.

Njësitë e qeverisjes vendore përgjigjen penalisht vetëm për veprime të kryera gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre, të cilat mund të ushtrohen nëpërmjet delegimit të shërbimeve publike.

Përgjegjësia penale e personave juridikë nuk përjashton atë të personave fizikë, të cilët kanë kryer ose janë bashkëpunëtorë në kryerjen e të njëjtave vepra penale.

Veprat penale dhe masat ndëshkuese përkatëse, që zbatohen ndaj personave juridikë, si dhe procedura për vendosjen dhe ekzekutimin e tyre rregullohen me ligj të veçantë.

Neni 46

### **Masat mjekësore dhe edukuese**

Masat mjekësore mund të jepen nga gjykata ndaj personave të papërgjegjshëm që kanë kryer veprë penale, ndërsa masat edukuese mund të jepen ndaj të miturve që përjashtohen nga dënimi ose që për shkak të moshës nuk kanë përgjegjësi penale.

Masat mjekësore janë:

1. Mjekimi i detyruar ambulator
2. Mjekimi i detyruar në një institucion mjekësor

Masa edukuese është:

1. Vendosja e të miturit në një institucion edukimi

Vendimi gjyqësor për masat mjekësore dhe edukuese është i revokueshëm në çdo kohë kur zhduken rrethanat për të cilat ai është dhënë, por në çdo rast, gjykata, kryesisht, është e detyruar që pas kalimit të një viti nga dita e dhënies së vendimit, të marrë në shqyrtim vendimin e saj.

Rregullat për revokimin e vendimit gjyqësor që përmban masën mjekësore dhe edukuese, parashikohen në Kodin e Procedurës Penale.

## KREU VI CAKTIMI I DËNIMIT

Neni 47

### **Mënyra e caktimit të dënimit**

Gjykata cakton dënimin duke respektuar dispozitat e pjesës së përgjithshme të këtij Kodi dhe kufijtë e dënimeve të parashikuar në ligj për veprën penale.

Në caktimin e dënimit ndaj personit ajo merr parasysh rrezikshmërinë e veprës penale, të autorit të saj, shkallën e fajit, si dhe rrethanat lehtësuese dhe rënduese.

Neni 48

### **Rrethanat lehtësuese**

*(Shtuar dy paragrafët e fundit me ligjin 144/2013, datë 2.5.2013, neni 5)*

Lehtësojnë dënimin rrethanat që vijojnë:

- a) Kur vepra është kryer e shtyrë nga motive me vlera pozitive morale e shoqërore;
- b) kur vepra është kryer nën ndikimin e tronditjes psikike të shkaktuar nga provokimi ose veprime të padrejta të viktimës apo të ndonjë personi tjetër;
- c) kur vepra është kryer nën ndikimin e veprimeve apo të udhëzimeve të padrejta të eprorit;
- ç) kur personi që ka kryer veprën tregon pendim të thellë;
- d) kur personi ka zëvendësuar dëmin e shkaktuar nga vepra penale ose ka ndihmuar aktivisht për të zhdukur ose pakësuar pasojat e veprës penale;
- dh) kur personi paraqitet në organet kompetente pas kryerjes së veprës penale;
- e) kur marrëdhëniet ndërmjet personit që ka kryer veprën penale dhe të dëmtuarit janë normalizuar.

Rrethana lehtësuese e parashikuar në shkronjën “a” të paragrafit të parë të këtij neni, nuk lehtëson dënimin kur vepra penale është kryer në rrethanat e parashikuara në shkronjën “j” të nenit 50 të këtij Kodi.

Rrethana lehtësuese, e parashikuar në shkronjën “e” të paragrafit të parë të këtij neni, nuk lehtëson dënimin e një personi që ka kryer një veprë penale ndaj fëmijëve apo një veprë penale të dhunës në familje.

Neni 49

Gjykata, pavarësisht nga rrethanat që përmenden në nenin 48 të këtij Kodi, mund të marrë në konsideratë edhe rrethanat të tjera për sa kohë i quan të tilla që justifikojnë lehtësimin e dënimit.

Rrethana lehtësuese e parashikuar në shkronjën “a” të paragrafit të parë të këtij neni, nuk lehtëson dënimin kur vepra penale është kryer në rrethanat e parashikuara në shkronjën “j” të nenit 50 të këtij Kodi.

Rrethana lehtësuese, e parashikuar në shkronjën “e” të paragrafit të parë të këtij neni, nuk lehtëson dënimin e një personi që ka kryer një vepër penale ndaj fëmijëve apo një vepër penale të dhunës në familje.

#### Neni 50

#### **Rrethanat rënduese**

*(Ndryshuar shkronja “b”, shtuar shkronja “h” dhe “i” me ligjin nr.8733, datë 24.1.2001, neni 5; ndryshuar shkronja “dh” me ligjin nr.9275, datë 16.9.2004, neni 8; shtuar shkronja “j” me ligjin nr.9686, datë 26.2.2007, neni 6)*  
*(Shtuar dhe ndryshuar me ligjin 144/2013, datë 2.5.2013, neni 6)*

Rëndojnë dënimin rrethanat që vijojnë:

- a) kryerja e veprës i shtyrë nga motive të dobëta;
- b) kryerja e veprës për të vënë para përgjegjësisë ose për të fshehur përgjegjësinë penale të një tjetri apo për të shmangur dënimin për një vepër penale tjetër ose për të realizuar, ose për të siguruar për vete a për të tretët fitime pasurore, ose çdo lloj përfitimi tjetër material;
- c) kryerja e veprës penale me egërsi dhe mizori;
- ç) kryerja e një krimi pas dhënies së një dënimi për një krim të kryer më parë;
- ç/1) kryerja e veprës penale pas vendosjes së personit nën mbikëqyrje elektronike;
- d) kryerja e veprimeve që rëndojnë apo shtojnë pasojat e veprës penale;
- dh) kryerja e veprës penale duke shpërdoruar funksionin publik ose shërbimin fetar;
- e) kur vepra është kryer kundër fëmijëve, grave shtatzana ose personave që, për shkaqe të ndryshme, nuk mund të mbrohen;
- e/1) kryerja e veprës penale gjatë ose pas dhënies së urdhrave gjyqësorë të mbrojtjes nga dhuna në familje;
- f) kur vepra është drejtuar ndaj përfaqësuesve të shteteve të tjera;
- g) kur vepra është kryer duke përfituar nga marrëdhëniet familjare, të bashkëjetesës, të miqësisë, të mikpritjes;
- gj) kryerja e veprës penale në bashkëpunim;
- h) kryerja e veprës penale më shumë se një herë;
- i) kur vepra është kryer duke përdorur armë, municione luftarake, lëndë plasëse, djegëse, helmuese dhe radioaktive.
- j) kur vepra është kryer e shtyrë nga motive që kanë të bëjnë me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike ose aftësinë e kufizuar.

Neni 51

**Dënimi me burgim për të miturit**

Për të miturit, që në kohën e kryerjes së veprës penale nuk kanë mbushur moshën 18 vjeç, dënimi me burgim nuk mund të jetë më shumë se gjysma e dënimit që parashikon ligji për veprën penale të kryer.

Neni 52

**Përfshirja e të miturit nga dënimi**

Gjykata, nisur nga rrezikshmëria e paket e veprës penale, nga rrethanat konkrete të kryerjes së saj, nga sjellja e mëparshme e të miturit, mund ta përfshijë atë nga dënimi.

Në këto raste gjykata mund të vendosë dërgimin e të miturit në një institucion edukimi.

Neni 52/a

**Përfshirja ose ulja e dënimit për bashkëpunëtorët  
e drejtësisë dhe viktimat**

*(Shtuar neni me ligjin 144/2013, datë 2.5.2013, neni 7)*

Personi, që ka premtuar ose ka dhënë shpërblim ose përfitime të tjera, sipas neneve 164/a, 244, 244/a, 245, 312, 319, 319/a, 319/b, 319/c dhe 328 të këtij Kodi mund të përfitojë përfshirje nga vuajtja e dënimit ose ulje të tij, nëse bën kallëzim dhe jep ndihmesë në procedimin penal të këtyre veprave. Në dhënien e vendimit, gjykata mban parasysh edhe kohën kur është bërë kallëzimi, ardhjen ose jo të pasojave të veprës.

Personi i dëmtuar nga veprat penale, që lidhen me trafikimin e personit, mund të përfitojë përfshirjen nga dënimi, për kryerjen e veprave penale gjatë periudhës së trafikimit dhe në masën që ka qenë i detyruar t'i kryejë ato veprime apo mosveprime të kundërligjshme.

Personi që ka kryer njërin nga veprat penale që kanë lidhje me trafikun e narkotikëve, armëve apo municioneve, trafikimin e personave ose për vepra penale të kryera nga organizata kriminale, që bashkëpunon dhe ndihmon organet e ndjekjes penale në luftën kundër tyre ose, sipas rastit, në zbulimin e personave të tjerë, që kryejnë krime të tilla, nuk mund të dënohet më tepër se gjysma e dënimit të parashikuar për veprën e kryer prej tij. Në raste të veçanta, kur konkurrojnë edhe rrethana lehtësuese në favor të tij, ky person mund të përfshijë nga dënimi.

Neni 53

**Ulja e dënimit nën kufijtë e parashikuar nga ligji**

*(Shtuar me ligjin 144/2013, datë 2.5.2013, neni 8)*

Gjykata, në raste të veçanta, kur çmon që vepra dhe autori i saj paraqesin rrezikshmëri të paket dhe janë të pranishme disa nga rrethanat lehtësuese dhe nuk është e pranishme asnjë rrethanë rënduese, ka të drejtë të caktojë një dënim nën minimumin ose një lloj dënimi më të butë se ai që parashikon dispozita përkatëse.

Neni 54

**Pranimi i pagimit të gjobës**



Për kundërvajtjet penale për të cilat, veç gjobës, parashikohet njëkohësisht dënimi me burgim, gjykata, me kërkesën e autorit të kundërvajtjes penale mund të pranojë që ai të paguajë aty për aty një shumë të hollash në favor të buxhetit të shtetit, e barabartë me gjysmën e maksimumit të gjobës të parashikuar për kundërvajtjet penale në Pjesën e Përgjithshme të këtij Kodi.

Kërkesa mund të paraqitet në çdo fazë të gjykimit deri përpara dhënies së vendimit përfundimtar të shkallës së parë.

Kur gjykata nuk pranon kërkesën, jep dënimin për veprën e kryer.

Pranimi i kërkesës nuk lejohet për personat që më parë janë dënuar edhe për kundërvajtje penale.

#### Neni 55

### **Caktimi i dënimeve për disa vepra penale**

*(Shtuar paragrafi i II me ligjin 144/2013, datë 2.5.2013, neni 9)*

Kur veprimet ose mosveprimet përmbajnë elementët e disa veprave penale, si dhe kur personi ka kryer disa vepra penale për të cilat nuk është dhënë akoma vendim, gjykata më parë cakton dënimin për çdo vepër penale dhe në përfundim jep një dënim të vetëm, që përbëhet nga dënimi më i rëndë i shtuar.

Dënimi më i rëndë i shtuar në rastin kur personi ka kryer një krim kundër jetës me dashje, me përdorimin pa leje të armëve luftarake dhe municionit, përbëhet nga shumica e përgjithshme e dënimeve për secilën vepër penale.

Dënimi më i rëndë i shtuar nuk mund të kapërcejë shumën e përgjithshme të dënimeve të caktuara veç e veç, as kufirin më të lartë të parashikuar për llojin e dënit të dhënë.

Kur gjykata çmon se kryerja e shumë veprave penale nuk tregon rrezikshmëri të madhe të fajtorit, mund të japë si dënim përfundimtar dënimin më të rëndë që ka caktuar për një nga veprat penale.

Gjykata në vendimin përfundimtar jep një ose më shumë nga dënimet plotësuese të dhëna më vete për çdo vepër të veçantë.

#### Neni 56

### **Bashkimi i dënimeve**

Kur i dënuari, para vuajtjes së plotë të dënit, dënohet për një vepër penale të kryer para dhënies së vendimit, zbatohen rregullat e nenit të mësipërm dhe pjesa e vuajtur e dënit llogaritet në dënimin e ri.

Kur i dënuari, pas dhënies së vendimit, por para vuajtjes së plotë të dënit, kryen një vepër penale të re, gjykata bën bashkimin e dënit të ri me pjesën e mbetur të dënit të mëparshëm, duke ndjekur rregullat e parashikuara nga neni 55 i këtij Kodi.

#### Neni 57

### **Llogaritja e paraburgimit**

*(Ndryshuar paragrafi i III me ligjin nr.8733, datë 24.1.2001, neni 6)*

Koha e paraburgimit llogaritet në dënimin me burgim ose me gjobë, si dhe në detyrimin për kryerjen e një pune në interes publik si më poshtë:

Një ditë paraburgim baras me një ditë e gjysmë burgim.

Një ditë paraburgim baras me 5 mijë lekë gjobë.

Një ditë paraburgim baras me tetëmbëdhjetë orë pune në interes publik.

KREU VII  
ALTERNATIVAT E DËNIMIT ME BURGIM

Neni 58

**Gjysmëliria**

*(Ndryshuar me ligjin nr.10 023, datë 27.11.2008, neni 2)*

Për dënimin deri në një vit burgim, gjykata, për shkak të detyrimeve të personit të dënuar për punën, arsimin, kualifikimin ose aftësimin profesional, përgjegjësitë thelbësore familjare apo për nevojën për trajtim ose rehabilitim mjekësor, mund të vendosë ekzekutimin e vendimit me burgim me gjysmëliri.

Personi i dënuar, që vuan dënimin me gjysmëliri, është i detyruar të kthehet në burg, pasi të ketë kryer detyrimet jashtë burgut, brenda periudhës kohore të përcaktuar nga gjykata.

Kur personi i dënuar nuk përmbush detyrimet, sipas këtij neni, zbatohet neni 62 i këtij Kodi.

Neni 59

**Pezullimi i ekzekutimit të vendimit me burgim dhe vënia  
në provë**

*(Ndryshuar me ligjin nr.10 023, datë 27.11.2008, neni 3)*

Për shkak të rrezikshmërisë së paktë të personit, moshës, kushteve shëndetësore apo mendore, mënyrës së jetesës dhe të nevojave, veçanërisht atyre që lidhen me familjen, shkollimin ose punën, rrethanave të kryerjes së veprës penale, si dhe të sjelljes pas kryerjes së veprës penale, gjykata, kur jep dënim me burg deri në pes, vjet, mund të urdhëroj, që i dënuari të mbajë kontakte me shërbimin e provës dhe të vihet në provë, duke pezulluar ekzekutimin e dënimit, me kusht që gjatë kohës së provës të mos kryejë veprë tjetër penale.

Gjykata urdhëron që i dënuari të përmbushë një apo më shumë detyrime, të parashikuara në nenin 60 të këtij Kodi.

Afati i provës është 18 muaj deri në 5 vjet.

Nëse i dënuari nuk mban kontakte me shërbimin e provës apo nuk përmbush detyrimet e parashikuara në nenin 60, siç është urdhëruar nga gjykata, gjykata vendos zëvendësimin e dënimit të parë me një dënim tjetër, zgjatjen e afatit të mbikëqyrjes, brenda periudhës së provës, ose revokimin e pezullimit të ekzekutimit të vendimit.

Neni 59/a

**Qëndrimi në shtëpi**

*(Shtuar me ligjin nr.10 023, datë 27.11.2008, neni 4)*

*(Shtuar me paragrafi I II me ligjin nr. 144/2013, datë 2.5.2013, neni 10)*

Për dënimet me burgim deri në dy vjet ose kur kjo kohë është pjesë e mbetur e dënimit, sipas një vendimi për një periudhë më të gjatë burgimi, gjykata mund të vendosë vuajtjen e dënimit të dhënë me qëndrimin në shtëpi të të dënuarit, në një shtëpi tjetër private apo në një qendër të kujdesit dhe të shëndetit publik, kur ekzistojnë rrethanat e mëposhtme:

a) Për gratë shtatzëna ose nëna me fëmijë, nën moshën 10 vjeç, që jetojnë me të.

b) Për baballarët, që kanë përgjegjësi prindërore për fëmijën, që jeton me të, nën moshën 10 vjeç, kur nëna e tij ka vdekur apo është e pazonja për t'u kujdesur për të.

c) Për persona, në kushte të rënda shëndetësore, që kërkojnë kujdes të vazhdueshëm nga shërbimi shëndetësor, jashtë burgut.

ç) Për personat mbi 60 vjeç, që janë të paaftë nga ana shëndetësore.

d) Për të rinj, nën moshën 21 vjeç, me nevoja të dokumentuara shëndetësore, studimore, të punës apo përgjegjësive familjare.

Gjykata, në rrethanat e parashikuara në shkronjat "a" dhe "b" të paragrafit të parë të këtij neni, nuk mund të vendosë vuajtjen e dënimit të dhënë me qëndrim në shtëpi, të dënuarve që kanë kryer një krim ndaj bashkëshortit, bashkëjetuesit apo fëmijës së tij.

Gjykata mund të lejojë personat e dënuar me qëndrim në shtëpi të largohen nga vendbanimi, për plotësimin e nevojave të domosdoshme familjare, për t'u angazhuar në veprimtari pune, edukimi apo arsimimi ose për programe rehabilitimi, për të cilat shërbimi i provës është dakord.

Në këtë rast gjykata përcakton masat që duhet të marrë shërbimi i provës.

Gjykata revokon qëndrimin në shtëpi dhe e zëvendëson atë me një ndëshkim tjetër, kur nuk ekzistojnë më kushtet e parashikuara në paragrafin e parë të këtij neni. Në qoftë se personi i dënuar largohet pa autorizimin e gjykatës nga vendbanimi apo shkel detyrimet e caktuara në vendimin e gjykatës, zbatohet neni 62 i këtij Kodi.

#### Neni 60

#### **Detyrimet e të dënuarit të vënë në provë**

*(Ndryshuar me ligjin nr.10 023, datë 27.11.2008, neni 5)*

I dënuari i vënë në provë, mund të detyrohet nga gjykata të plotësojë një apo më tepër prej detyrimeve të mëposhtëme:

1. Të ushtrojë një veprimtari profesionale ose të marrë një arsim apo formim profesional.
2. Shfrytëzimi i pagës dhe i të ardhurave të tjera ose i pasurisë për përmbushjen e detyrimeve financiare.
3. Të riparojë dëmin civil të shkaktuar.
4. Të ndalohet të drejtojë automjete të caktuara.
5. Të mos ushtrojë veprimtari profesionale kur vepra penale ka lidhje me këtë veprimtari.
6. Të mos frekuentojë vende të caktuara.
7. Të mos frekuentojë lokale që shërbejnë pije alkoolike.
8. Të qëndrojë në banesën e tij në orare të caktuara.
9. Të mos shoqërohet me persona të caktuar, kryesisht me të dënuar apo bashkëpunëtorët e veprës penale.
10. Të mos zotërojë, mbajë apo përdorë armë.
11. Mjekimi ose rehabilitimi në një institucion shëndetësor ose nënshtrimi në një program të trajtimit, mjekësor apo rehabilitues.
12. Heqja dorë nga përdorimi i alkoolit ose drogës.

Në përcaktimin e detyrimeve për të dënuarin, gjykata merr parasysh moshën e të dënuarit, gjendjen mendore, mënyrën e jetesës dhe nevojat e tij, veçanërisht ato të lidhura me familjen, edukimin ose punën, motivet e kryerjes së veprës penale, qëndrimin pas kryerjes së veprës penale, si dhe rrethana të tjera, që ndikojnë në vendosjen e detyrimeve, sipas këtij neni dhe mbikëqyrjen e tyre.

#### Neni 60/a

#### **Detyrimi për të hequr dorë nga përdorimi i alkoolit ose drogës**

*(Shtuar neni me ligjin 144/2013, datë 2.5.2013, neni 11)*

Gjykata, ndaj të dënuarit të vënë në provë, i cili është në kushtet e varësisë kronike ndaj alkoolit apo lëndëve narkotike, vendos detyrimin për t'iu nënshtruar trajtimeve mjekësore për heqjen dorë nga përdorimi i alkoolit apo drogës.

Trajtimi mjekësor për heqjen dorë nga përdorimi i alkoolit apo drogës bëhet në institucionin mjekësor të specializuar, sipas përcaktimit që bën Ministria e Shëndetësisë, në bazë të kërkesës së shërbimit të provës.

Shërbimi i provës mbikëqyr ekzekutimin e vendimit të gjykatës dhe i raporton menjëherë prokurorit, kur personi i dënuar nuk përmbush detyrimin e vendosur.

Neni 61

**Detyrimet e të dënuarit gjatë kohës së provës**

*(Ndryshuar me ligjin nr.10 023, datë 27.12.2008, neni 6)*

Gjatë kohës së provës i dënuari është i detyruar:

a) të paraqitet rregullisht dhe të informojë në vazhdimësi shërbimin e provës për përmbushjen e kushteve dhe detyrimeve të caktuara nga gjykata;

b) të marrë pëlqimin nga shërbimi i provës për ndryshimin e vendbanimit, qendrës së punës apo për lëvizjet e shpeshta brenda vendit.

Neni 62

**Shkelja e kushteve dhe e detyrimeve gjatë kohës së provës**

*(Ndryshuar me ligjin nr. 10 023, datë 27.11.2008, neni 7)*

Nëse i dënuari, gjatë afatit të provës, kryen një vepër tjetër penale, gjykata mund të ndryshojë detyrimet që ka vendosur, ta zëvendësojë dënimin e dhënë me një dënim tjetër, apo ta revokojë, tërësisht ose pjesërisht, vendimin e pezullimit.

Nëse i dënuari, gjatë afatit të provës, shkel kushtet ose detyrimet që i janë vendosur, shërbimi i provës i raporton menjëherë prokurorit.

Për shkelje të lehta dhe për herë të parë të kushteve ose të detyrimeve që i janë vendosur nga gjykata, prokurori ka të drejtë të japë paralajmërim, i cili regjistrohet në dosjen personale të të dënuarit.

Për shkelje të rënda ose të përsëritura, prokurori i kërkon gjykatës ndryshimin e detyrimit të vendosur, shtimin e detyrimeve të tjera, zëvendësimin e tyre me një sanksion tjetër, ose revokimin e vendimit të pezullimit të dënimit dhe vuajtjen e pjesës së mbetur të dënimit në burg.

Neni 63

**Pezullimi i ekzekutimit të vendimit me burgim  
dhe detyrimi për kryerjen e një pune në interes publik**

*(Ndryshuar me ligjin nr. 10 023, datë 27.11.2008, neni 8)*

Gjykata, për shkak të rrezikshmërisë së pakët të personit dhe të rrethanave të kryerjes së veprës penale, kur ka caktuar një dënim gjer në një vit burgim, mund të vendosë pezullimin e ekzekutimit të vendimit me burgim dhe zëvendësimin e tij me detyrimin që i dënuari të përmbushë një punë në interes publik.

Puna me interes publik nënkupton kryerjen nga i dënuari të një pune, me pëlqimin e tij dhe pa shpërblim, në favor të interesit publik apo shoqatës së caktuar në vendimin e gjykatës, për një kohë nga dyzet deri në dyqind e dyzet orë.

Ky detyrim nuk mund të vendoset kur i dënuari refuzon pezullimin në seancë gjyqësore.

Puna në interes publik kryhet brenda afatit prej gjashtë muajsh.

Në vendimin e saj gjykata përcakton numrin e orëve të punës dhe detyrimin që i dënuari të mbajë kontakte me shërbimin e provës. Shërbimi i provës vendos llojin e punës që do të kryhet, përcakton vendin e kryerjes së punës dhe ditët e javës kur do të kryhet ajo, duke pasur parasysh, për aq sa është e mundur, punësimin e rregullt të të dënuarit apo detyrimet e tij familjare. Kohëzgjatja e punës me interes publik nuk i kalon tetë orë në ditë.

Pas përfundimit të punës, dënimi konsiderohet i paqenë.

Nëse i dënuari nuk kryen punën me interes publik, nuk mban kontakte me shërbimin e provës apo shkel kushtet ose detyrimet e tjera, të vendosura nga gjykata, prokurori informon menjëherë gjykatën. Gjykata, në këtë rast, vendos sipas nenit 62 të këtij Kodi.

#### Neni 64

##### **Lirimi me kusht**

*(Ndryshuar me ligjin nr.8733, datë 24.1.2001, neni 7;  
ndryshuar me ligjin nr. 10 023, datë 27.11.2008, neni 9)  
(Shtuar me ligjin 144/2013, datë 2.5.2013, neni 12)*

I dënuari me burgim mund të lirohet me kusht, nga vuajtja e dënimit vetëm për arsye të veçanta, nëse me sjelljen dhe punën e tij tregon se me dënimin e vuajtur i është arritur qëllimit për edukimin e tij, si dhe të ketë vuajtur:

- jo më pak se gjysmën e dënimit të dhënë për kundërvajtje penale;
- jo më pak se dy të tretat e dënimit të dhënë për krime me masa dënimi gjër në pesë vjet burgim;
- jo më pak se tre të katërtat e dënimit të dhënë për krime me masa dënimi nga pesë gjër në njëzet e pesë vjet burgim.

Në masën e dënimit të vuajtur nuk llogaritet koha e përfutur me amnisti ose falje.

Nuk lejohet lirimi me kusht për të dënuarin përsëritës për krime të kryera me dashje si dhe për të dënuarit për kryerjen e veprave penale të parashikuara në nenet 78/a, 79/a, 79/b, 79/c apo paragrafi i tretë i nenit 100.

Lirimi me kusht revokohet nga gjykata, kur i dënuari për një vepër penale të kryer me dashje, gjatë kohës së kushtit, kryen një vepër tjetër penale me dashje, duke u zbatuar dispozitat për bashkimin e dënimeve.

#### Neni 65

*(Ndryshuar paragrafi I, II me ligjin nr.10 023, datë 27.11.2008, neni 10)*

Nuk lejohet lirimi me kusht për të dënuarin me burgim të përjetshëm.

Vetëm në raste të jashtëzakonshme i dënuari me burgim të përjetshëm mund të lirohet me kusht kur:

Ka vuajtur jo më pak se njëzet e pesë vjet burgim dhe, gjatë vuajtjes së dënimit ka mbajtur sjellje shembullore dhe çmohet se i është arritur qëllimit të dënimit për edukimin e tij.

#### Neni 65/a

##### **Periudha e sigurisë**

*(Shtuar me ligjin nr.23/2012, datë 1.3.2012, neni 9)*

Gjykata, në dhënien e vendimit, mund të vendosë edhe caktimin e një periudhe sigurie, gjatë së cilës nuk lejohet zbatimi i nenit 64 të këtij Kodi, në rastet kur ekziston një nga këto rrethana:

- a) vepra penale, masa e dënimit të së cilës është mbi pesë vjet;
  - b) kryerja e veprës penale është bërë me egërsi dhe mizori;
  - c) kur vepra është kryer kundër fëmijëve, grave shtatzëna ose personave që, për shkaqe të ndryshme, nuk mund të mbrohen;
  - ç) kur vepra është kryer duke përfituar nga marrëdhëniet familjare ose të bashkëjetesës;
  - d) kur kryerja e veprës penale është shtyrë nga motive që kanë të bëjnë me gjininë, racën, fenë, kombësinë, gjuhën, bindjet politike, fetare ose sociale.
- Periudha e sigurisë shtrihet për afatin kohor nga tre të katërtat e dënimit të dhënë nga gjykata deri në kohëzgjatjen e plotë të dënimit penal.

## KREU VIII SHUARJA E NDJEKJES PENALE, TË DËNIMEVE DHE MOSEKZEKUTIMI I TYRE

### Neni 66

#### **Parashkrimi i ndjekjes penale**

Nuk mund të bëhen ndjekje penale kur nga kryerja e veprës deri në çastin e marrjes së personit si të pandehur kanë kaluar:

- a) njëzet vjet për krimet që parashikojnë dënim jo më të ulët se dhjetë vjet burgim ose dënim tjetër më të rëndë;
- b) dhjetë vjet për krimet që parashikojnë dënim nga pesë gjer në dhjetë vjet burgim;
- c) pesë vjet për krimet që parashikojnë dënim gjer në pesë vjet burgim ose gjobë;
- ç) tre vjet për kundërvajtjet penale që parashikojnë dënim gjer në dy vjet burgim;
- d) dy vjet për kundërvajtjet penale që parashikojnë dënim me gjobë.

### Neni 67

#### **Mosparashkrimi i ndjekjes penale**

Nuk i nënshtrohen parashkrimit të ndjekjes penale krimet e luftës dhe ato kundër njerëzimit.

### Neni 68

#### **Parashkrimi i ekzekutimit të dënimit**

Vendimi i dënimit nuk ekzekutohet kur nga dita që ka marrë formë të prerë kanë kaluar:

- a) njëzet vjet për vendimin që përmban dënim pesëmbëdhjetë gjer në njëzetepesë vjet burgim;
- b) dhjetë vjet për vendimin që përmban dënim pesë gjer në pesëmbëdhjetë vjet burgim;
- c) pesë vjet për vendime që përmbajnë dënim me burgim gjer në pesë vjet ose dënime të tjera më të lehta.

*Në kreun e VIII-të të Kodit Penal ligjvënësi ka parashikuar një institut më vete në lidhje me shuarjen e ndjekjes penale, të dënimeve dhe mosekzekutimin e tyre.*

*Brenda kuadrit të këtij instituti janë përfshirë dispozita të veçanta në lidhje me parashkrimin e ndjekjes penale, (neni 66 i K.Penal); në lidhje me parashkrimin e ekzekutimit të dënimit, (neni 68 i Kodit Penal) dhe shuarjen e dënimit ose, sikurse e ka emërtuar vetë ligjvënësi, rehabilitimin, (neni 69 i Kodit Penal).*

*Këto dispozita përmbajnë rregullimin ligjor të këtij instituti në tre aspekte të veçanta të tij.*

*Kështu, dispozita e nenit 66 të Kodit Penal bën fjalë për parashkrimin e ndjekjes penale me të cilin duhet kuptuar ndalimi që ekziston me ligj për të bërë ndjekje penale, në qoftë se, nga koha kur është kryer vepra penale, deri në momentin e marrjes si të pandehur të autorit të saj, kanë kaluar afatet e parashikuara në këtë dispozitë.*

*Në dispozitën e nenit 68 të Kodit Penal ligjvënësi ka parashikuar afatet, me kalimin e të cilëve, vendimi i dënimit, dhënë ndaj një personi për vepra penale të kryera prej tij, nuk mund të ekzekutohet më.*

*Kurse në dispozitën e nenit 69 të Kodit Penal janë parashikuar afatet, me kalimin e të cilave, personi i dënuar për vepra penale të kryera prej tij, do të quhet i padënuar ose, siç e ka vetë ligji i rehabilituar.*

*Nga sa u parashtrua shkurtimisht më lart, arrihet në përfundimin se, në rastin e parë, (neni 66 i Kodit Penal) ndodhemi para rastit të parashkrimit të së drejtës së organeve kompetente të ndjekjes penale; në rastin e dytë (neni 68 i Kodit Penal), ndodhemi para parashkrimit të së drejtës së organeve kompetente shtetërore, të ngarkuara me ekzekutimin e vendimeve të dënimit për të ekzekutuar këto vendime. Kurse, në rastin e tretë, (neni 69 i Kodit Penal) ndodhemi para shuarjes së dënimit të dhënë ndaj një personi për vepra penale të kryera prej tij d.m.th., para rehabilitimit të këtij personi që sjell si pasojë ndryshimin e gjendjes gjyqësore të tij, nga i dënuar në i padënuar.*

*Çështja objekt gjykimi në Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë ka të bëjë me aspektin e dytë të institutit të parashkrimit, d.m.th. me parashkrimin e ekzekutimit të dënimit, parashikuar nga neni 68 i Kodit Penal.*

*Nga përmbajtja e kësaj dispozite, del se vendimi i dënimit nuk ekzekutohet kur nga dita që ka marrë formë të prerë kanë kaluar: njëzet vjet për vendimin që përmban dënim pësëmbëdhjetë gjer në njëzetëpesë vjet; dhjetë vjet për vendimin që përmban dënim pesë gjer në pësëmbëdhjetë vjet dhe pesë vjet për vendime që përmbajnë dënim me burgim gjer në pesë vjet ose dënime të tjera më të lehta.*

*Duket qartë se, ligjvënësi, nëpërmjet kësaj dispozite, ka vënë përpara organeve kompetente shtetërore të ngarkuara me ekzekutimin e vendimeve të dënimit një kufizim kohor brenda të cilit këto organe kanë të drejtë që të vënë në ekzekutim një vendim penal të formës së prerë. Ky kufizim kohor, përbën në të njëjtën kohë edhe një ndalim të shprehur për këto organe, i cili nuk u lejon atyre që të ekzekutojnë vendime penale tej afateve të përcaktuara, sipas rastit, në shkronjat “a”, “b” dhe “c” të dispozitës së nenit 68 të Kodit Penal.*

*Qëllimi i ligjvënësit në vendosjen e këtij kufizimi kohor dhe ndalimi ka qenë së pari, realizimi në praktikë i efektit të përgjithshëm dhe të veçante parandalues të dënimit në çdo rast konkret dhe së dyti, disiplinimi i procesit të ekzekutimit të vendimeve të dënimit në përgjithësi dhe në mënyrë të veçantë në rastet kur personi i dënuar, për njërën apo tjetrën arsye i shmanget apo i fshihet këtij procesi.*

*Të drejtën dhe njëkohësisht detyrën që kanë organet kompetente shtetërore, të ngarkuara me ekzekutimin e vendimeve të dënimit, ligjvënësi ë ka kushtëzuar së pari me momentin kur vendimi i dënimit ka marrë formën e prerë dhe së dyti, në vartësi të masave dhe llojeve të dënimit të dhënë, me afatet, (njëzet, dhjetë dhe pesë vjet), që parashikohen në dispozitën e përmendur të Kodit Penal.*

*Nga sa u parashtruan në paragrafin e mësipërm, arrihet në përfundimin se, organet kompetente shtetërore të ngarkuara me ekzekutimin e vendimeve të dënimit, kanë të drejtë dhe njëkohësisht detyrë që menjëherë, sapo vendimi i dënimit të ketë marrë formë të prerë, ta vënë në ekzekutim atë.*

*Këtë të drejtë ato vazhdojnë ta kenë derisa pa u plotësuar akoma afatet, njëzet, dhjetë dhe pesë vjet të parashikuara respektivisht nga shkronjat “a”, “b” dhe “c” të nenit 68 të Kodit Penal.*

*Nga kjo del se vendimi i dënimit nuk mund të ekzekutohet as para se ai të ketë marrë formë të prerë, as pasi të jenë plotësuar afatet njëzet, dhjetë dhe pesë vjet që u përmendën dhe kjo përbën ndalimin që u përmend më lart.*

*Nga leximi i vetë tekstit të dispozitës së nenit 68 të Kodit Penal shihet fare qartë që ligjvënësi jo vetëm që nuk ka parashikuar, por as ka lënë të nënkuptohet se ekzistojnë shkaqe apo faktorë që mund të sjellin si pasojë zgjatjen e afateve të parashkrimit që janë parashikuar prej tij në lidhje me ekzekutimin e vendimit të dënimit.*

*Gjykata e shkallës së parë Elbasan dhe Gjykata e Apelit Durrës e kanë rrëzuar kërkesën e të dënuarit Blerim Llukani me arsyetimin: “se me datë 13.3.1997 është ndërprerë vuajtja e dënimit”. Ky konkluzion i gjykatave nuk gjen mbështetje në asnjë dispozitë ligjore të së drejtës penale. Në Kodin Penal dhe në Kodin e Procedurës Penale nuk parashikohet ndërprerja e ekzekutimit të vendimeve. Megjithëse në legjislationin penal shqiptar nuk parashikohet ndërprerja e ekzekutimit të vendimit, gjykatat i referohen parimeve të përgjithshme të së drejtës e sidomos të drejtës civile që e parashikon ndërprerjen si një institut ligjor. Një qëndrim i tillë vjen në kundërshtim me parimet e Kodit Penal shqiptar. Në të drejtën penale shqiptare është sanksionuar: “Kodi Penal bazohet në parimet kushtetuese të shtetit të së drejtës, të barazisë përpara ligjit, të drejtësisë në caktimin e fajësisë dhe të dënimit, si dhe të humanizmit. Zbatimi i ligjit penal me analogji nuk lejohet.*

---

#### Neni 69 **Rehabilitimi**

Quhen të padënuar:

- a) ata që janë dënuar me burgim për një kohë gjer në gjashtë muaj ose me çdo dënim tjetër më të lehtë dhe që gjatë dy vjetëve nga dita e vuajtjes së dënimit nuk kanë kryer vepër tjetër penale;
- b) ata që janë dënuar me burgim për një kohë nga gjashtë muaj gjer në pesë vjet dhe që gjatë pesë vjetëve nga dita e vuajtjes së dënimit nuk kanë kryer vepër tjetër penale;
- c) ata që janë dënuar me burgim për një kohë nga pesë gjer në dhjetë vjet dhe që gjatë shtatë vjetëve nga dita e vuajtjes së dënimit nuk kanë kryer vepër tjetër penale;
- ç) ata që janë dënuar me burgim për një kohë nga dhjetë gjer në njëzet e pesë vjet dhe që gjatë dhjetë vjetëve nga dita e vuajtjes së dënimit nuk kanë kryer vepër tjetër penale.

#### Neni 70 **Falja**

Me aktin e faljes organi kompetent përjashton tërësisht apo pjesërisht personin nga vuajtja e dënimit të dhënë me një vendim gjyqësor ose bën zëvendësimin e dënimit me një lloj dënimi më të butë.

#### Neni 71 **Amnistia**



Me aktin e amnistisë organi kompetent përjashton nga ndjekja penale, nga vuajtja tërësisht apo pjesërisht e dënimit ose bën zëvendësimin e dënimit me një lloj dënimi më të butë.

Amnistia shtrihet për ato vepra penale të kryera deri një ditë para shpalljes së saj, veç rastit kur në aktin përkatës vendoset ndryshe.

Neni 72

### **Zbatimi i dispozitave të pjesës së përgjithshme**

Dispozitat e pjesës së përgjithshme të këtij Kodi zbatohen edhe për veprat penale të tjera të parashikuara si të tilla nga ligje të veçanta.

## **PJESA E POSAÇME**

KREU I

### **KRIME KUNDËR NJERËZIMIT**

Neni 73

#### **Genocidi**

*(Ndryshuar me ligjin nr.8733, datë 24.1.2001, neni 79)*

Zbatimi i një plani të paramenduar që synon shkatërrimin tërësisht apo pjesërisht të një grupi nacional, etnik, racial apo fetar i drejtuar kundër anëtarëve të grupit dhe i shoqëruar me veprat që vijnë, si: vrasje me dashje të anëtarëve të grupit, dëmtime të rënda fizike dhe psikike, vendosja në kushte jetese të rënda që shkaktojnë shkatërrimin fizik, zbatimi i masave që synojnë pengimin e lindjeve, si dhe transferimi i detyrueshëm i fëmijëve të një grupi në një grup tjetër, dënohet me burgim jo më pak se dhjetë vjet ose me burgim të përjetshëm.

Neni 74

#### **Krime kundër njerëzimit**

*(Ndryshuar me ligjin nr.8733, datë 24.1.2001, neni 8)*

*(Ndryshuar me ligjin 144/2013, datë 2.5.2013, neni 13)*

Vrasjet, zhdukja me forcë, shfarosjet, kthimi në skllëvër, internimet dhe dëbimet, si dhe çdo lloj torture ose dhune tjetër njerëzore, të kryera, sipas një plani konkret të paramenduar, ose në mënyrë sistematike, kundër një grupi të popullsisë civile, për motive politike, ideologjike, raciale, etnike e fetare dënohen jo më pak se pesëmbëdhjetë vjet ose me burgim të përjetshëm.

Neni 74/a

#### **Shpërndarja kompjuterike e materialeve pro gjenocidit ose krimeve kundër njerëzimit**

*(Shtuar me ligjin nr.10 023, datë 27.11.2008, neni 11)*

Vrasjet, zhdukja me forcë, shfarosjet, kthimi në skllëvër, internimet dhe dëbimet, si dhe çdo lloj torture ose dhune tjetër njerëzore, të kryera, sipas një plani konkret të paramenduar, ose në mënyrë sistematike, kundër një grupi të popullsisë civile, për motive politike, ideologjike, raciale, etnike e fetare dënohen jo më pak se pesëmbëdhjetë vjet ose me burgim të përjetshëm.

Neni 75

**Krimet e luftës**

*(Ndryshuar me ligjin nr.8733, datë 24.1.2001, neni 79)*

Veprat e kryera nga persona të ndryshëm në kohë lufte, si vrasja, keqtrajtimi ose dëbimi për punë skllavëruese, si dhe për çdo lloj shfrytëzimi tjetër çnjerëzor në dëm të popullsisë civile ose në territor të pushtuar, vrasja ose keqtrajtimi i robërve të luftës, vrasja e pengjeve, shkatërrimi i pasurisë private ose publike, shkatërrimi i qyteteve, komunave ose fshatrave, jo të diktuar nga nevoja ushtarake, dënohet me heqje të lirisë jo më pak se pesëmbëdhjetë vjet ose me burgim të përjetshëm.

KREU II

VEPRA PENALE KUNDËR PERSONIT

KRIME KUNDËR JETËS

SEKSIONI I

KRIME KUNDËR JETËS TË KRYERA ME DASHJE

Neni 76

**Vrasja me dashje**

Vrasja e kryer me dashje dënohet me burgim nga dhjetë gjer në njëzet vjet.

Neni 77

**Vrasja me dashje në lidhje me një krim tjetër**

*(Ndryshuar me ligjin nr. 8733, datë 24.1.2001, neni 9)*

Vrasja me dashje, që paraprin, shoqëron, fsheh ose pason një krim tjetër, dënohet me burgim jo më pak se njëzet vjet.

Neni 78

**Vrasja me paramendim**

*(Ndryshuar me ligjin nr.8733, datë 24.1.2001, neni 10;  
shtesë në paragrafin e dytë me ligjin nr.9686, datë 26.2.2007, neni 7)  
(Ndryshuar paragrafi i II me ligjin 144/2013, datë 2.5.2013, neni 14)*

Vrasja me paramendim dënohet me burgim nga pesëmbëdhjetë gjer në njëzet e pesë vjet.

Vrasja e kryer për interes apo hakmarrje dënohet me burgim jo më pak se njëzet vjet ose me burgim të përjetshëm.

Neni 78/a

**Vrasja për gjakmarrje**

*(Shtuar neni me ligjin 144/2013, datë 2.5.2013, neni 15)*

Vrasja me dashje për gjakmarrje dënohet me burgim jo më pak se tridhjetë vjet ose me burgim të përjetshëm.

Neni 79

**Vrasja në rrethana të tjera cilësuese**

*(Ndryshuar me ligjin nr.8733, datë 24.1.2001, neni 11;  
ndryshuar shkronja "c" me ligjin nr.9275, datë 16.9.2004, neni 9)  
(Shfuqizuar shkronja "c" me ligjin 144/2013, datë 2.5.2013, neni 48)*

Vrasja me dashje e kryer:

- a) ndaj të miturit;
- b) ndaj personit me mangësi fizike ose psikike, të sëmurë rëndë ose shtatzënë, kur cilësitë e viktimës janë të dukshme ose të njohura;
- c) *shfuqizuar*
- ç) ndaj kallëzuesit, dëshmitarit, të dëmtuarit ose palëve të tjera ndërgjyqëse;
- d) më shumë se një herë;
- dh) kundër dy ose më shumë personave;
- e) në mënyrë të tillë që i shkakton mundime të veçanta viktimës;
- ë) në mënyrë të rrezikshme për jetën e shumë personave, dënohet me burgim jo më pak se njëzet vjet ose me burgim të përjetshëm.

Neni 79/a

**Vrasja e funksionarëve publikë**

*(Shtuar neni me ligjin 144/2013, datë 2.5.2013, neni 16)*

Vrasja me dashje e deputetit, gjyqtarit, prokurorit, avokatit, ushtarakut apo e funksionarëve të tjerë publikë, gjatë detyrës ose për shkak të saj, kur cilësitë e viktimës janë të dukshme ose të njohura, dënohet me burgim jo më pak se tridhjetë vjet ose me burgim të përjetshëm.

Neni 79/b

**Vrasja e punonjësve të Policisë së Shtetit**

*(Shtuar neni me ligjin 144/2013, datë 2.5.2013, neni 16)*

Vrasja me dashje e punonjësve të Policisë së Shtetit, gjatë detyrës ose për shkak të saj, kur cilësitë e viktimës janë të dukshme ose të njohura, dënohet me burgim jo më pak se tridhjetë vjet ose me burgim të përjetshëm.

Neni 79/c

**Vrasja për shkak të marrëdhënieve familjare**

*(Shtuar neni me ligjin 144/2013, datë 2.5.2013, neni 16)*

Vrasja me dashje e personit që është bashkëshort, ish-bashkëshort, bashkëjetues apo ish-bashkëjetues, gjini e afërt ose krushqi e afërt me autorin e veprës penale, dënohet me burgim jo më pak se njëzet vjet ose me burgim të përjetshëm.

Neni 80

Sigurimi i kushteve dhe i mjeteve materiale për të kryer vrasje dënohet me burgim gjer në pesë vjet.

Neni 81

**Vrasja e foshnjës**

*(Ndryshuar neni me ligjin 144/2013, datë 2.5.2013, neni 17)*

Vrasja e foshnjës e kryer me dashje nga nëna, menjëherë pas lindjes, dënohet me burgim deri në pesë vjet.

Neni 82

**Vrasja e kryer në gjendje të tronditjes së fortë psikike**

Vrasja me dashje e kryer në gjendje të tronditjes së fortë psikike të çastit shkaktuar nga dhuna ose fyerja e rëndë e viktimës dënohet me burgim gjer në tetë vjet.

Neni 83

**Vrasja e kryer me kapërcim të kufijve të mbrojtjes së nevojshme**

Vrasja e kryer në kushtet e kapërcimit të kufijve të mbrojtjes së nevojshme dënohet me burgim gjer në shtatë vjet.

Neni 83/a

**Kanosja serioze për hakmarrje ose për gjakmarrje**

*(Shtuar me ligjin nr.8733, datë 24.1.2001, neni 12;*

*ndryshuar me ligjin nr.9686, datë 26.2.2007, neni 8)*

*(Shfuqizuar me ligjin nr.144/2013, datë 2.5.2013, neni 48)*

Kanosja serioze për hakmarrje ose gjakmarrje, që i bëhet një personi për t'u mbyllur në shtëpi, dënohet me burgim deri në tre vjet.

Neni 83/b

**Nxitja për gjakmarrje**

*(Shtuar me ligjin nr.9686, datë 26.2.2007, neni 9)*

*(Shfuqizuar me ligjin nr.144/2013, datë 2.5.2013, neni 48)*

Nxitja e të tjerëve për hakmarrje ose gjakmarrje, kur nuk përbën vepër tjetër penale, dënohet me burgim deri në tre vjet.

Neni 84

**Kanosja**

Kanosja serioze për vrasje ose për plagosje të rëndë që i bëhet një personi, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në një vit.

Neni 84/a

**Kanosja me motive racizimi dhe ksenofobie nëpërmjet sistemit kompjuterik**

*(Shtuar me ligjin nr.10 023, datë 27.11.2008, neni 12)*

Kanosja serioze për vrasje ose plagosje të rëndë, që i bëhet një personi, nëpërmjet sistemeve kompjuterike, për shkak përkatësie etnike, kombësie, race apo feje, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre vjet.

SEKSIONI II  
KRIME KUNDËR JETËS SHKAKTUAR ME PAKUJDESI

Neni 85

**Vrasja nga pakujdesia**

Vrasja e kryer nga pakujdesia dënohet me gjobë ose me burgim gjer në pesë vjet.

SEKSIONI III  
VEPRAT PENALE TË KRYERA ME DASHJE  
KUNDËR SHËNDETIT

Neni 86

**Tortura**

*(Ndryshuar me ligjin nr.9686, datë 26.2.2007, neni 10;  
ndryshuar me ligjin nr.23/2012, datë 1.3.2012, neni 56)*

Kryerja me dashje e veprave, nëpërmjet të cilave një personi i janë shkaktuar vuajtje të rënda, fizike apo mendore, nga një person, që ushtron funksione publike, ose me nxitjen apo miratimin e tij, të hapur ose të heshtur, me qëllim:

- a) për të marrë prej tij ose një tjetri informata ose pohime;
  - b) për ta ndëshkuar për një veprim të kryer ose që dyshohet të jetë kryer prej/ose një personi tjetër;
  - c) për ta frikësuar ose bërë presion mbi të ose një person tjetër;
  - ç) për çdo qëllim tjetër të bazuar në çfarëdolloj forme diskriminimi;
  - d) çdo akt tjetër çnjerëzor apo poshtërues;
- dënohen me burgim nga katër deri në dhjetë vjet.

Neni 87

**Tortura me pasoja të rënda**

Tortura, si dhe çdo akt tjetër çnjerëzor, kur ka sjellë gjymtimin, shëmtimin ose çdo dëmtim të përhershëm të shëndetit të personit apo vdekjen, dënohen me burgim nga dhjetë gjer në njëzet vjet.

Neni 88

**Plagosja e rëndë me dashje**

*(Ndryshuar paragrafi i II me ligjin 144/2013, datë 2.5.2013, neni 18)*

Plagosja e kryer me dashje që ka sjellë si pasojë gjymtimin, shëmtimin ose çdo dëmtim tjetër të përhershëm të shëndetit, ndërprerjen e shtatzanisë, ose ka qenë e rrezikshme për jetën në çastin e shkaktimit të saj, dënohet me burgim nga tre gjer në dhjetë vjet.

Po kjo vepër, kur është kryer kundër disa personave, kundër personit që është bashkëshort, ish-bashkëshort, bashkëjetues apo ish-bashkëjetues, gjini e afërt ose krushqi e afërt me autorin e veprës penale, ose kur ka sjellë si pasojë vdekjen, dënohet me burgim nga pesë deri në pesëmbëdhjetë vjet.

Neni 88/a

**Plagosje e rëndë në gjendje të tronditjes së fortë psikike**

*(Shtuar me ligjin nr.8733, datë 24.1.2001, neni 13)*

Plagosja e rëndë, e kryer në gjendje të tronditjes të fortë psikike të çastit, shkaktuar nga dhuna ose fyerja e rëndë nga ana e të dëmtuarit, dënohet me burgim gjer në pesë vjet.

Neni 88/b

**Plagosje e rëndë me kapërcim të kufijve të mbrojtjes së nevojshme**

*(Shtuar me ligjin nr.8733, datë 24.1.2001, neni 13)*

Plagosja e rëndë, e kryer me kapërcim të kufijve të mbrojtjes së nevojshme, dënohet me burgim gjer në tre vjet.

Neni 89

**Plagosja e lehtë me dashje**

Plagosja e kryer me dashje, që ka shkaktuar paaftësi të përkohshme në punë më tepër se 9 ditë, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në dy vjet.

Neni 89/a

*(Shtuar me ligjin nr.8204, datë 10.4.1997, neni 1)*

Shitblerja e transplanteve, si dhe çdo veprimtari që lidhet me heqjen dhe implantimin e paligjshëm të organeve, dënohet me burgim nga 3 deri në 10 vjet.

Kur këto vepra kryhen me qëllim fitimi, dënohen me burgim nga 10 deri në 20 vjet.

Neni 90

**Dëmtime të tjera me dashje**

Rrahja, si dhe çdo vepër tjetër dhune, përbën kundërvajtje penale dhe dënohen me gjobë.

Po kjo vepër, kur ka shkaktuar paaftësi të përkohshme në punë deri në 9 ditë, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në gjashtë muaj.

SEKSIONI IV  
VEPRA PENALE KUNDËR SHËNDETIT TË KRYERA  
NGA PAKUJDESIA

Neni 91

**Plagosja e rëndë nga pakujdesia**

Plagosja e rëndë e kryer nga pakujdesia përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në një vit.

Neni 92

**Plagosja e lehtë nga pakujdesia**

Plagosja e lehtë e kryer nga pakujdesia përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë.

SEKSIONI V  
VEPRA PENALE QË RREZIKOJNË JETËN DHE SHËNDETIN NGA NDËRPRERJA E  
SHTATZANISË OSE MOSDHËNIA  
E NDIHMËS

Neni 93

**Ndërprerja e shtatzënisë pa pëlqim të gruas**

Ndërprerja e shtatzënisë pa pëlqim të gruas, veç rastit kur ndërprerja diktohet nga një shkak shëndetësor i justifikuar, dënohet me gjobë ose me burgim gjer në pesë vjet.

Neni 94

**Ndërprerja e shtatzënisë e kryer në vende dhe nga persona  
të paautorizuar**

Ndërprerja e shtatzënisë e kryer jo në ambiente spitalore publike apo klinika private të lejuara posaçërisht, ose nga një person që nuk është mjek ose, tej kohës së lejueshme për ndërprerje veç rastit kur kjo diktohet nga një shkak shëndetësor i justifikuar, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në dy vjet.

Kur nga vepra është shkaktuar rrezikimi i jetës ose vdekja, dënohet me gjobë ose me burgim gjer në pesë vjet.

Neni 95

**Dhënia e mjeteve për ndërprerjen e shtatzënisë**

Dhënia e mjeteve që shërbejnë për ndërprerjen e shtatzënisë një gruaje me qëllim që kjo të kryejë vetë ose me ndihmën e ndonjë tjetri ndërprerje, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në një vit.

Neni 96

### **Mjekimi i pakujdesshëm**

*(Shtuar paragrafi i II me ligjin nr.8733, datë 24.1.2001, neni14)*

Mjekimi i pakujdesshëm i të sëmurëve nga ana e mjekut ose e personelit tjetër mjekësor, si dhe moszbatimi i terapisë ose i porosive të mjekut nga personeli mjekësor apo farmacist, kur ka shkaktuar dëmtimin e rëndë të shëndetit, ka rrezikuar jetën e personit ose ka shkaktuar vdekjen e tij, dënohet me gjobë ose me burgim gjer në pesë vjet.

Po kjo vepër, kur ka shkaktuar infektimin e të sëmurëve me infeksionin HIV/AIDS, dënohet me burgim nga tre gjer në shtatë vjet.

Neni 97

### **Mosdhënia ndihmë**

Mosdhënia e ndihmës, pa shkaqe të arsyeshme nga ana e personit që me ligj ose për shkak të detyrës detyrohej ta jepte atë, kur si pasojë e saj është shkaktuar dëmtimi i rëndë i shëndetit, rrezikimi i jetës ose vdekja, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në dy vjet.

Neni 98

### **Mosdhënia e ndihmës nga kapiteni i anijes**

Mosdhënia e ndihmës nga kapiteni i anijes njerëzve që janë duke u mbytur në det ose në ujëra të tjera, kur kjo ndihmë mund të jepej pa rrezik serioz për anijen, ekuipazhin dhe udhëtarët, dënohet me gjobë ose me burgim gjer në katër vjet.

Neni 99

### **Shkaktimi i vetëvrasjes**

*(Ndryshuar me ligjin 144/2013, datë 2.5.2013, neni 19)*

Shkaktimi i vetëvrasjes ose i tentativës së vetëvrasjes të një personi, si rrjedhojë e trajtimit të keq sistematik ose nga sjellje të tjera sistematike që prekin rëndë dinjitetin, të kryera nga personi që e ka në varësi apo nga personi me të cilin ka marrëdhënie familjare ose bashkëjetese, dënohet me burgim nga tre deri në shtatë vjet.

## **SEKSIONI VI KRIME SEKSUALE**

Neni 100

### **Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me të mitur**

*(Ndryshuar me ligjin nr.8733, datë 24.1.2001, neni 15)*

*(Ndryshuar me ligjin 144/2013, datë 2.5.2013, neni 20)*



Kryerja e marrëdhënieve seksuale ose homoseksuale me fëmijë të mitur, që nuk ka arritur moshën katërbëdhjetë vjeç ose me të miturën që nuk ka arritur pjekurinë seksuale, dënohet me burgim nga shtatë gjer në në pesëmbëdhjetë vjet.

Kur marrëdhënia seksuale ose homoseksuale kryhet në bashkëpunim, më shumë se një herë ose me dhunë, ose kur i janë shkaktuar fëmijës së dëmtuar pasoja të rënda për shëndetin, dënohet me burgim jo më pak se njëzet e pesë vjet.

Kur vepra ka sjellë si pasojë vdekjen ose vetëvrasjen e fëmijës së mitur dënohet me burgim dënohet me burgim jo më pak se tridhjetë vjet ose me burgim të përjetshëm.

#### Neni 101

##### **Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me dhunë me të mitur të moshës 14-18 vjeç**

*(Ndryshuar me ligjin nr.8733, datë 24.1.2001, neni 16)*

Kryerja e marrëdhënieve seksuale ose homoseksuale, me dhunë, me fëmijë të mitur në moshën katërbëdhjetë gjer në tetëmbëdhjetë vjeç dhe që ka arritur pjekurinë seksuale, dënohet me burgim nga pesë gjer në pesëmbëdhjetë vjet.

Kur marrëdhënia seksuale ose homoseksuale, me dhunë, kryhet në bashkëpunim ose më shumë se një herë, ose kur fëmijës së dëmtuar i shkaktohen pasoja të rënda për shëndetin, dënohet me burgim nga dhjetë gjer në njëzet vjet.

Kur vepra ka sjellë si pasojë vdekjen ose vetëvrasjen e fëmijës së mitur dënohet me burgim jo më pak se njëzet vjet.

#### Neni 102

##### **Marrëdhënie seksuale me dhunë me të rritura**

*(Ndryshuar paragrafi i I, II me ligjin nr.8733, datë 24.1.2001 dhe neni 17)*

*(Ndryshuar paragrafi i I me ligjin 144/2013, datë 2.5.2013, neni 21)*

Kryerja e marrëdhënieve seksuale me dhunë, me të rritura ose midis bashkëshortëve apo bashkëjetuesve, pa pëlqimin e njërit prej tyre, dënohet me burgim nga tre gjer në dhjetë vjet.

Kur marrëdhënia seksuale me dhunë kryhet në bashkëpunim ose më shumë se një herë, ose kur të dëmtuarës i shkaktohen pasoja të rënda për shëndetin, dënohet me burgim nga pesë gjer në pesëmbëdhjetë vjet.

Kur vepra ka sjellë si pasojë vdekjen ose vetëvrasjen e të dëmtuarës, dënohet me burgim nga dhjetë gjer në njëzet vjet.

#### Neni 102/a

##### **Marrëdhëniet homoseksuale me dhunë me të rritur**

*(Shtuar me ligjin nr.8733, datë 24.1.2001, neni 18;*

*ndryshuar me ligjin nr.23/2012, datë 1.3.2012, neni 10)*

Kryerja e marrëdhënieve homoseksuale me dhunë me të rritur dënohet me burgim nga tre gjer në shtatë vjet.

Kur marrëdhënia homoseksuale me dhunë kryhet në bashkëpunim ose më shumë se një herë, ose kur të dëmtuarit i shkaktohen pasoja të rënda për shëndetin, dënohet me burgim nga pesë gjer në dhjetë vjet.

Kur vepra ka sjellë si pasojë vdekjen ose vetëvrasjen e të dëmtuarit dënohet me burgim nga dhjetë gjer në njëzet vjet.

Neni 103

**Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me persona  
të pazotë për t'u mbrojtur**

*(Ndryshuar me ligjin nr.8733, datë 24.1.2001, neni 19)*

Kryerja e marrëdhënieve seksuale ose homoseksuale, duke përfituar nga pazotësia fizike ose mendore e personit të dëmtuar ose, nga vendosja në gjendje të pandërgjegjshme, dënohet me burgim nga pesë gjer në dhjetë vjet.

Kur marrëdhënia seksuale ose homoseksuale kryhet në bashkëpunim ose më shumë se një herë, ose kur personit të dëmtuar i shkaktohen pasoja të rënda për shëndetin, dënohet me burgim nga shtatë gjer në pesëmbëdhjetë vjet.

Kur vepra ka sjellë si pasojë vdekjen ose vetëvrasjen e personit të dëmtuar dënohet me burgim nga dhjetë gjer në njëzet vjet.

Neni 104

**Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me kërcënim me përdorimin e armës**

*(Ndryshuar me ligjin nr.8733, datë 24.1.2001, neni 20)*

Kryerja e marrëdhënieve seksuale ose homoseksuale, duke kërcënuar personin e dëmtuar për përdorim aty për aty të armës, dënohet me burgim nga pesë gjer në pesëmbëdhjetë vjet.

Neni 105

**Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale duke shpërdoruar detyrën**

*(Ndryshuar me ligjin nr.8733, datë 24.1.2001, neni 21)*

Kryerja e marrëdhënieve seksuale ose homoseksuale duke shpërdoruar marrëdhëniet e varësisë ose të detyrës, dënohet me burgim gjer në tre vjet.

Neni 106

**Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me persona  
në gjini ose nën kujdestari**

*(Ndryshuar me ligjin nr.8733, datë 24.1.2001, neni 22)*

Kryerja e marrëdhënieve seksuale ose homoseksuale ndërmjet prindit dhe fëmijës, vëllait dhe motrës, ndërmjet vëllezërve, motrave, ndërmjet personave të tjerë që janë gjini në vijë të drejtë ose me persona që ndodhen në raporte kujdestarie ose të birësimit, dënohet me burgim gjer në shtatë vjet.

Neni 107

**Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale në vende publike**

*(Shtuar me ligjin nr.8733, datë 24.1.2001, neni 23)*

Kryerja e marrëdhënieve seksuale ose homoseksuale në vende publike ose në ambiente të ekspozuara nga vështrimi i njerëzve, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në një vit.

Neni 107/a

#### **Dhuna seksuale**

*(Shtuar neni me ligjin 144/2013, datë 2.5.2013, neni 22)*

Ushtrimi i dhunës seksuale, nëpërmjet kryerjes së veprimeve me natyrë seksuale në trupin e një personi tjetër me objekte, përbën veprë penale dhe dënohet me burgim nga tre deri në shtatë vjet.

Kur kjo veprë kryhet në bashkëpunim, kundër disa personave, më shumë se një herë, ose kundër fëmijëve të moshës katërbëdhjetë deri në tetëmbëdhjetë vjeç dënohet me burgim nga pesë deri në pesëmbëdhjetë vjet.

Kur kjo veprë kryhet ndaj një të mituri që nuk ka arritur moshën katërbëdhjetë vjeç apo një të mituri që nuk ka arritur pjekurinë seksuale, pavarësisht nëse kryhet me dhunë apo jo, dënohet me burgim jo më pak se njëzet vjet.

Kur kjo veprë ka sjellë si pasojë vdekjen ose vetëvrasjen e të dëmtuarit dënohet me burgim jo më pak se njëzet e pesë vjet.

Neni 108

#### **Vepra të turpshme**

*(Ndryshuar me ligjin nr.8733, datë 24.1.2001, neni 24;*

*ndryshuar me ligjin nr.23/2012, datë 1.3.2012, neni 11)*

*(Shtuar paragrafët II, III dhe IV me ligjin 144/2013, datë 2.5.2013, neni 23)*

Kryerja e veprave të turpshme me të mitur që nuk kanë arritur moshën katërbëdhjetë vjeç, dënohet me burgim nga tre gjer në shtatë vjet.

Po kjo veprë, kur kryhet ndaj një të mituri që nuk ka arritur moshën katërbëdhjetë vjeç, me të cilin autori ka marrëdhënie familjare, dënohet me burgim nga pesë deri në dhjetë vjet.”.

Përfshirja e qëllimshme si dëshmitar, në veprime me natyrë seksuale, e një të mituri që nuk ka arritur moshën katërbëdhjetë vjeç apo i një të mituri që nuk ka arritur pjekurinë seksuale, përbën veprë penale dhe dënohet me burgim nga një deri në pesë vjet.

Propozimi i bërë nga një i rritur, me çdo mjet ose formë, për të takuar një të mitur që nuk ka arritur moshën katërbëdhjetë vjeç apo një të mitur që nuk ka arritur pjekurinë seksuale, me qëllim kryerjen e ndonjëres nga veprat penale të parashikuara në këtë seksion apo në seksionin VIII të kreut II të këtij Kodi, përbën veprë penale dhe dënohet me burgim nga një deri në pesë vjet.

Neni 108/a

#### **Ngacmimi seksual**

*(Shtuar neni me ligjin 144/2013, datë 2.5.2013, neni 24)*

Kryerja e sjelljeve me natyrë seksuale, që cenojnë dinjitetin e një personi, me çdo mjet ose formë, duke krijuar një mjedis kërcënues, armiqësor, degradues, poshtërues ose ofendues, përbën veprë penale dhe dënohet me burgim nga një deri në pesë vjet.

Kur kjo vepër kryhet në bashkëpunim, kundër disa personave, më shumë se një herë, ose kundër fëmijëve, dënohet me burgim nga tre deri në shtatë vjet.

## SEKSIONI VII VEPRA PENALE KUNDËR LIRISË SË PERSONIT

Neni 109

### **Rrëmbimi ose mbajtja peng e personit**

*(Ndryshuar me ligjin nr.8733, datë 24.1.2001, neni 25;*

*shtuar me ligjin nr.9275, date 16.9.2004, neni 10)*

*(Shfuqizuar me ligjin nr.144/2013, datë 2.5.2013, neni 48)*

Rrëmbimi ose mbajtja peng e personit me qëllim për të fituar pasuri ose çdo lloj përfitimi tjetër, për të përgatitur krijimin e kushteve lehtësuese për kryerjen e një krimi, për të ndihmuar fshehjen ose largimin e autorëve ose bashkëpunëtorëve në kryerjen e një krimi, për t'iu shmangur dënimit, për të detyruar realizimin e kërkesave a kushteve të caktuara, për qëllime politike ose çdo qëllim tjetër, dënohet me burgim nga dhjetë gjer në njëzet vjet.

Po kjo vepër e kryer ndaj të miturit nën moshën 14 vjeç dënohet me burgim jo më pak se pesëmbëdhjetë vjet.

Rrëmbimi ose mbajtja peng e personit ose e të miturit nën moshën 14 vjeç, i paraprirë ose i shoqëruar me tortura fizike ose psikike, kur është kryer kundër disa personave ose më shumë se një herë, dënohet me burgim jo më pak se njëzet vjet dhe, kur është shkaktuar vdekja, me burgim të përjetshëm.

Neni 109/a

### **Rrëmbimi ose mbajtja peng e personit në rrethana lehtësuese**

*(Shtuar me ligjin nr.8733, datë 24.1.2001, neni 26)*

Kur personi i rrëmbyer ose i mbajtur peng lirohet vullnetarisht para mbarimit të shtatë ditëve nga rrëmbimi ose mbajtja peng, pa e arritur qëllimin e krimit dhe, kur ndaj personit nuk është ushtruar torturë ose dëmtime të tjera të shëndetit, dënohet me burgim nga tre gjer në pesë vjet.

Neni 109/b

### **Shtrëngimi me anë të kanosjes ose dhunës për dhënien e pasurisë**

*(Shtuar me ligjin nr.9275, date 16.9.2004, neni 11)*

*(Shfuqizuar me ligjin nr.144/2013, datë 2.5.2013, neni 48)*

Shtrëngimi me anë të kanosjes ose dhunës për të kryer ose mos kryer një veprim të caktuar, për të fituar padrejtësisht pasuri ose çdo lloj përfitimi tjetër, për vete ose për të tretë, dënohet me burgim nga dy deri në tetë vjet.

Po kjo vepër, kur kryhet duke përdorur a kërcënuar me përdorimin e armës, torturës, akteve çnjerëzore e poshtëruese që kanë shkaktuar dëmtime të shëndetit, dënohet me burgim nga shtatë deri në pesëmbëdhjetë vjet.

Kur vepra ka sjellë si pasojë vdekjen, dënohet me burgim të përjetshëm.

Neni 109/c

### **Zhdukja me forcë**

*(Shtuar neni me ligjin 144/2013, datë 2.5.2013, neni 25)*

Zhdukja me forcë, nëpërmjet arrestimit, burgimit, rrëmbimit ose çdo forme tjetër heqjeje lirie të personit, nga funksionarët publikë apo nga persona që veprojnë me autorizimin, mbështetjen ose miratimin e tyre, shoqëruar me mospranimin e faktit të heqjes së lirisë apo me fshehjen e fatit të personit ose vendit në të cilin ndodhet ai, duke i mohuar ndihmën dhe mbrojtjen e nevojshme, sipas ligjit, përbën vepër penale dhe dënohet me burgim nga shtatë deri në pesëmbëdhjetë vjet.

Eprori që:

a) ka dijëni që vartës të vendosur nën autoritetin dhe kontrollin e tij efektiv po kryejnë ose do të kryejnë zhdukje me forcë, ose nuk merr parasysh të dhëna dhe informacione që e tregojnë qartë këtë fakt;

b) ushtron përgjegjësinë dhe kontrollin e tij efektiv mbi veprimtaritë me të cilat është lidhur zhdukja me forcë; apo

c) nuk ka marrë të gjitha masat e nevojshme dhe të arsyeshme që janë në kompetencën e tij për të penguar ose ndëshkuar personin që jep autorizimin, mbështetjen dhe miratimin e zhdukjes me forcë, ose për t'ia dërguar çështjen organeve kompetente të ndjekjes penale, dënohet me burgim nga tre deri në shtatë vjet.

Kur kjo vepër kryhet kundër fëmijëve, grave shtatzëna ose personave që, për shkaqe të ndryshme, nuk mund të mbrohen, apo shoqërohet me vuajtje të rënda fizike, kryhet në bashkëpunim, kundër disa personave ose më shumë se një herë, dënohet me burgim nga dhjetë deri në njëzet vjet.

Kur kjo vepër ka sjellë si pasojë vdekjen e personit, dënohet me burgim jo më pak se tridhjetë vjet ose me burgim të përjetshëm.

Marrja e paligjshme e fëmijëve që janë subjekt i një zhdukjeje me forcë, ose e fëmijëve, babai, nëna ose përfaqësuesi ligjor i të cilëve është bërë subjekt i një zhdukjeje me forcë, apo e fëmijëve të lindur gjatë periudhës së zhdukjes me forcë, përbën vepër penale dhe dënohet me burgim nga pesë deri në dhjetë vjet.

Neni 110

### **Heqja e paligjshme e lirisë**

*(Ndryshuar paragrafi II me ligjin nr.8733, datë 24.1.2001, neni 27)*

Heqja e paligjshme e lirisë së personit përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në një vit.

Kur kjo vepër shoqërohet me vuajtje të rënda fizike, kryhet në bashkëpunim, kundër disa personave ose më shumë se një herë, dënohet me burgim nga tre gjer në shtatë vjet.

Neni 110/a

### **Trafikimi i personave të rritur**

*(Shtuar me ligjin 8733, datë 24.1.2001, neni 28;*

*ndryshuar me ligjin nr.9188, datë 12.2.2004, neni 1)*

*(Ndryshuar dhe shtuar me ligjin 144/2013, datë 2.5.2013, neni 26)*

*(Shfuqizuar me ligjin nr.144/2013, datë 2.5.2013, neni 48)*

Rekrutimi, transportimi, transferimi, fshehja ose pritja e personave nëpërmjet kërcënimit ose përdorimit të forcës apo formave të tjera të shtrëngimit, rrëmbimit, mashtrimit, shpërdorimit të detyrës ose përfitimit nga gjendja shoqërore, fizike apo psikike ose dhënies apo marrjes së pagesave ose përfitimeve për të marrë pëlqimin e personit që kontrollon një person tjetër, me qëllim shfrytëzimin e prostitucionit të të tjerëve ose formave të tjera të shfrytëzimit seksual, të punës ose shërbimeve të detyruara, të skllavërimit ose formave të ngjashme me skllavërimin, të vënies në përdorim ose transplantimit të organeve, si dhe formave të tjera të shfrytëzimit, si brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, dënohen me burgim nga tetë deri në pesëmbëdhjetë vjet.

Kur kjo veprë kryhet ndaj një personi të rritur të gjinisë femërore dënohet me burgim nga dhjetë deri në pesëmbëdhjetë vjet.

Kur kjo veprë kryhet në bashkëpunim, më shumë se një herë, shoqërohet me keqtrajtimin dhe detyrimin me dhunë fizike a psikike ndaj të dëmtuarit, për të kryer veprime të ndryshme, sjell pasoja të rënda për shëndetin, ose rrezikon jetën e tij, dënohet me burgim jo më pak se pesëmbëdhjetë vjet.

Kur kjo veprë kryhet në bashkëpunim ose më shumë se një herë, apo shoqërohet me keqtrajtimin dhe detyrimin me dhunë fizike a psikike ndaj të dëmtuarit, për të kryer veprime të ndryshme, ose sjell pasoja të rënda për shëndetin, dënohet me burgim jo më pak se pesëmbëdhjetë vjet.

Kur vepra ka sjellë si pasojë vdekjen e të dëmtuarit, dënohet me burgim jo më pak se njëzet vjet ose me burgim të përjetshëm.

Kur vepra penale kryhet nëpërmjet shfrytëzimit të funksionit shtetëror ose shërbimit publik, dënimi me burgim shtohet me  $\frac{1}{4}$  e dënimit të dhënë.

#### Neni 110/b

### **Përfitimi apo përdorimi i shërbimeve të ofruar nga personat e trafikuar**

*(Shtuar neni me ligjin 144/2013, datë 2.5.2013, neni 27)*

Përfitimi apo përdorimi i shërbimeve të ofruar nga personat e trafikuar, apo i shërbimeve që janë objekt i shfrytëzimit nga trafikimi, duke pasur dijeni që personi është i trafikuar, dënohet me burgim nga dy deri në pesë vjet.

Kur kjo veprë kryhet ndaj një fëmije dënohet me burgim nga tre deri në shtatë vjet.

#### Neni 110/c

### **Veprimet që lehtësojnë trafikimin**

*(Shtuar neni me ligjin 144/2013, datë 2.5.2013, neni 27)*

Falsifikimi, zotërimi ose sigurimi i dokumentit të identitetit, i pasaportave, i vizave ose i dokumenteve të tjera të udhëtimit apo mbajtja, heqja, fshehja, dëmtimi ose shkatërrimi i tyre, që kanë shërbyer për trafikimin e personave të rritur, por pa pasur dijeni për këtë fakt, përbën veprë penale dhe dënohet me burgim nga dy deri në pesë vjet.

Po kjo veprë, kur kryhet në bashkëpunim, më shumë se një herë, apo është kryer nga personi që ka për detyrë të lëshojë letërnjoftimin, pasaportën, vizën apo dokumentin e udhëtimit, ose ka mundësuar trafikimin e fëmijëve, dënohet me burgim nga katër deri në tetë vjet.

Po kjo veprë, kur ka sjellë pasoja të rënda, dënohet me burgim jo më pak se pesë vjet.

Neni 111

**Rrëmbimi i avionëve, anijeve dhe mjeteve të tjera**

Zotërimi dhe vënia nën kontroll e avionëve, anijeve dhe mjeteve të tjera të transportit ku ndodhen njerëz, duke përdorur dhunë ose me kërcënim me armë a mjete të tjera, dënohet me burgim nga dhjetë gjer në njëzet vjet.

Neni 112

**Dhunimi i banesës**

Hyrja ose qëndrimi në banesën e tjetrit pa pëlqim të tij përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në tre muaj.

Kur vepra është kryer me dhunë ose me kërcënim për përdorim të armës përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në një vit.

**SEKSIONI VIII**

**VEPRA PENALE KUNDËR MORALIT DHE DINJITETIT**

Neni 113

**Prostitucioni**

*(Shtuar me ligjin nr.23/2012, datë 1.3.2012, neni 12)*

Ushtrimi i prostitucionit dënohet me gjobë ose me burgim gjer në tre vjet.

Dhënia e shpërblimit për përfitim personal të prostitucionit dënohet me gjobë ose me burgim gjer në tre vjet.

Neni 114

**Shfrytëzimi i prostitucionit**

*(Ndryshohet titulli dhe shfuqizohet paragrafi II me ligjin nr.8279,*

*datë 15.1.1998, neni 2)*

*(Ndryshuar me ligjin 144/2013, datë 2.5.2013, neni 28)*

Shtytja, ndërmjetësimi ose marrja shpërblim për ushtrimin e prostitucionit dënohet me burgim nga dy deri në pesë vjet.

Po kjo vepër, kur kryhet me të mitur, ndaj disa personave, me persona me të cilët ekzistojnë lidhje të afërta gjinie, krushqie, kujdestarie, apo duke përfituar nga raportet zyrtare, ose kryhet në bashkëpunim apo më shumë se një herë, ose nga persona të ngarkuara me funksione shtetërore dhe publike, dënohet me burgim nga shtatë deri në pesëmbëdhjetë vjet.

Neni 114/a

**Shfrytëzimi i prostitucionit në rrethana rënduese**

*(Shtuar me ligjin nr.8279, datë 15.1.1998, neni 2, pika 6 dhe paragrafi i fundit ndryshuar me ligjin nr.8733, datë*

*24.1.2001, neni 29)*

*(Shfuqizuar me ligjin 144/2013, datë 2.5.2013, neni 48)*

Neni 114/b

### **Trafikimi i femrave**

*(Ndryshuar me ligjin nr.9188, datë 12.2.2004, neni 2)  
(Shfuqizuar me ligjin 144/2013, datë 2.5.2013, neni 48)*

Neni 115

### **Mbajtja e lokaleve për prostitucion**

Mbajtja, shfytëzimi, financimi, dhënia me qira e lokaleve për ushtrim të prostitucionit, dënohet me gjobë ose me burgim gjer në dhjetë vjet.

Neni 116

### **Homoseksualizmi**

*(Shfuqizuar me ligjin nr.8733, datë 24.1.2001, neni 31)*

Neni 117

### **Pornografia**

*(Shtuar paragrafi i dytë me ligjin nr.9859, datë 21.1.2008, neni 1)  
(Ndryshuar me ligjin 144/2013, datë 2.5.2013, neni 29)*

Prodhimi, shpërndarja, reklamimi, importimi, shitja e botimi i materialeve pornografike në mjediset ku ka fëmijë, me çdo mjet ose formë, përbëjnë kundërvajtje penale dhe dënohen me burgim deri në dy vjet.

Prodhimi, importimi, ofrimi, vënia në dispozicion, shpërndarja, transmetimi, përdorimi ose posedimi i pornografisë së fëmijëve, si dhe krijimi i aksesit në mënyrë të vetëdijshme në të, me çdo mjet ose formë, dënohet me burgim nga tre deri në dhjetë vjet.

Rekrutimi, përdorimi, shtrëngimi, ose bindja e një fëmije, për të marrë pjesë në shfaqje pornografike, ose marrja pjesë në shfaqje pornografike që përfshijnë fëmijët, dënohet me burgim nga pesë deri në dhjetë vjet.

Neni 118

### **Dhunimi i varreve**

Dhunimi i varrezave, varreve, nxjerrja e kufomës, si dhe vjedhja e sendeve që mund të ndodhen në to, si dhe çdo veprim tjetër që ul respektin ndaj të vdekurve, dënohen me gjobë ose me burgim gjer në pesë vjet.

Neni 119

### **Fyerja**

*(Ndryshuar paragrafi II me ligjin nr.8733, datë 24.1.2001, neni 32;  
ndryshuar me ligjin nr.23/2012, datë 1.3.2012, neni 13)*

Fyerja e qëllimshme e personit përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë nga pesëdhjetë mijë gjer në një milion lekë.

Po kjo vepër, kur kryhet botërisht, në dëm të disa personave ose më shumë se një herë, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë nga pesëdhjetë mijë gjer në tre milionë lekë.



Neni 119/a

**Shpërndarja e materialeve raciste ose ksenofobike nëpërmjet sistemit kompjuterik**

*(Shtuar me ligjin nr.10 023, datë 27.11.2008, neni 13)*

Ofrimi në publik ose shpërndarja e qëllimshme publikut, nëpërmjet sistemeve kompjuterike, e materialeve me përmbajtje raciste ose ksenofobike përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim deri në dy vjet.

Neni 119/b

**Fyerja me motive racizmi ose ksenofobie nëpërmjet sistemit kompjuterik**

*(Shtuar me ligjin nr.10 023, datë 27.11.2008, neni 13)*

Fyerja e qëllimshme publike, nëpërmjet sistemit kompjuterik, që i bëhet një personi, për shkak të përkatësisë etnike, kombësisë, racës apo fesë, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim deri në dy vjet.

Neni 120

**Shpifja**

*(Ndryshuar paragrafi II me ligjin nr.8733, datë 24.1.2001, neni 33;*

*ndryshuar me ligjin nr.23/2012, datë 1.3.2012, neni 14)*

Përhapja e qëllimshme e thënieve, si dhe çdo informacion tjetër, duke e ditur se janë të rreme, që cenojnë nderin dhe dinjitetin e personit, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë nga pesëdhjetë mijë gjer në një milion e pesëqind mijë lekë.

Po kjo vepër, kur kryhet botërisht, në dëm të disa personave ose më shumë se një herë, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë nga pesëdhjetë mijë gjer në tre milionë lekë.

Neni 121

**Ndërhyrje të padrejta në jetën private**

Vendosja e aparaturave që shërbejnë për dëgjim apo regjistrim të fjalëve ose të figurave, dëgjimi, regjistrimi ose transmetimi i fjalëve, fiksimi, regjistrimi ose transmetimi i figurave, si dhe ruajtja për publikim apo publikimi i këtyre të dhënave që ekspozojnë një aspekt të jetës private të personit pa pëlqimin e tij, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në dy vjet.

Neni 121/a

**Përndjekja**

*(Shtuar me ligjin nr.23/2012, datë 1.3.2012, neni 15)*

Kërcënimi ose ngacmimi i personit me anën e veprimeve të përsëritura, me qëllimin për t'i shkaktuar një gjendje të vazhdueshme dhe të rëndë ankthi apo frike për sigurinë vetjake, të një të afërmi ose të një personi, me të cilin ka lidhje shpirtërore, apo për ta detyruar të ndryshojë mënyrën e tij të jetesës, dënohet me burgim nga gjashtë muaj gjer në katër vjet.

Kur kjo vepër kryhet nga ish-bashkëshorti, ish-bashkëjetuesi apo personi që ka pasur lidhje shpirtërore me të dëmtuarin, dënimi rritet me një të tretat e dënimit të dhënë.

Kur kjo veper kryhet ndaj të miturit, gruas shtatzënë ose një personi të pazotë për t'u mbrojtur, si dhe kur kryhet nga një person i maskuar ose shoqërohet me mbajtjen ose me përdorimin e armëve, dënimi rritet deri në një të dytën e dënimit të dhënë.

Neni 122

### **Përhapja e sekreteve vetjake**

Përhapja e një sekreti që i përket jetës private të një personi nga ai që e siguron atë për shkak të detyrës ose të profesionit, kur detyrohet të mos e përhapë pa qenë i autorizuar, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në një vit.

Po kjo veper, e kryer me qëllim fitimi ose për të dëmtuar një person tjetër, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në dy vjet.

Neni 123

### **Pengimi ose shkelja e fshehtësisë së korrespondencës**

Kryerja me dashje e veprimeve të tilla si asgjësimi, mosdorëzimi, hapja dhe leximi i letrave apo çdo korrespondencë tjetër, si dhe ndërprerja ose vënia nën kontroll, dëgjimi i bisedave telefonike, telegrafike ose i çdo mjeti tjetër telekomunikimi, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose burgim gjer në dy vjet.

## **SEKSIONI IX**

### **VEPRA PENALE KUNDËR FËMIJËVE, MARTESËS DHE FAMILJES**

Neni 124

### **Braktisja e fëmijëve të mitur**

*(Ndryshuar paragrafi I me ligjin nr.8733, datë 24.1.2001, neni 34)*

Braktisja e fëmijës nën moshën 16 vjeç nga prindi ose personi që është i detyruar të kujdeset për të, dënohet me gjobë ose me burgim gjer në tre vjet.

Kur nga vepra është shkaktuar dëmtimi i rëndë i shëndetit ose vdekja e fëmijës, dënohet me burgim nga tre gjer në dhjetë vjet.

Neni 124/a

### **Kërkimi ose marrja e shpërblimeve për procedurat e birësimit**

*(Shtuar me ligjin nr.9086, datë 19.6.2003, neni 5)*

*(Shfuqizuar me ligjin nr.144/2013, datë 2.5.2013, neni 48)*

Kërkimi, propozimi, dhënia ose pranimi i shpërblimeve dhe përfitimeve të tjera, për të kryer ose për të mos kryer një veprim, që lidhet me procesin e birësimit të një të mituri, dënohen me burgim deri në shtatë vjet.

Neni 124/b

### **Keqtrajtimi i të miturit**

*(Shtuar me ligjin nr.9859, datë 21.1.2008, neni 2;*

*ndryshuar me ligjin nr.23/2012, datë 1.3.2012, neni 16)*

*(Ndryshuar paragrafi i II me ligjin 144/2013, datë 2.5.2013, neni 30)*

Keqtrajtimi fizik ose psikologjik i të miturit nga prindërit, motra, vëllai, gjyshi, gjyshja, kujdestari ligjor ose çdo person që është i detyruar të kujdeset për të, dënohet me burgim nga tre muaj gjer në dy vjet.

Detyrimi, shfrytëzimi, shtytja ose përdorimi i të miturit për të punuar, për të siguruar të ardhura, për të lypur apo për të kryer veprime që dëmtojnë zhvillimin e tij mendor dhe/ose fizik, apo arsimimin e tij, dënohet me burgim nga dy deri në pesë vjet.

Kur nga vepra është shkaktuar dëmtimi i rëndë i shëndetit ose vdekja e të miturit, dënohet me burgim nga dhjetë deri në njëzet vjet.

Neni 125

### **Mosdhënia e mjeteve për jetesë**

Mosdhënia e mjeteve të nevojshme për jetesën e fëmijëve, të prindërve ose të bashkëshortit, nga personi që në zbatim të një vendimi gjyqësor detyrohet ta japë, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në një vit.

Neni 126

### **Mosnjoftimi i ndryshimit të vendbanimit**

Mosnjoftimi brenda një muaji i ndryshimit të vendbanimit, të interesuarve ose organit të ekzekutimit, nga personi që sipas vendimit gjyqësor detyrohet me dhënien e mjeteve të nevojshme për jetesë fëmijëve, prindërve ose bashkëshortit të vet, si dhe ai të cilit i janë besuar fëmijët pas zgjidhjes së martesës, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në tre muaj.

Neni 127

### **Marrja e padrejtë e fëmijës**

Marrja e padrejtë e fëmijës, duke e larguar prej personit që ushtron autoritetin prindëror ose që i është besuar për rritje dhe edukim, si dhe mosdorëzimi i fëmijës prindit tjetër në zbatim të vendimit gjyqësor, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në gjashtë muaj.

Neni 128

### **Ndërrimi i fëmijëve**

Ndërrimi i fëmijëve i bërë me pakujdesi nga personeli ku fëmijët mbahen për rritje, mjekim ose në shtëpi lindjeje, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në dy vjet.

Neni 128/a

### **Fshehja ose ndërrimi me dashje i fëmijës**

*(Shtuar me ligjin nr.8733, datë 24.1.2001, neni 35)*

Fshehja ose ndërrimi me dashje i fëmijës me një tjetër, i kryer nga personeli mjekësor, dënohet me burgim nga tre gjer në tetë vjet.

Neni 128/b

#### **Trafikimi i të miturve**

*(Ndryshuar me ligjin nr.9188, datë 12.2.2004, neni 3;*

*shtuar me ligjin nr.9859, datë 21.1.2008, neni 3)*

*(Ndryshuar me ligjin 144/2013, datë 2.5.2013, neni 31)*

*(Shfuqizuar me ligjin nr.144/2013, datë 2.5.2013, neni 48)*

Rekrutimi, shitja, transportimi, transferimi, fshehja ose pritja e të miturve me qëllim shfrytëzimin e prostitucionit ose formave të tjera të shfrytëzimit seksual, të punës ose shërbimeve të detyruara, skllavërimit ose formave të ngjashme me skllavërimin, vënies në përdorim ose transplantimit të organeve, si dhe formave të tjera të shfrytëzimit, dënohen me burgim nga dhjetë deri në njëzet vjet.

Organizimi, drejtimi dhe financimi i trafikimit të të miturve dënohen me burgim nga dhjetë deri në njëzet vjet.

Kur kjo veprë kryhet në bashkëpunim ose më shumë se një herë, apo shoqërohet me keqtrajtimin dhe detyrimin me dhunë fizike a psikike të të dëmtuarit, për të kryer veprime të ndryshme, ose sjell pasojë të rënda për shëndetin, dënohet me burgim jo më pak se pesëmbëdhjetë vjet.

Kur vepra ka sjellë si pasojë vdekjen e të dëmtuarit, dënohet me burgim jo më pak se njëzet vjet ose me burgim të përjetshëm.

Kur vepra penale kryhet nëpërmjet shfrytëzimit të funksionit shtetëror ose shërbimit publik, dënimi me burgim shtohet me ¼ e dënimit të dhënë.

Neni 129

#### **Shtytja e të miturve në krim**

Shtytja ose tërheqja e të miturve nën moshën katërmëdhjetë vjeç për të kryer krim, dënohet me burgim gjer në pesë vjet.

Neni 130

#### **Shtrengimi apo pengimi për të bashkëjetuar ose për të lidhur apo zgjidhur martesë**

*(Ndryshuar neni me ligjin 144/2013, datë 2.5.2013, neni 32)*

Shtrengimi apo pengimi për të filluar ose vazhduar bashkëjetesën, ose shtrengimi për të lidhur apo zgjidhur martesën, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në tre muaj.

Kërkesa e qëllimshme ndaj një të rrituri ose fëmije për të shkuar jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, me qëllim detyrimin e tij për të lidhur martesë, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre muaj.

Neni 130/a

## **Dhuna në familje**

*(Shtuar me ligjin nr.23/2012, datë 1.3.2012, neni 17)*

*(Ndryshuar paragrafi i fundit neni me ligjin 144/2013, datë 2.5.2013, neni 33)*

Rrahja, si dhe çdo vepër tjetër dhune, ndaj personit që është bashkëshort, ish-bashkëshort, bashkëjetues apo ish-bashkëjetues, gjini e afërt ose krushqi e afërt me autorin e veprës penale, me pasojë cenimin e integritetit fizik, psiko-social dhe ekonomik të tij, dënohet me burgim gjer në dy vjet.

Kanosja serioze për vrasje ose plagosje të rëndë, ndaj personit që është bashkëshort, ish-bashkëshort, bashkëjetues apo ish-bashkëjetues, gjini e afërt ose krushqi e afërt me autorin e veprës penale, me pasojë cenimin e integritetit psikik të tij, dënohet me burgim gjer në tre vjet.

Plagosja e kryer me dashje, ndaj personit që është bashkëshort, ish-bashkëshort, bashkëjetues apo ish-bashkëjetues, gjini e afërt ose krushqi e afërt me autorin e veprës penale, që ka shkaktuar paaftësi të përkohshme në punë më tepër se nëntë ditë, dënohet me burgim gjer në pesë vjet.

Po këto vepra, të kryera në mënyrë të përsëritur, ose në praninë e fëmijëve, dënohen nga një deri në pesë vjet.

### **SEKSIONI X**

#### **VEPRA PENALE KUNDËR LIRISË SË BESIMIT**

Neni 131

#### **Pengimi i veprimtarive të organizatave fetare**

Ndalimi i veprimtarive të organizatave fetare, si dhe krijimi i pengesave për ushtrimin e lirë të veprimtarive të tyre, dënohet me gjobë ose me burgim gjer në tre vjet.

Neni 132

#### **Shkatërrimi ose dëmtimi i objekteve të kultit**

Shkatërrimi ose dëmtimi me dashje i objekteve të kultit, kur ka shkaktuar humbjen plotësisht ose pjesërisht të vlerave të tyre, dënohet me gjobë ose me burgim gjer në tre vjet.

Neni 133

#### **Pengimi i ceremonive fetare**

Ndalimi ose krijimi i pengesave që u bëhen personave për të marrë pjesë në ceremonitë fetare, si dhe për të shprehur lirisht bindjet fetare, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në një vit.

### **KREU III**

#### **VEPRA PENALE KUNDËR PASURISË DHE NË SFERËN EKONOMIKE**

### **SEKSIONI I**

#### **VJEDHJA E PASURISË**

## Neni 134

### Vjedhja

(Ndryshuar me ligjin nr.9275, date 16.9.2004, neni 12;

ndryshuar me ligjin nr.23/2012, datë 1.3.2012, neni 18)

Vjedhja e pasurisë dënohet me gjobë ose me burgim gjer në tre vjet.

Po kjo vepër, kur kryhet në bashkëpunim ose më shumë se një herë dënohet me burgim nga gjashtë muaj deri në pesë vjet.

E njëjta vepër, kur ka sjellë pasoja të rënda dënohet me burgim nga katër deri në dhjetë vjet.

---

### Vendim i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë nr.5, datë 11.11.2003

*Nisur nga formulimi i bërë në nenin 134/2 të Kodit Penal, duhet pranuar se ekzistenca qoftë dhe vetëm e rrethanës “pasoje e rëndë”, në rastin e vjedhjes së pasurisë, është e mjaftueshme që vepra penale e kryer nga personi të cilësohet sipas këtij paragrafi. Vetëm fakti që vjedhja e pasurisë të ketë sjellë pasoja të rënda, bën që ajo të konsiderohet e cilësuar.*

*Interpretimi i termit “pasoja të rënda” duhet parë në raport me vetë figurën e veprës penale, me raportet shoqërore që ajo mbron dhe duhet analizuar në çdo rast me disa rrethana që lidhen me dëmin e shkaktuar nga vjedhja.*

*Duke u nisur nga fakti që figura e veprës penale të vjedhjes ka pasojë pakësimin e pasurisë së tjetrit në mënyrë të kundërligjshme, Kolegjet e Bashkuara evidentojnë faktin se një ndër kriteret bazë për të përcaktuar pasojën e rëndë është vlera e pasurisë së vjedhur, e cila do të merret në çdo rast e lidhur me rrethanat e tjera që kanë ndikuar te subjekti i dëmtuar.*

*Ligjvënësi nuk e kushtëzon vjedhjen me vlerën dhe në paragrafin e dytë të nenit 134 nuk përmendet fjala vlerë, prandaj për të përcaktuar “pasojën e rëndë” duhet pasur parasysh se ajo do të jetë e ndryshme mes subjekteve që dëmtohen nga vepra penale e vjedhjes, që ndahen në: individë, persona juridikë dhe shteti. Në raport me zhvillimin aktual ekonomik e gjendjen ekonomike të individit e të shoqërisë, Kolegjet e Bashkuara përcaktojnë si kriter orientues për vlerën si pasojë të rëndë në rastet e vjedhjes së parashikuar nga neni 134/2 i Kodit Penal:*

*1. Shuma ose sende me vlerë mbi 1 000 000 lekë, kur ato u vidhen individëve.*

*2. Shuma ose sende me vlerë mbi 2 000 000 lekë, kur vjedhja është realizuar në dëm të personave juridikë dhe pasurisë shtetërore.*

*Këto vlera do të jenë relative, duke pasur parasysh edhe pasojat e tjera që mund të shkaktohen nga kryerja e kësaj vepre penale, dhe gjykatat, rast pas rasti, duhet ta marrin atë lidhur me vendin e kryerjes së veprës penale, kohën e kryerjes së saj, me subjektin e dëmtuar dhe me pasojat e tjera joekonomike që mund të vijnë, të cilat, kur rëndojnë rrethanat e faktit, pavarësisht se vlerat mund të jenë më të vogla nga përcaktimet e mësipërme, mund ta çojnë gjykatën në përfundimin se vjedhja ka sjellë pasoja të rënda e ta kualifikojnë atë në bazë të nenit 134/2 të Kodit Penal.*

*Në këtë përfundim arrihet duke u nisur nga vetë formulimi i paragrafit të dytë të nenit 134 të Kodit Penal, ku thuhet: “po kjo vepër kur ka sjellë pasoja të rënda” dhe nga terminologjia që ka përdorur ligjvënësi për këtë qëllim në lidhje me pasojën si element të anës objektive të kësaj figure krimi dhe që duhen kuptuar jo pasojat e çfarëdoshme që vijnë në çdo rast vjedhjeje të pasurisë, por pasojat e një*

*natyre të veçantë, që duhen trajtuar të rënda, duke mbajtur parasysh edhe shkallën e efektit negativ që pëson i dëmtuari nga vepra penale. Kështu mund të sillen si shembuj vjedhja e një pjese ose detaji të linjës teknologjike të një fabrike ose të një aparature elektromjekësore etj., të cilat, pavarësisht nga vlera e tyre e shprehur në të holla, shkakton sipas rastit ndërprerjen e procesit teknologjik, lë pa punë një numër të konsiderueshëm punonjësish, lë pacientët pa mjekimin e domosdoshëm jetik, lë pa energji elektrike apo ujë një zonë qyteti ose fshati etj.*

---

Neni 135

**Vjedhja e kryer duke shpërdoruar detyrën**

*(Shtuar fjalë me ligjin nr.23/2012, datë 1.3.2012, neni 19)*

*(Shfuqizuar me ligjin nr.144/2013, datë 2.5.2013, neni 48)*

Vjedhja e pasurisë e kryer nga personi, që ka për detyrë ta ruajë dhe ta administrojë atë, apo duke shpërdoruar detyrën, dënohet me burgim gjer në dhjetë vjet.

Neni 136

**Vjedhja e bankave dhe arkave të kursimit**

*(Shtuar paragrafi II me ligjin nr.8733, datë 24.1.2001, neni 37)*

Vjedhja e bankave dhe e arkave të kursimit dënohet me burgim nga pesë gjer në pesëmbëdhjetë vjet. Po kjo vepër, kur kryhet në bashkëpunim, më shumë se në herë ose ka sjellë pasoja të rënda, dënohet me burgim nga dhjetë gjer në njëzet vjet.

Neni 137

**Vjedhja e energjisë elektrike ose impulseve telefonike**

*(Shtuar paragrafi I me ligjin nr.8733, datë 24.1.2001, neni 38;*

*ndryshuar paragrafi II me ligjin nr.10 023, datë 27.11.2008, neni 14)*

Lidhja e paligjshme me rrjetin e energjisë elektrike, përbën kundërvajte penale dhe dënohet me burgim gjer në dy vjet.

Vjedhja e energjisë elektrike ose impulseve telefonike dënohet me burgim gjer në tre vjet.

Neni 137/a

**Vjedhja e rrjetit të komunikimeve elektronike**

*(Shtuar neni me ligjin 144/2013, datë 2.5.2013, neni 34)*

Vjedhja e rrjetit të komunikimeve elektronike dënohet me burgim deri në tre vjet. Po kjo vepër, kur kryhet në bashkëpunim, më shumë se një herë, ose ka sjellë pasoja të rënda, dënohet me burgim nga tre deri në shtatë vjet.

Neni 138

**Vjedhja e veprave të artit e kulturës**

Vjedhja e veprave të artit e kulturës dënohet me gjobë ose me burgim gjer në pesë vjet.

Vjedhja e veprave të artit e kulturës me rëndësi kombëtare dënohet me burgim nga pesë gjer në dhjetë vjet.

Neni 138/a

**Trafikimi i veprave të artit dhe kulturës**

*(Shtuar me ligjin nr.8733, datë 24.1.2001, neni 39)*

Importimi, eksportimi, tranzitimi dhe tregtimi në kundërshtim me ligjin i veprave të artit dhe të kulturës, me qëllim fitimi material ose çdo përfitim tjetër, dënohet me burgim nga tre gjer në dhjetë vjet.

Po kjo vepër, kur kryhet në bashkëpunim ose më shumë se një herë, ose sjell pasoja të rënda, dënohet me burgim nga pesë gjer në pesëmbëdhjetë vjet.

Neni 139

**Vjedhja me dhunë**

Vjedhja e pasurisë e shoqëruar me përdorim dhune dënohet me burgim nga pesë gjer në pesëmbëdhjetë vjet.

Neni 140

**Vjedhja me armë**

*(Ndryshuar me ligjin nr.8733, datë 24.1.2001, neni 40;*

*ndryshuar me ligjin nr.9686, datë 26.2.2007, neni 11)*

Vjedhja e pasurisë, e shoqëruar me mbajtjen e armëve dhe municioneve luftarake ose me përdorimin e tyre, dënohet me burgim nga dhjetë gjer në njëzet vjet.

Neni 141

**Vjedhja me pasojë vdekjen**

*(Ndryshuar me ligjin nr.8733, datë 24.1.2001, neni 79)*

Vjedhja e pasurisë, kur është shoqëruar me dhunime që kanë sjellë vdekjen e personit, dënohet me burgim nga pesëmbëdhjetë gjer në njëzet e pesë vjet ose me burgim të përjetshëm.

Neni 141/a

**Trafikimi i mjeteve motorike**

*(Shtuar me ligjin nr.8733, datë 24.1.2001, neni 41)*

Importimi, eksportimi, tranzitimi dhe tregtimi në kundërshtim me ligjin, i mjeteve motorike të vjedhura, me qëllim fitimi material ose çdo përfitim tjetër, dënohet me burgim nga tre gjer në shtatë vjet.

Po kjo vepër, kur kryhet në bashkëpunim ose më shumë se një herë, ose sjell pasoja të rënda, dënohet me burgim nga pesë gjer në pesëmbëdhjetë vjet.



Neni 142

### **Sigurimi i mjeteve për vjedhje**

Sigurimi i kushteve dhe i mjeteve materiale për të vjedhur pasurinë dënohet me gjobë ose me burgim gjer në tre vjet.

## **SEKSIONI II MASHTRIMET**

Neni 143

### **Mashtrimi**

*(Shtuar paragrafi II me ligjin nr.8733, datë 24.1.2001, neni 42)*

Vjedhja e pasurisë me anë të gënjeshtërs ose shpërdorimit të besimit dënohet me gjobë ose me burgim gjer në pesë vjet.

Po kjo vepër, kur kryhet në bashkëpunim në dëm të disa personave ose më shumë se një herë, dënohet me burgim nga tre gjer në dhjetë vjet dhe, kur ka sjellë pasoja të rënda, me burgim nga dhjetë gjer në njëzet vjet.

Neni 143/a

### **Skemat mashtruese dhe piramidale**

*(Shtuar me ligjin nr.8733, datë 24.1.2001, neni 43;*

*shtuar me ligjin nr.23/2012, datë 1.3.2012, neni 20)*

*(Shfuqizuar me ligjin nr.144/2013, datë 2.5.2013, neni 48)*

Organizimi dhe vënia në funksionim e skemave mashtruese dhe piramidale të huamarrjes, me qëllim fitimi material, dënohet me burgim nga tre gjer në dhjetë vjet.

Po kjo vepër, kur ka sjellë pasoja të rënda, dënohet me burgim nga dhjetë gjer në njëzet vjet.

Neni 143/a/1

### **Manipulimi i tregut**

*(Shtuar me ligjin nr.23/2012, datë 1.3.2012, neni 20)*

Paraqitja jo e saktë, me dashje, e vlerës së një malli, shërbimi apo paraje, me qëllim çrregullimin e funksionimit të lirë dhe të drejtë të tregut, dënohet me gjobë ose me burgim gjer në katër vjet.

Neni 143/a/2

### **Përdorimi i paautorizuar dhe përhapja e informacionit të privilegjuar**

*(Shtuar me ligjin nr.23/2012, datë 1.3.2012, neni 20)*

Personi, i cili, në mënyrë të autorizuar ose të paautorizuar, vihet në dijeni të informacionit të privilegjuar, për të cilin publiku nuk ka dijeni e që mund ta përdorë me qëllim fitimi material për vete, për një palë të tretë apo në dëm të kësaj të fundit, në njërën nga mënyrat e mëposhtme:

a) për të blerë ose për të shitur tituj të tregtueshëm në territorin e Republikës së Shqipërisë ose të tregtuar nga një emetues, me seli në Republikën e Shqipërisë;

b) duke ditur natyrën e privilegjuar të informacionit, ia komunikon, pa autorizim, një palë të tretë;

c) duke ditur natyrën e privilegjuar të informacionit, këshillon një palë të tretë për të blerë ose për të shitur tituj të tregtueshëm në territorin e Republikës së Shqipërisë apo të tregtuar nga një emetues, me seli në Republikën e Shqipërisë, dënohet me burgim nga gjashtë muaj gjer në tre vjet.

Kur kjo vepër kryhet në bashkëpunim, më shumë se një herë ose ka sjellë pasoja të rënda, dënohet me burgim gjer në pesë vjet.

Neni 143/a/3

### **Manipulimi i çmimeve dhe përhapja e informacionit të rremë**

*(Shtuar me ligjin nr.23/2012, datë 1.3.2012, neni 20)*

Veprimi apo mosveprimi i personit që:

a) nënshkruan një kontratë fiktive për shitjen apo zëvendësimin e titujve;

b) kryen porosi për blerje ose shitje të titujve, për të cilët është kryer porosia me të njëjtin çmim, apo nëse ai i përdor këto tituj si kundërporosi;

c) përhap informacion apo fakte të tjera të rreme për rritjen ose rënien e çmimit të titujve apo krijimin e një tregtimi fiktiv aktiv të tyre, me qëllim përfitimi personal për vete, një palë të tretë apo në dëm të kësaj të fundit, dënohet me burgim nga gjashtë muaj gjer në tre vjet.

Kur kjo vepër kryhet në bashkëpunim, më shumë se një herë ose ka sjellë pasoja të rënda, dënohet me burgim nga dy gjer në pesë vjet.

Neni 143/a/4

### **Paraqitja e të dhënave të rreme dhe shpërndarja e paautorizuar e tyre**

*(Shtuar me ligjin nr.23/2012, datë 1.3.2012, neni 20)*

Personi që, si anëtar i drejtorisë apo i këshillit mbikëqyrës të një emetuesi, lejon ose mundëson shpërndarjen e një prospekti, të ndryshëm nga ai që përcaktohet nga ligji, apo lejon ose mundëson paraqitjen e të dhënave të rreme ose paraqitjen e rreme të fakteve me vlerë materiale në një prospekt, dënohet me burgim nga gjashtë muaj gjer në tre vjet.

Kur kjo vepër kryhet në bashkëpunim, më shumë se një herë ose ka sjellë pasoja të rënda dënohet me burgim gjer në pesë vjet.

Neni 143/a/5

### **Regjistrimi i titujve në bursë në mënyrë të paautorizuar**

*(Shtuar me ligjin nr.23/2012, datë 1.3.2012, neni 20)*

Personi që, si anëtar i drejtorisë së bursës, lejon regjistrimin në kuotimin një, kuotimin e shoqërive anonime publike apo në kuotime të tjera të titujve, të cilët nuk i plotësojnë kushtet e ligjit për titujt, dënohet me burgim nga gjashtë muaj gjer në tre vjet.

Kur kjo vepër kryhet në bashkëpunim, më shumë se një herë ose ka sjellë pasoja të rënda dënohet me burgim nga dy gjer në pesë vjet.

Neni 143/a/6

### **Fshehja e pronësisë**

*(Shtuar me ligjin nr.23/2012, datë 1.3.2012, neni 20)*

Personi, i cili me dashje nuk i jep të dhëna për pronësinë Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, sipas ligjit për titujt, dënohet me gjobë ose burgim gjer në një vit.

Kur kjo vepër kryhet në bashkëpunim, më shumë se një herë ose ka sjellë pasoja të rënda dënohet me burgim nga dy gjer në pesë vjet.

Neni 143/a/7

### **Tregtimi i paligjshëm i titujve**

*(Shtuar me ligjin nr.23/2012, datë 1.3.2012, neni 20)*

Personi që merret me ndërmjetësim të paautorizuar për blerjen ose shitjen e titujve dënohet me gjobë ose me burgim gjer në një vit.

Kur kjo vepër kryhet në bashkëpunim, më shumë se një herë ose ka sjellë pasoja të rënda dënohet me burgim nga dy gjer në pesë vjet.

Neni 143/b

### **Mashtrimi kompjuterik**

*(Shtuar me ligjin nr.10 023, datë 27.11.2008, neni 15)*

*(Shfuqizuar me ligjin nr.144/2013, datë 2.5.2013, neni 48)*

Futja, ndryshimi, fshirja ose heqja e të dhënave kompjuterike apo ndërhyrja në funksionimin e një sistemi kompjuterik, me qëllim për t'i siguruar vetes apo të tretëve, me mashtrim, një përfitim ekonomik të padrejtë apo për t'i shkaktuar një të treti pakësimin e pasurisë, dënohen me burgim nga gjashtë muaj deri në gjashtë vjet.

Po kjo vepër, kur kryhet në bashkëpunim, në dëm të disa personave, më shumë se një herë ose kur ka sjellë pasoja të rënda materiale, dënohet me burgim nga pesë deri në pesëmbëdhjetë vjet.

Neni 144

### **Mashtrimi në subvencione**

Mashtrimi në dokumentet e paraqitura, duke përfituar padrejtësisht subvencione nga shteti, dënohet me gjobë ose me burgim gjer në katër vjet.

Neni 144/a

### **Krijimi i skemave mashtruese lidhur me tatimin mbi vlerën e shtuar**

*(Shtuar neni me ligjin 144/2013, datë 2.5.2013, neni 35)*

Organizimi dhe vënia në funksionim e skemave mashtruese, me qëllim fitimin material për vete apo për të tjerët, nëpërmjet mospagimit, apo përfitimit të kreditimit ose rimbursimit të tatimit mbi vlerën e shtuar, dënohet me burgim nga tre deri në dhjetë vjet.

Neni 145

### **Mashtrimi në sigurime**

Paraqitja e rrethanave të rreme në lidhje me objektin që sigurohet, ose krijimi i rrethanave të rreme dhe paraqitja e tyre në dokumentet duke përfituar padrejtësisht sigurime, dënohet me gjobë ose me burgim gjer në pesë vjet.

Neni 146

### **Mashtrimi në kredi**

Mashtrimi në dokumentet e paraqitura, duke përfitur padrejtësisht kredi duke regjistruar në mënyrë fiktive në hipotekë objekte që nuk ekzistojnë, ose tej vlerës së tyre reale, ose në pronësi të një tjetri, të bëra me qëllim për të mos kthyer më kredinë e marrë, dënohet me gjobë ose me burgim gjer në shtatë vjet.

Neni 147

### **Mashtrimi për veprat e artit e të kulturës**

*(Ndryshuar me ligjin nr.8733, datë 24.1.2001, neni 44)*

Vjedhja e pasurisë me anë të mashtrimit, duke paraqitur një vepër të artit dhe të kulturës si origjinale apo të një tjetër autori nga ai që është në fakt, dënohet me gjobë ose me burgim gjer në katër vjet.

Neni 148

### **Botimi i veprës së tjetrit me emrin e vet**

*(Ndryshuar me ligjin nr.8733, datë 24.1.2001, neni 45)*

Botimi ose përdorimi tërësisht apo pjesërisht me emrin e vet të një vepre letrare, muzikore, artistike ose shkencore që i përket një tjetri, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në dy vjet.

Neni 149

### **Riprodhimi pa të drejtë i veprës së tjetrit**

*(Ndryshuar me ligjin nr.8733, datë 24.1.2001, neni 46)*

Riprodhimi tërësisht ose pjesërisht i veprës letrare, muzikore, artistike ose shkencore që i përket një tjetri, ose përdorimi i tyre pa pëlqim të autorit, kur kanë shkelur të drejtat vetjake e pasurore të tij, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në dy vjet.

Neni 149/a

### **Shkelja e të drejtave të pronësisë industriale**

*(Shtuar me ligjin nr.23/2012, datë 1.3.2012, neni 21)*

Prodhimi, shpërndarja, mbajtja për qëllime tregtimi, shitja, ofrimi për shitje, furnizimi, shpërndarja, eksportimi ose importimi për këto qëllime i:

- a) produktit ose procesit të mbrojtur nga një patentë, pa pëlqimin e pronarit të patentës;
  - b) produktit që mbrohet nga një dizeno industriale, pa pëlqimin e pronarit të dizenjës industriale;
  - c) mallrave ose shërbimeve që mbrohen nga një markë tregtare, pa pëlqimin e pronarit të markës tregtare;
  - ç) produktit që rrjedh nga një tregues gjeografik, pa pëlqimin e pronarit të treguesit gjeografik;
- të kryera me dashje, përbëjnë kundërvajtje penale dhe dënohen me gjobë ose me burgim gjer në një vit.

Po kjo vepër kur kryhet në bashkëpunim ose më shumë se një herë përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në dy vjet.

Neni 149/b

### **Shkelja e të drejtave të topografisë së qarkut të gjysmëpërçuesit**

Prodhimi, përdorimi, mbajtja për qëllim tregtimi, shitja, ofrimi për shitje, furnizimi, shpërndarja, eksportimi ose importimi për këto qëllime i produktit që shkel të drejtat e topografisë së regjistruar të qarkut, të gjysmëpërçuesit ose të qarkut të integruar, pa pëlqimin e pronarit të topografisë, të kryera me dashje, përbëjnë kundërvajtje penale dhe dënohen me gjobë ose me burgim gjer në një vit.

Kur kjo vepër kryhet në bashkëpunim ose më shumë se një herë përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në dy vjet.

## **SEKSIONI III SHKATËRRIMI I PRONËS**

Neni 150

### **Shkatërrimi i pronës**

Shkatërrimi apo dëmtimi me dashje i pronës, kur pasojat materiale nuk janë të lehta, dënohet me gjobë ose me burgim gjer në tre vjet.

Neni 151

### **Shkatërrimi i pronës me zjarr**

Shkatërrimi apo dëmtimi me dashje i pronës me zjarr dënohet me gjobë ose me burgim gjer në pesë vjet.

Kur nga vepra penale janë shkaktuar pasoja të rënda materiale, dënohet me burgim gjer në dhjetë vjet.

Kur janë shkaktuar pasoja të rënda për jetën e shëndetin e njerëzve, dënohet me burgim nga pesë gjer në pesëmbëdhjetë vjet.

Neni 152

### **Shkatërrimi i pronës me eksploziv**

Shkatërrimi apo dëmtimi me dashje i pronës me eksploziv dënohet me gjobë ose me burgim gjer në pesë vjet.

Kur nga vepra penale kanë ardhur pasoja të rënda materiale, dënohet me burgim nga pesë gjer në dhjetë vjet.

Kur janë shkaktuar pasoja të rënda për jetën e shëndetin e njerëzve, dënohet me burgim nga dhjetë gjer në njëzet vjet.

Neni 153

### **Shkatërrimi i pronës me përmytje**

Shkatërrimi apo dëmtimi me dashje i pronës me përmytje dënohet me gjobë ose me burgim gjer në pesë vjet.

Kur nga vepra penale kanë ardhur pasoja të rënda materiale, dënohet me burgim nga pesë gjer në dhjetë vjet.

Kur janë shkaktuar pasoja të rënda për jetën e shëndetin e njerëzve, dënohet me burgim nga pesë gjer në pesëmbëdhjetë vjet.

Neni 154

#### **Shkatërrimi i pronës me mjete të tjera**

Shkatërrimi apo dëmtimi me dashje i pronës me mjete të tjera, që përbëjnë rrezik për mjedisin rrethues dhe jetën e njerëzve, dënohet me gjobë ose me burgim gjer në pesë vjet.

Kur nga vepra penale kanë ardhur pasoja të rënda materiale, dënohet me burgim nga pesë gjer në dhjetë vjet.

Kur janë shkaktuar pasoja të rënda për jetën dhe shëndetin e njerëzve, dënohet me burgim nga pesë gjer në pesëmbëdhjetë vjet.

Neni 155

#### **Shkatërrimi i rrugëve**

Shkatërrimi apo dëmtimi me dashje i rrugëve automobilistike, hekurudhore dhe veprave që lidhen me to, dënohet me gjobë apo me burgim gjer në shtatë vjet.

Kur nga veprat penale kanë ardhur pasoja të rënda materiale, dënohet me burgim nga tre gjer në dhjetë vjet.

Kur janë shkaktuar pasoja të rënda për jetën dhe shëndetin e njerëzve, dënohet me burgim nga pesë gjer në pesëmbëdhjetë vjet.

Neni 156

#### **Shkatërrimi i rrjetit elektrik**

*(Shtuar paragrafi i II me ligjin nr.10 023, datë 27.11.2008, neni 16)*

Shkatërrimi apo dëmtimi me dashje i rrjetit elektrik, telegrafik, telefonik, radioteleviziv apo të çdo rrjeti ndërlidhës, dënohet me gjobë ose me burgim gjer në tre vjet.

Po kjo vepër, kur kryhet në bashkëpunim, më shumë se një herë, ose ka sjellë pasoja të rënda, dënohet me burgim deri në tre vjet.

Neni 157

#### **Shkatërrimi i rrjetit të ujitjes**

Shkatërrimi apo dëmtimi me dashje i kanaleve ujtitëse dhe kulluese ose veprave që lidhen me to, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në dy vjet.

Neni 158

Administrimi i ujit pa të drejtë, duke kthyer ose ndryshuar vijën e ujit, duke hapur pendat, duke ndërtuar apo mbyllur kanale kulluese apo vaditëse, vija ose vepra të tjera, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në dy vjet.

Neni 159

### **Shkatërrimi i rrjetit të ujësjellësit**

*(Ndryshuar me ligjin nr.10 023, datë 27.11.2008, neni 17)*

Lidhja, si dhe çdo ndërhyrje tjetër e bërë pa leje në rrjetin e ujësjellësit, për marrjen e ujit të pijshëm, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim deri në dy vjet.

Shkatërrimi me dashje i rrjetit të ujësjellësit dënohet me burgim deri në pesë vjet.

Neni 160

### **Shkatërrimi i veprave kulturore**

Shkatërrimi apo dëmtimi me dashje i veprave kulturore dënohet me gjobë ose me burgim gjer në tre vjet.

Kur nga vepra penale janë shkatërruar apo dëmtuar vepra kulturore me rëndësi kombëtare, dënohet me gjobë ose me burgim nga dy gjer në tetë vjet.

Neni 161

### **Shkatërrimi i pronës nga pakujdesia**

Shkatërrimi apo dëmtimi nga pakujdesia i pronës, kur ka sjellë pasoja të rënda materiale, dënohet me gjobë ose me burgim gjer në tre vjet.

Neni 162

### **Përplasja e mjeteve të transportit masiv**

Shkaktimi nga pakujdesia i përplasjes së trenave, anijeve, avionëve, kur ka shkaktuar rrëzimin, djegien, mbytjen, përmbysjen, daljen nga shinat ose është shoqëruar me pasoja të rënda materiale, dënohet me gjobë ose burgim gjer në pesë vjet.

## **SEKSIONI IV**

### **VEPRA PENALE TË KRYERA NË SHOQËRITË TREGTARE**

Neni 163

### **Përpilimi i deklaratave të rreme**

Përpilimi i deklaratave të rreme, në rastin e zmadhimit të kapitalit të shoqërisë, lidhur me ndarjen e pjesëve të kapitalit themeltar të ortakëve, me shlyerjen e tij apo me depozitimimin e fondeve, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë.

Neni 164

### **Shpërdorimi i kompetencave**

Shpërdorimi i kompetencave nga anëtarët e këshillit mbikqyrës apo administratorët e shoqërisë me qëllim përfitimi apo për të favorizuar një shoqëri tjetër ku kanë interesa, dënohet me gjobë ose me burgim gjer në pesë vjet.

Neni 164/a

**Korrupsioni aktiv në sektorin privat**

*(Shtuar me ligjin nr.9275, datë 16.9.2004, neni 13;  
ndryshuar me ligjin nr.23/2012, datë 1.3.2012, neni 22)  
(Shfuqizuar me ligjin nr.144/2013, datë 2.5.2013, neni 48)*

Premtimi, propozimi ose dhënia, drejtpërdrejt ose tërthorazi, i çdo lloj përfitimi të parregullt, për vete ose për persona të tjerë, personit që ushtron funksion drejtues në shoqëri tregtare ose punon në çdo pozicion në sektorin privat, për të kryer ose moskryer një veprim në kundërshtim me detyrën ose funksionin e tij, dënohet me burgim nga tre muaj deri në tre vjet.

Neni 164/b

**Korrupsioni pasiv në sektorin privat**

*(Shtuar me ligjin nr.9275, datë 16.9.2004, neni 13;  
ndryshuar me ligjin nr.23/2012, datë 1.3.2012, neni 23)  
(Shfuqizuar me ligjin nr.144/2013, datë 2.5.2013, neni 48)*

Kërkimi a marrja, drejtpërdrejt ose tërthorazi, i çdo lloj përfitimi të parregullt a i një premtimi të tillë, për vete ose për persona të tjerë, ose pranimi i një oferte a premtimi, që vjen nga përfitimi i parregullt, nga personi që ushtron funksion drejtues ose punon në çdo pozicion në sektorin privat, për të kryer ose mos kryer një veprim në kundërshtim me detyrën a funksionin e tij, dënohet me burgim nga gjashtë muaj deri në pesë vjet.

Neni 165

**Falsifikimi i nënshkrimeve**

Falsifikimi i nënshkrimeve dhe derdhjeve apo deklarimi i rremë i derdhjeve të fondeve të shoqërisë, apo publikimi i nënshkrimeve dhe derdhjeve për persona fiktivë, apo vlerësimi i kontributit në natyrë me vlerë më të madhe se sa vlera faktike, dënohet me gjobë ose me burgim gjer në pesë vjet.

Neni 166

**Emetimi i parregullt i aksioneve**

Emetimi i parregullt i aksioneve bërë përpara regjistrimit të shoqërisë apo kur regjistrimi është bërë në mënyrë të kundërligjshme, apo kur formalitetet e shoqërisë ende nuk janë plotësuar, apo kur ndryshimi i statutit me rastin e zmadhimit të kapitalit ende nuk është bërë ose nuk është regjistruar apo është bërë në mënyrë të kundërligjshme, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në tre muaj.

Neni 167

**Mbajtja e padrejtë e dy cilësive**



Mbajtja njëkohësisht e cilësive të ortakut dhe ekspertit kontabël përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në gjashtë muaj.

Neni 168

#### **Dhënia e informacioneve të rreme**

Dhënia e informacioneve të rreme për gjendjen e shoqërisë prej ekspertit kontabël pranë një shoqërie tregtare, apo moskallëzimi në organet kompetente për kryerjen e një krimi, kur nuk ekzistojnë rastet e përjashtimeve nga përgjegjësia penale të përcaktuar në nenin 300 të këtij Kodi, dënohet me gjobë ose me burgim gjer në pesë vjet.

Neni 169

#### **Zbulimi i sekreteve të shoqërisë**

Zbulimi i sekreteve të shoqërisë prej ekspertit kontabël të saj, me përjashtim të rasteve kur e detyron ligji, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në dy vjet.

Neni 170

#### **Mosbërja e shënimeve të detyrueshme**

Mosbërja e shënimeve të detyrueshme nga administratori apo likuiduesi i shoqërisë përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë.

Neni 170/a

#### **Punësimi i paligjshëm**

*(Shtuar me ligjin nr.8279, datë 15.1.1998, neni 2;  
ndryshuar me ligjin nr.8733, datë 24.1.2001, neni 47)*

Punësimi pa regjistrim në organet kompetente ose pa garantuar sigurimin e të punësuarit sipas rregullave, kur është dhënë më parë masë administrative, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë deri në 10 mijë lekë për çdo rast ose me burgim deri në 1 vit.

Moskryerja me dashje ose mbulimi i shkeljeve lidhur me punësimin dhe sigurimin social nga persona të ngarkuar me zbatimin dhe kontrollin e dispozitave përkatëse, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë deri në 100 mijë lekë ose me burgim deri në 2 vjet.

Neni 170/b

#### **Konkurrenca e paligjshme nëpërmjet dhunës**

*(Shtuar me ligjin nr.9275, datë 16.9.2004, neni 14;  
ndryshuar paragrafi i parë me ligjin nr.9686, datë 26.2.2007, neni 12)*

Kryerja, gjatë ushtrimit të veprimtarisë tregtare, e veprimeve të konkurrencës me anë të kërcënimit ose dhunës dënohet me burgim nga një deri në katër vjet.

Kur veprimet e konkurrencës drejtohen ndaj veprimtarive të financuara plotësisht ose pjesërisht dhe në çfarëdo mënyre nga shteti ose entet publike, dënimi me burgim shtohet me një të tretën.

SEKSIONI IV/1

VEPRA PENALE NË LIDHJE ME USHTRIMIN E VEPRIMTARIVE BANKARE DHE FINANCIARE

*(Shtuar me ligjin nr.23/2012, datë 1.3.2012, neni 25)*

Neni 170/c

**Ushtrimi pa licencë i veprimtarisë bankare**  
*(Shtuar me ligjin nr.23/2012, datë 1.3.2012, neni 25)*

Ushtrimi i veprimtarisë bankare nga persona që nuk janë të licencuar për këtë qëllim, sipas legjislacionit bankar në fuqi, dënohet me gjobë ose me burgim gjer në tre vjet.

Po kjo vepër, kur i ka shkaktuar pasoja të rënda interesave shtetërorë ose atyre të shtetasve, dënohet me gjobë ose me burgim gjer në shtatë vjet.

Neni 170/ç

**Ushtrimi pa licencë i veprimtarive financiare**  
*(Shtuar me ligjin nr.23/2012, datë 1.3.2012, neni 25)*

Ushtrimi i një ose disa veprimtarive financiare të ndryshme nga veprimtaria bankare, nga persona që nuk janë të licencuar për këtë qëllim, sipas legjislacionit bankar dhe/ose financiar në fuqi, dënohet me gjobë ose burgim gjer në tre vjet.

Po kjo vepër, kur i ka shkaktuar pasoja të rënda interesave shtetërorë ose atyre të shtetasve, dënohet me gjobë ose me burgim gjer në pesë vjet.

SEKSIONI V  
KRIME NË FUSHËN E DOGANAVE

Neni 171

**Kontrabanda me mallra të ndaluar**

Importimi, eksportimi apo tranzitimi i paligjshëm i mallrave të ndaluar që hyjnë e dalin në Republikën e Shqipërisë, i kryer me çdo mënyrë a mjet qoftë, dënohen me burgim gjer në dhjetë vjet.

Neni 172

**Kontrabanda me mallra që paguhet akcizë**

Importimi, eksportimi apo tranzitimi i mallrave që paguhet akcizë nëpërmjet kalimit jashtë pikave doganore, fshehjes së pjesshme apo të plotë, mosdeklarimit të saktë në doganë, deklarimit të rremë për natyrën, llojin, cilësinë, çmimin, destinacionin e mallit apo të tjera forma që kanë për qëllim shmangien nga detyrimet doganore, dënohen me gjobë ose me burgim gjer në shtatë vjet.

Neni 173

**Kontrabanda me mallra të licencuar**

Importimi, eksportimi apo tranzitimi i mallrave, që kërkojnë licencë nga organi kompetent, nëpërmjet kalimit jashtë pikave doganore, fshehjes së pjesshme apo të plotë, mosdeklarimit të saktë në doganë, deklarimit të rremë për natyrën, llojin, cilësinë, çmimin, destinacionin e mallit apo të tjera forma që kanë për qëllim shmangien nga detyrimet doganore, dënohen me gjobë ose burgim gjer në pesë vjet.

Neni 174

**Kontrabanda me mallra të tjera**

Importimi, eksportimi apo tranzitimi i mallrave, nëpërmjet kalimit jashtë pikave doganore, fshehjes së plotë apo të pjesshëm, mosdeklarimit të saktë në doganë, deklarimit të rremë për natyrën, llojin, cilësinë, çmimin, destinacionin e mallit apo të tjera forma që kanë për qëllim shmangien nga detyrimet doganore, dënohen me gjobë ose burgim gjer në pesë vjet.

Neni 175

**Kontrabanda nga punonjës që lidhen me veprimtarinë doganore**

*(Ndryshuar me ligjin nr.8733, datë 24.1.2001, neni 48)*

Kryerja e kontrabandës nga punonjës të doganave ose punonjës që kanë lidhje me veprimtarinë doganore, qoftë edhe në bashkëpunim me persona të tjerë, dënohet me burgim nga tre gjer në dhjetë vjet.

Neni 176

**Kontrabanda e vlerave kulturore**

Importimi, eksportimi apo tranzitimi i vlerave kulturore kombëtare në kundërshtim me dispozitat ligjore në lidhje me to, dënohen me burgim gjer në dhjetë vjet.

Neni 177

**Kontrabanda me mallra me regjim të ndërmjetëm**

Importimi, eksportimi apo tranzitimi i mallrave, duke i paraqitur ato si mallra me regjim të ndërmjetëm, me qëllim shmangien nga detyrimet doganore, dënohen me gjobë ose me burgim gjer në pesë vjet.

Neni 178

**Tregtimi dhe transportimi i mallrave që janë kontrabandë**

*(Ndryshuar me ligjin nr.8733, datë 24.1.2001, neni 49)*

Tregtimi, tjetërsimi ose transportimi i mallrave që dihet që janë kontrabandë, si dhe çdo ndihmë tjetër që u jepet personave që merren me këto veprimtari, dënohet me gjobë ose me burgim gjer në tre vjet.

Neni 179

**Ruajtja apo depozitimi i mallrave kontrabandë**

Ruajtja, depozitimi, mbajtja apo përpunimi i mallrave që dihen se janë kontrabandë, dënohen me gjobë ose me burgim gjer në tre vjet.

Neni 179/a

**Mosdeklarimi në kufi i të hollave dhe i sendeve me vlerë**

*(Shtuar me ligjin nr.9086, datë 19.6.2003, neni 6)*

Mosdeklarimi, në hyrje ose dalje nga territori i Republikës së Shqipërisë, i shumave në të holla, i çdo lloj forme të çekut bankar, metaleve ose gurëve të çmuar, si dhe i sendeve të tjera me vlerë, përtej vlerës së parashikuar nga ligji, përbëjnë kundërvajtje penale dhe dënohen me gjobë ose me burgim deri në dy vjet.

---

### **Vendim i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë nr.1, datë 26.3.2002**

*Në seksionin e V-të ligjvënësi ka përfshirë krimet në fushën e doganave, duke i ndarë në nëntë figura të veçanta krimi (nenet 171-179 të Kodit Penal), të cilat, me përjashtim të figurave të krimit parashikuar nga nenet 178 (tregtimi i mallrave që janë kontrabandë) dhe 179 (ruajtja apo depozitimi i mallrave kontrabandë), janë forma specifike të figurës së përgjithshme të kontrabandës, variante të veçanta të saj.*

*Në këtë përfundim arrihet pasi objektin e përgjithshëm të gjithë këtyre figurave të veçanta krimi, që përfshihen në këtë seksion, e përbëjnë të njëjtat marrëdhënie shoqërore. E përbëjnë marrëdhëniet shoqërore që janë vendosur për funksionimin normal të doganave në Republikën e Shqipërisë dhe për mbrojtjen e interesave ekonomike të saj nga çfarëdolloj veprimtarie që ka për qëllim shmangien nga pagimi në Buxhetin e Shtetit të detyrimeve doganore, të cilat, në analizë të fundit, llogariten në të holla.*

*Ndarja e figurës së përgjithshme të krimit të kontrabandës në shtatë figura të veçanta kontrabande është bërë nga ligjvënësi duke u nisur, së pari, nga natyra e mallrave me të cilat bëhet kontrabanda, regjimi juridik i tyre; së dyti, nga shkalla e rrezikshmërisë shoqërore të secilit prej këtyre llojeve të kontrabandës dhe, së fundi, nga subjekti, duke krijuar, kështu, kushte ligjore të përshtatshme për të bërë të mundur zhvillimin e një lufte sa më efektive kundër kriminalitetit në një sferë aq të rëndësishme të ekonomisë, siç është ajo e veprimtarisë së organeve të doganës.*

*Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, duke u nisur nga parimet e përgjithshme të doktrinës të së drejtës penale sipas të cilave kur ndodhemi para figurave specifike të veprës penale (delictum proprium), në të cilat bashkezekutimi është i mundur vetëm midis personave që janë mbajtës të disa cilësive të veçanta për të qenë subjekte të disa veprave penale, (subjekte të posaçme), vepra penale e kryer prej tyre do të cilësohet sipas dispozitës së Pjesës së Posaçme të Kodit Penal, subjekt i të cilës mund të jenë vetëm personat që janë mbajtës të këtyre cilësive të veçanta. E tillë është edhe figura e krimit të kontrabandës nga punonjës të doganave parashikuar nga neni 175 i Kodit Penal.*

*Figura e krimit të kontrabandës me mallra në regjim të ndërmjetëm, parashikuar nga neni 177 i Kodit Penal dhe ajo e kontrabandës nga punonjës që lidhen me veprimtarinë doganore, parashikuar nga neni 177 i këtij Kodi, nuk konkurrojnë as me njëra-tjetrën, as edhe me figurat e tjera të krimit të kontrabandës që përfshihen në seksionin e V të nenit të III të Kodit Penal, në të cilin janë përfshirë krimet në fushën e doganave (nenet 171-179 të Kodit Penal).*

*Në këtë përfundim arrihet duke u nisur, së pari, nga fakti që, ashtu sikurse u përmend, objekti i të gjitha këtyre figurave krimi është i njëjtë (marrëdhëniet shoqërore që janë vendosur për funksionimin normal të doganave në Republikën e Shqipërisë dhe për mbrojtjen e interesave të shtetit) dhe, së dyti, nga fakti që vet ligjvënësi, për arsye praktike, duke dashur të lehtësojë zbatimin sa më të drejtë të tyre në funksion të zhvillimit të një lufte sa më efektive në këtë fushë të kriminalitetit, e ka ndarë kontrabandën në disa figura krimi, të cilat, teorikisht dhe praktikisht, mund të përbënin paragrafe të veçantë të së njëjtës dispozitë të Pjesës së Posaçme të Kodi Penal.*

*Figura e krimit nga punonjës që lidhen me veprimtarinë doganore, parashikuar nga neni 175 i Kodit Penal, nuk konkurron as me figurën e krimit të shpërdorimit të detyrës, parashikuar nga neni 248 i tij.*

Në këtë përfundim arrihet duke u nisur nga fakti se, anën objektive të figurës së krimit të shpërdorimit të detyrës, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, të cilin ligjvënësi, veç të tjerave, e ka shprehur edhe me fjalët: “Kryerja... e veprimeve në kundërshtim me ligjin që përbën mospërbushje të rregullt të detyrës”, që janë shumë të përgjithshme, në figurën e krimit të parashikuar nga neni 175 i Kodit Penal, këtë element përbërës të kësaj figure krimi, e ka konkretizuar, duke e shprehur me fjalët: “Kryerja e kontrabandës...” veprimtari kjo, e cila është e qartë që është në kundërshtim me ligjin dhe me përbushjen e rregullt të detyrës të një kategorie të caktuar personash dhe konkretisht të punonjësve që lidhen me veprimtarinë doganore.

Këta të fundit përbëjnë edhe subjektin e posaçëm të figurës së krimit, të parashikuar nga neni 175 i Kodit Penal, në të cilin mund të përfshihet një rreth i kufizuar personash, siç janë punonjësit e doganave ose punonjës të tjerë që kanë lidhje me veprimtarinë doganore dhe jo çdo punonjës i ngarkuar me funksion shtetëror ose me shërbim publik nga të cilat që përbëhet subjekti i figurës së , parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal.

Nga sa u tha më lart, arrihet në përfundimin se figura e krimit të kontrabandës nga punonjës që lidhen me veprimtarinë doganore, parashikuar nga neni 175 i Kodit Penal, është një variant i figurës së përgjithshme të krimit të shpërdorimit të detyrës, parashikuar nga neni 248 i tij, e cila realizohet në një fushë specifike të veprimtarisë shtetërore, sikurse është ajo e doganave dhe prandaj këto dy figura krimi nuk mund të konkurrojnë me njëra-tjetrën.

---

## SEKSIONI VI VEPRAT PENALE NË LIDHJE ME TAKSAT DHE TATIMET

Neni 180

### **Fshehja e të ardhurave**

*(Ndryshuar neni me ligjin 144/2013, datë 2.5.2013, neni 36)*

Fshehja apo shmangia nga pagimi e detyrimeve tatimore, nëpërmjet mosdorëzimit të dokumenteve ose mosdeklarimit të të dhënave të nevojshme, sipas legjislacionit në fuqi, dorëzimi i dokumenteve të falsifikuara, apo deklaratave ose informacioneve të rreme, me qëllim fitimin material, për vete apo për të tjerët, përmes përlllogaritjes së pasaktë të shumës së tatimit, taksës, apo kontributit, përbën veprë penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre vjet.

Kur kjo veprë kryhet me qëllim fshehjen apo shmangien nga pagimi të një detyrimi tatimor me vlerë më të lartë se pesë milionë lekë, dënohet me burgim nga dy deri në pesë vjet.

Kur kjo veprë kryhet me qëllim fshehjen apo shmangien nga pagimi të një detyrimi tatimor me vlerë më të lartë se tetë milionë lekë, dënohet me burgim nga katër deri në tetë vjet.

Neni 181

### **Mospagimi i taksave dhe tatimeve**

Mospagimi i taksave dhe tatimeve brenda afatit të caktuar, megjithë mundësinë e pagimit të tyre, nga personi ndaj të cilit janë marrë më parë masa administrative për këtë qëllim, dënohet me gjobë ose me burgim gjer në tre vjet.

Neni 181/a

### **Moskryerja e detyrave nga organet tatimore**

*(Shtuar me ligjin nr.8279, datë 15.1.1998, neni 2)*

Moskryerja e detyrave që lidhen me vjeljen brenda afatit të caktuar ligjor të taksave dhe tatimeve nga punonjësit e organeve tatimore dhe personat e tjerë zyrtarë që janë ngarkuar me këto detyra, kur bëhet për fajin e tyre dhe i sjell shtetit dëm në vlerë më të vogël se 1 milion lekë, dënohet me gjobë deri në 2 milionë lekë;

kur vlera është më e lartë se 1 milion lekë dënohet nga 3 deri në 10 vjet burgim.

Neni 182

### **Ndryshimi në aparatet matëse**

Ndryshimi apo ndërhyrja në aparatet dhe arkat matëse regjistruese e të lëshimit të kuponave, apo përdorimi i aparateve dhe arkave të ndryshuara, apo lejimi i përdorimit nga të tjerët i aparateve dhe arkave të parregullta, me qëllim shmangien nga pagimi i plotë i tatimit, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në dy vjet.

Neni 182/a

### **Prishja e shenjave të bllokimit apo pezullimit të veprimtarisë tregtare**

*(Shtuar neni me ligjin 144/2013, datë 2.5.2013, neni 37)*

Prishja me dashje e shenjave dalluese të vendosura nga administrata tatimore për bllokimin apo pezullimin e veprimtarisë tregtare, apo ushtrimi i veprimtarisë tregtare pas njoftimit të vendimit të administratës tatimore për bllokimin apo pezullimin e saj, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim deri në një vit.

## **SEKSIONI VII**

### **FALSIFIKIMI I MONEDHAVE DHE LETRAVE ME VLERË**

Neni 183

#### **Falsifikimi i monedhave**

*(Ndryshuar me ligjin nr.8733, datë 24.1.2001, neni 50)*

Falsifikimi ose vënia në qarkullim e monedhave të falsifikuara dënohet me burgim gjer në pesë vjet. Po kjo vepër, kur kryhet në bashkëpunim, më shumë se një herë ose ka sjellë pasoja të rënda, dënohet me burgim nga pesë gjer në pesëmbëdhjetë vjet.

Neni 184

#### **Falsifikimi i letrave me vlerë**

*(Ndryshuar me ligjin nr.8733, datë 24.1.2001, neni 51)*

Falsifikimi ose vënia në qarkullim i çeqeve, kambialeve, kartëkrediteve, çekudhëtarëve ose letrave të tjera me vlerë të falsifikuara, dënohet me burgim gjer në pesë vjet.

Po kjo vepër, kur kryhet në bashkëpunim, më shumë se një herë ose ka sjellë pasoja të rënda, dënohet me burgim nga tre gjer në dhjetë vjet.

Neni 185

### **Prodhimi i mjeteve për falsifikim**

*(Shtuar paragrafi i II me ligjin nr.8733, datë 24.1.2001, neni 52)*

Prodhimi apo mbajtja e mjeteve për të falsifikuar monedha, çeqe, kambiale, kartëkredite, çekudhëtari apo të tjera letra me vlerë, dënohet me gjobë ose me burgim ga një gjer në tre vjet.

Po kjo vepër, kur kryhet në bashkëpunim, më shumë se një herë ose ka sjellë pasoja të rënda, dënohet me burgim nga tre gjer në dhjetë vjet.

## SEKSIONI VIII

### FALSIFIKIMI I DOKUMENTEVE

Neni 186

#### **Falsifikimi i dokumenteve**

*(Ndryshuar me ligjin nr.9188, datë 12.2.2004, neni 4)*

*(Shfuqizuar me ligjin nr.144/2013, datë 2.5.2013, neni 48)*

Falsifikimi ose përdorimi i dokumenteve të falsifikuara dënohet me burgim deri në tre vjet.

Kur kjo vepër kryhet në bashkëpunim ose më shumë se një herë apo ka sjellë pasoja të rënda, dënohet me burgim nga gjashtë muaj deri në katër vjet.

Kur falsifikimi bëhet nga personi që ka për detyrë të lëshojë dokumentin, dënohet me burgim nga një vit deri në shtatë vjet.

Neni 186/a

#### **Falsifikimi kompjuterik**

*(Shtuar me ligjin nr.10 023, datë 27.11.2008, neni 18)*

Futja, ndryshimi, fshirja apo heqja e të dhënave kompjuterike, pa të drejtë, për krijimin e të dhënave të rreme, me qëllim paraqitjen dhe përdorimin e tyre si autentike, pavarësisht nëse të dhënat e krijuara janë drejtpërdrejt të lexueshme apo të kuptueshme, dënohen me burgim nga gjashtë muaj deri në gjashtë vjet.

Kur kjo vepër kryhet nga personi, që ka për detyrë ruajtjen dhe administrimin e të dhënave kompjuterike, në bashkëpunim, më shumë se një herë ose ka sjellë pasoja të rënda për interesin publik, dënohet me burgim tre deri në dhjetë vjet.

Neni 187

#### **Falsifikimi i dokumenteve shkollore**

Falsifikimi apo përdorimi i dokumenteve shkollore të falsifikuara dënohet me gjobë ose me burgim gjer në tre vjet.

Kur falsifikimi bëhet nga personi që ka për detyrë të lëshojë dokumentin, dënohet me gjobë ose me burgim gjer në pesë vjet.

Neni 188

### **Falsifikimi i dokumenteve shëndetësore**

Falsifikimi apo përdorimi i dokumenteve të falsifikuara shëndetësore dënohet me gjobë ose me burgim gjer në tre vjet.

Kur falsifikimi bëhet nga personi që ka për detyrë të lëshojë dokumentin, dënohet me gjobë ose me burgim gjer në pesë vjet.

Neni 189

### **Falsifikimi i letërnjoftimeve, i pasaportave ose i vizave**

*(Ndryshuar me ligjin nr.9188, datë 12.2.2004, neni 5)*

*(Shfuqizuar me ligjin nr.144/2013, datë 2.5.2013, neni 48)*

Falsifikimi ose përdorimi i letërnjoftimeve, i pasaportave apo i vizave të falsifikuara dënohet me burgim nga gjashtë muaj deri në katër vjet.

Kur kjo veprë kryhet në bashkëpunim ose më shumë se një herë apo ka sjellë pasoja të rënda, dënohet me burgim nga gjashtë muaj deri në pesë vjet.

Kur falsifikimi bëhet nga personi që ka për detyrë të lëshojë letërnjoftimin, pasaportën apo vizën, dënohet me burgim nga tre deri në shtatë vjet.

Neni 190

### **Falsifikimi i vulave, i stampave ose i formularëve**

*(Ndryshuar me ligjin nr.9188, datë 12.2.2004, neni 6;*

*shtuar me ligjin nr.9275, datë 16.9.2004, neni 15;shfuqizuar me vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.47, datë 26. 7. 2012, pjesët që parashikojnë dënimin me gjobë, si dënim kryesor, krahas dënimit me burgim)*

Falsifikimi ose përdorimi i vulave, i stampave apo i formularëve të falsifikuar ose paraqitja e rrethanave të rreme në këto të fundit, që u drejtohen organeve shtetërore, dënohet me burgim nga gjashtë muaj deri në katër vjet.

Kur kjo veprë kryhet në bashkëpunim ose më shumë se një herë apo ka sjellë pasoja të rënda, dënohet me burgim nga gjashtë muaj deri në pesë vjet.

Kur falsifikimi bëhet nga personi që ka për detyrë hartimin e tyre, dënohet me burgim nga tre deri në shtatë vjet.

Neni 191

### **Falsifikimi i akteve të gjendjes civile**

*(Ndryshuar me ligjin nr.9188, datë 12.2.2004, neni 7)*

*(shfuqizuar me vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.47, datë 26. 7. 2012, pjesët që parashikojnë dënimin me gjobë, si dënim kryesor, krahas dënimit me burgim)*

Falsifikimi apo përdorimi i akteve të gjendjes civile të falsifikuara dënohet me burgim nga tre muaj deri në dy vjet.



Kur kjo veper kryhet në bashkëpunim ose më shumë se një herë apo ka sjellë pasoja të rënda, dënohet me burgim nga gjashtë muaj deri në katër vjet.

Kur falsifikimi bëhet nga personi që ka për detyrë të lëshojë aktin, dënohet me burgim nga një deri në pesë vjet.

Neni 192

### **Prodhimi i mjeteve për falsifikim të dokumenteve**

Prodhimi apo mbajtja e mjeteve për të kryer falsifikim të dokumenteve përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në dy vjet.

Neni 192/a

### **Zhdukja dhe vjedhja e dokumenteve**

*(Shtuar me ligjin nr.8733, datë 24.1.2001, neni 53)*

Asgjësimi me çdo mënyrë i dokumenteve të arkivit ose të bibliotekës, si dhe zhdukja e vjedhja e dokumenteve që janë të një rëndësie të veçantë, në kundërshtim me kërkesat e ligjit, dënohen me gjobë ose me burgim gjer në tre vjet.

Vjedhja e dokumenteve të arkivit ose të bibliotekës, që janë të një rëndësie të veçantë, ose eksportimi i tyre në kundërshtim me kërkesat e ligjit, dënohen me gjobë ose me burgim gjer në pesë vjet.

Neni 192/b

### **Hyrja e paautorizuar kompjuterike**

*(Shtuar me ligjin nr.8733, datë 24.1.2001, neni 53;  
ndryshuar me ligjin nr.10 023, datë 27.11.2008, neni 19)*

Hyrja e paautorizuar apo në tejkallim të autorizimit për të hyrë në një sistem kompjuterik a në një pjesë të tij, nëpërmjet cenimit të masave të sigurimit, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre vjet.

Kur kjo veper kryhet në sistemet kompjuterike ushtarake, të sigurisë kombëtare, të rendit publik, të mbrojtjes civile, të shëndetësisë apo në çdo sistem tjetër kompjuterik, me rëndësi publike, dënohet me burgim nga tre deri në dhjetë vjet.

## **SEKSIONI IX**

### **VEPRA PENALE NË FUSHËN E FALIMENTIMIT**

Neni 193

### **Falimentimi i provokuar**

Çuarja me dashje e personit juridik në gjendjen e falimentimit dënohet me gjobë ose me burgim gjer në tre vjet.

Neni 194

## **Fshehja e gjendjes së falimentimit**

Hyrja në marrëdhënie ekonomike tregtare me të tretët nga ana e personit juridik, me qëllim të fshehë gjendjen e falimentimit, dënohet me gjobë ose me burgim gjer në pesë vjet.

Neni 195

## **Fshehja e pasurisë pas falimentimit**

Fshehja e pasurisë pas falimentimit të personit juridik, me qëllim që t'u shmanget pasojave të tij, dënohet me gjobë ose me burgim gjer në shtatë vjet.

Neni 196

## **Shkelja e detyrimeve**

Shkelja nga ana e personit juridik të detyrimeve që rëndojnë mbi të me rastin e falimentimit, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në dy vjet.

## **SEKSIONI X**

### **ZHVILLIMI I PALEJUAR I LOJËRAVE TË FATIT**

Neni 197

## **Organizimi i llotarive të palejuara**

Organizimi i llotarive, lojrave të fatit apo bixhozit, në kundërshtim me dispozitat ligjore, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në tre muaj.

Neni 197/a

### **Paracaktimi i rezultateve në garat sportive**

*(Shtuar me ligjin nr.10 023, datë 27.11.2008, neni 20)*

*(Shfuqizuar me ligjin nr.144/2013, datë 2.5.2013, neni 48)*

Kryerja e veprimeve ose mosveprimeve për paracaktimin e rezultateve në garat sportive, kombëtare dhe ndërkombëtare, në kundërshtim me parimet e lojës së ndershme, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me me burgim nga tre muaj deri në dy vjet.

Po kjo vepër, e kryer për qëllime të fitimit pasuror, dënohet me burgim nga dy deri në shtatë vjet.

Neni 197/b

### **Shtrembërimi i konkurrencës në garat sportive**

*(Shtuar me ligjin nr.10 023, datë 27.11.2008, neni 20)*

Shtrembërimi i konkurrencës në garat sportive prej pjesëmarrësve, nëpërmjet përdorimit të substancave të ndaluara, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim deri në dy vjet.

Neni 198

## **Vënia në dispozicion e lokaleve për lojra të palejuara**

Vënia në dispozicion e lokaleve për organizimin apo luajtjen e llotarive, lojrave të fatit apo bixhozit, në kundërshtim me dispozitat ligjore, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në gjashtë muaj.

SEKSIONI XI  
VEPRA PENALE QË CENOJNË RREGJIMIN JURIDIK  
TË TOKËS

Neni 199

**Shpërdorimi i tokës**

Shpërdorimi i tokës në kundërshtim me destinacionin e saj përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në gjashtë muaj.

Neni 199/a

**Ndërtimi i paligjshëm**

*(Shtuar me ligjin nr.10 023, datë 27.11.2008, neni 21)*

Ndërtimi i paligjshëm i një objekti në tokën e vet dënohet me gjobë ose me burgim deri në një vit.

Po kjo vepër, e kryer në tokën publike ose shtetërore apo në tokën e tjetrit, dënohet me burgim nga një deri në pesë vjet.

Neni 200

**Pushtimi i tokës**

Pushtimi i tokës përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në dy vjet.

KREU IV  
VEPRA PENALE KUNDËR MJEDISIT

Neni 201

**Ndotja e ajrit**

Ndotja e ajrit përmes çlirimit të tymrave, gazrave dhe lëndëve të tjera toksike radioaktive e bërë tej kufirit të normave të lejuara, kur vepra nuk përbën kundërvajtje administrative, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në dy vjet.

Po kjo vepër, kur ka shkaktuar pasoja të rënda për jetën e shëndetin e njerëzve, dënohet me burgim gjer në dhjetë vjet.

Neni 202

**Transportimi i mbeturinave toksike**

Transportimi tranzit apo depozitimi në territorin shqiptar të mbeturinave toksike dhe radioaktive, dënohet me burgim nga një gjer në pesë vjet.

Po kjo vepër, kur ka shkaktuar pasoja të rënda për jetën e shëndetin e njerëzve, dënohet me burgim nga pesë gjer në pesëmbëdhjetë vjet.

Neni 203  
**Ndotja e ujërave**

Ndotja e ujërave të deteve, lumenjve, liqeneve apo burimeve të rrjetit grumbullues e shpërndarës të ujërave me lëndë toksike, radioaktive apo substanca të tjera, që prishin ekuilibrin ekologjik, dënohet me burgim nga një gjer në pesë vjet.

Po kjo vepër, kur ka shkaktuar pasoja të rënda për jetën e shëndetin e njerëzve, dënohet me burgim nga pesë gjer në dhjetë vjet.

Neni 204  
**Peshkimi i ndaluar**

Peshkimi në kohë, me mjete, vende dhe mënyra të ndaluara përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në tre muaj.

Peshkimi i kryer me mjete të rrezikut të përbashkët si eksploziv, lëndë helmuese etj., përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në dy vjet.

Neni 205  
**Prerja e paligjshme e pyjeve**

Prerja apo dëmtimi i pyjeve pa leje apo në kohë dhe vende të ndaluara, kur vepra nuk përbën kundërvajtje administrative, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në një vit.

Neni 206  
**Prerja e drurëve dekorativë dhe frutorë**

Prerja e drurëve dekorativë dhe dëmtimi i lulishteve dhe parqeve nëpër qytete përbëjnë kundërvajtje penale dhe dënohen me gjobë.

Prerja e drurëve në pemëtore, ullishta e vreshta, pasi është refuzuar më parë leja e prerjes nga organet kompetente, përbën kundërvajtje penale e dënohet me burgim gjer në tre muaj.

Neni 206/a  
**Shkatërrimi me zjarr i pyjeve dhe i mjedisit pyjor**  
*(Shtuar me ligjin nr.10 023, datë 27.11.2008, neni 22)*  
*(Ndryshuar me ligjin 144/2013, datë 2.5.2013, neni 38)*

Shkatërrimi apo dëmtimi me dashje, me pasoja të rënda materiale, i fondit pyjor, i fidanishtes pyjore, i grumbullit pyjor ose i çdo njësie të ngjashme me to, me zjarr, dënohet me burgim nga pesë deri në tetë vjet.

Po kjo vepër, e kryer me qëllim ndryshimin e kategorisë dhe destinacionit të tokës, dënohet me burgim nga pesë deri në pesëmbëdhjetë vjet.

Po kjo vepër, kur ka shkaktuar pasoja të rënda për pronën, shëndetin ose jetën e njerëzve apo shkakton dëme të rënda dhe të zgjatura në kohë ndaj mjedisit apo zonave të mbrojtura, dënohet me burgim nga dhjetë deri në njëzet vjet.

Neni 206/b

**Shkatërrimi nga pakujdesia me zjarr i pyjeve dhe i mjedisit pyjor**

*(Shtuar me ligjin nr.10 023, datë 27.11.2008, neni 22)*

*(Ndryshuar me ligjin 144/2013, datë 2.5.2013, neni 39)*

Shkatërrimi apo dëmtimi nga pakujdesia, me pasoja të rënda materiale, i fondit pyjor, i fidanishtes pyjore, i grumbullit pyjor ose i çdo njësie të ngjashme me to, me zjarr, dënohet me burgim nga dy deri në pesë vjet.

Po kjo vepër, kur ka shkaktuar pasoja të rënda për pronën, shëndetin ose jetën e njerëzve apo shkakton dëme të rënda dhe të zgjatura në kohë ndaj mjedisit apo zonave të mbrojtura, dënohet me burgim nga tre deri në tetë vjet.

Neni 207

**Shkelja e karantinës së bimëve dhe kafshëve**

Shkelja e rregullave për karantinën e bimëve apo të kafshëve, kur ka sjellë pasoja të rënda materiale ose që rrezikojnë jetën e shëndetin e njerëzve, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë.

KREU V

KRIME KUNDËR PAVARËSISË DHE RENDIT KUSHTETUES

SEKSIONI I

KRIME KUNDËR PAVARËSISË DHE INTEGRITETIT

Neni 208

**Dorëzimi i territorit**

*(Ndryshuar me ligjin nr.8733, datë 24.1.2001, neni 79)*

Dorëzimi plotësisht apo pjesërisht i territorit një shteti apo fuqie të huaj, me qëllim për të cenuar pavarësinë dhe integritetin e vendit, dënohet me burgim jo më pak se pesëmbëdhjetë vjet ose me burgim të përjetshëm.

Neni 209

### **Dorëzimi i forcave të armatosura**

*(Ndryshuar me ligjin nr.8733, datë 24.1.2001, neni 79)*

Dorëzimi plotësisht apo pjesërisht i forcave të armatosura apo materialeve mbrojtëse ose furnizimi me armë e municion i një shteti apo fuqie të huaj, me qëllim për të cenuar pavarësinë dhe integritetin e vendit, dënohet me burgim jo më pak se pesëmbëdhjetë vjet ose me burgim të përjetshëm.

Neni 210

### **Marrëveshja për dorëzim territori**

Marrëveshja e bërë me fuqi apo shtete të huaja për dorëzim pjesërisht ose tërësisht të territorit apo të forcave të armatosura e materialeve mbrojtëse, me qëllim për të cenuar integritetin e vendit, dënohet me burgim nga pesë gjer në dhjetë vjet.

Neni 211

### **Provokimi i luftës**

Kryerja e veprimeve që synojnë të provokojnë luftë apo të vënë Republikën e Shqipërisë përpara rrezikut të ndërhyrjes nga fuqi të huaja, dënohet me burgim jo më pak se pesëmbëdhjetë vjet.

Neni 212

### **Marrëveshja për ndërhyrje të armatosur**

Marrëveshja e bërë me fuqi apo shtete të huaja për të shkaktuar ndërhyrje të armatosur kundër territorit të Republikës së Shqipërisë, dënohet me burgim nga dhjetë gjer në pesëmbëdhjetë vjet.

Neni 213

### **Dhënia e informatave sekrete**

Dhënia e informatave sekrete me karakter ushtarak apo të çdo lloji tjetër një fuqie të huaj për të cenuar pavarësinë e vendit, dënohet me burgim nga dhjetë gjer në njëzet vjet.

Neni 214

### **Sigurimi i informatave**

Sigurimi i informatave sekrete me karakter ushtarak apo të çdo lloji tjetër, me qëllim që t'i jepen një fuqie të huaj, për të cenuar pavarësinë e vendit, dënohet me burgim nga tre gjer në dhjetë vjet.

Neni 215

### **Dëmtimi i objekteve mbrojtëse**

Shkatërrimi apo dëmtimi i mjeteve, pajisjeve, aparaturave, armatimit, teknikës luftarake apo objekteve mbrojtëse ushtarake, me qëllim uljen e aftësisë mbrojtëse të vendit, dënohet me burgim nga pesë gjer në pesëmbëdhjetë vjet.

Neni 216

### **Sigurimi i mjeteve për shkatërrimin e teknikës luftarake**

Prodhimi apo mbajtja e mjeteve për të shkatërruar ose dëmtuar pajisjet, aparaturat, armatimin, mjetet e teknikës luftarake apo objektet mbrojtëse ushtarake, me qëllim uljen e aftësisë mbrojtëse të vendit, dënohet me burgim gjer në dhjetë vjet.

Neni 217

### **Marrja e shpërblimeve**

Marrja apo marrëveshja për të marrë shpërblim apo përfitime të tjera materiale, për të kryer në favor të shteteve apo fuqive të huaja një nga krimet e parashikuara në këtë seksion, dënohet me burgim nga pesë gjer në dhjetë vjet.

Neni 218

### **Vënia në shërbim të shteteve të huaja**

Vënia në shërbim të një shteti apo një fuqie të huaj të çdo shtetasi shqiptar, me qëllim kryerjen e veprave kundër pavarësisë dhe integritetit të Republikës së Shqipërisë, dënohet me burgim nga tre gjer në dhjetë vjet.

## **SEKSIONI II**

### **KRIME KUNDËR RENDIT KUSHTETUES**

Neni 219

#### **Atentati**

*(Ndryshuar me ligjin nr.8733, datë 24.1.2001, neni 79)*

Kryerja e vrasjeve, rrëmbimeve, torturave apo akteve të tjera të dhunës kundër përfaqësuesve më të lartë të shtetit, me qëllim për të përmbysur rendin kushtetues, dënohet me burgim jo më pak se pesëmbëdhjetë vjet ose me burgim të përjetshëm.

Neni 220

#### **Komploti**

Marrja e vendimeve dhe krijimi i kushteve materiale nga një grup njerëzish për të kryer atentat dënohet me burgim nga pesë gjer në pesëmbëdhjetë vjet.

Neni 221

#### **Kryengritja**

*(Ndryshuar paragrafi II me ligjin nr.8733, datë 24.1.2001, neni 79)*

Pjesëmarrja në veprime masive të dhunshme, si vendosje pengesash apo barrikadash për të ndalur forcat e rendit, rezistenca me armë apo çarmatosja e tyre, pushtimi me forcë i ndërtesave, kryerja e

plaçkitjeve, grumbullimi apo vënia në dispozicion e armëve, municioneve dhe njerëzve, krijimi i lehtësirave në favor të kryengritësve, të bëra për të përmbysur rendin kushtetues, dënohen me burgim nga pesëmbëdhjetë gjer në njëzet e pesë vjet.

Marrja pjesë si udhëheqës apo organizator në veprimet e mësipërme dënohet me burgim të përjetshëm.

Neni 222

### **Thirrjet për armatosje ose marrja pa të drejtë e komandës**

Thirrjet për armatosje kundër rendit kushtetues, krijimi apo organizimi i forcave të armatosura në kundërshtim me ligjin, marrja pa të drejtë e komandës së forcave të armatosura për të kryer veprime luftarake, me qëllim për t'iu kundërvënë rendit kushtetues, dënohen me burgim nga pesë gjer në dhjetë vjet.

Neni 223

### **Thirrjet publike për veprime të dhunshme**

Thirrjet e bëra publikisht për të kryer vepra të dhunshme kundër rendit kushtetues, dënohen me gjobë ose me burgim gjer në tre vjet.

Neni 224

### **Krijimi i partive dhe shoqatave antikushtetuese**

Krijimi apo pjesëmarrja në parti, organizata apo shoqata që synojnë përmbysjen me dhunë të rendit kushtetues, dënohet me gjobë ose me burgim gjer në tre vjet.

Rikrijimi i një partie, organizate ose shoqate të shpërndarë si antikushtetuese apo vazhdimi i veprimtarisë në mënyrë të fshehtë ose të hapur, dënohet me burgim nga një gjer në pesë vjet.

Neni 225

### **Shpërndarja e shkrimeve antikushtetuese**

Shpërndarja e shkrimeve apo përdorimi i simboleve që i përkasin një partie, organizate apo shoqate antikushtetuese ose që është e shpërndarë si e tillë, dënohet me gjobë ose me burgim gjer në tre vjet.

Shpërndarja apo futja e materialeve, shkrimeve apo simboleve nga jashtë në Republikën e Shqipërisë, të cilat synojnë përmbysjen e rendit kushtetues a cenimin e tërësisë tokësore të vendit, dënohet me gjobë ose me burgim gjer në tre vjet.

KREU VI

## **KRIME QË CENOJNË MARRËDHËNIET ME SHTETET E TJERA**

Neni 226

### **Veprat e dhunshme ndaj personave të mbrojtur ndërkombëtarisht**

*(Ndryshuar me ligjin nr.23/2012, datë 1.3.2012, neni 24)*

Kryerja e veprave të dhunshme ndaj personave të mbrojtur ndërkombëtarisht, dënohet me burgim gjer në dhjetë vjet.



Neni 227

**Fyerja ndaj përfaqësuesve të shteteve të huaja**  
(Shfuqizuar me ligjin nr.23/2012, datë 1.3.2012, neni 57)

Neni 228

**Veprimet e dhunshme ndaj vendeve të punës së personave të mbrojtur ndërkombëtarisht**  
(Ndryshuar me ligjin nr.23/2012, datë 1.3.2012, neni 26)

Kryerja e veprimeve të dhunshme ndaj vendeve të punës, banimit, mjeteve të transportit të personave të mbrojtur ndërkombëtarisht, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në një vit.

Kur nga vepra kanë ardhur pasoja të rënda materiale apo janë sjellë ndërlikime në marrdhëniet dypalëshe, dënohet me burgim gjer në dhjetë vjet.

Neni 229

**Veprimet fyese ndaj himnit e flamurit**  
(Shfuqizuar me ligjin nr.23/2012, datë 1.3.2012, neni 57)

## KREU VII

### VEPRA ME QËLLIME TERRORISTE

(Ndryshuar titulli me ligjin nr.9686, datë 26.2.2007, neni 14)

Neni 230

#### **Vepra me qëllime terroriste**

(Ndryshuar me ligjin nr.9686, datë 26.2.2007, neni 15;  
ndryshuar me ligjin nr.23/2012, datë 1.3.2012, neni 27)

Kryerja e veprave të mëposhtme, me qëllim përhapjen e panikut në popullatë ose për të detyruar organe shtetërore, shqiptare ose të huaja, të kryejnë ose të mos kryejnë një akt të caktuar, ose për të shkatërruar apo destabilizuar, në mënyrë serioze, struktura thelbësore politike, kushtetuese, ekonomike ose sociale të shtetit shqiptar, të një shteti tjetër, institucioni apo organizate ndërkombëtare, dënohet me burgim jo më pak se pesëmbëdhjetë vjet ose me burgim të përjetshëm.

Veprat me qëllime terroriste përfshijnë:

- a) veprat kundër personit, të cilat mund të shkaktojnë vdekjen ose plagosjen e rëndë;
- b) rrëmbimin e avionëve, të anijeve, të mjeteve të tjera të transportit apo të platformave fikse ose ushtrimin e paligjshëm të kontrollit mbi to, me dhunë ose nëpërmjet kanosjes për përdorimin e dhunës apo me anë të çdo forme tjetër kanosjeje;
- c) kryerjen e akteve të dhunës kundër një personi në bordin e një avioni në fluturim, në bordin e një anijeje ose në bordin e një platforme fikse, kur këto akte mund të rrezikojnë sigurinë e avionit, të mjetit të lundrimit ose të platformës fikse;
- ç) shkatërrimin e një avioni në funksionim, të një anijeje apo të një platforme fikse ose shkaktimin e dëmeve të tilla avionit, anijes a ngarkesës së saj ose platformës fikse, që e bëjnë të pamundur ose rrezikojnë a mund të rrezikojnë sigurinë e fluturimit, të lundrimit ose të platformës fikse;

d) vendosjen, me çdo mjet, në një avion në shërbim, në një anije ose në një platformë fikse, të një pajisjeje a substancë që mund të shkatërrojë avionin, anijen a platformën fikse ose që mund t'i shkaktojë dëme avionit, anijes a ngarkesës së saj ose platformës fikse dhe që rrezikon a mund të rrezikojë sigurinë e fluturimit, lundrimit të anijes ose të platformës fikse;

dh) shkatërrimin ose dëmtimin e pajisjeve të fluturimit apo të pajisjeve të lundrimit detar ose ndërhyrjen në funksionimin e tyre, kur nga një akt i tillë mund të rrezikohet siguria e avionit apo e anijes;

e) përhapjen e informacioneve që dihet se janë të pavërteta, duke rrezikuar sigurinë e një avioni në fluturim apo të anijes në lundrim;

ë) vrasjen ose rrëmbimin e një personi të mbrojtur ndërkombëtarisht, sipas nenit 9 të këtij Kodi, ose çdo sulm tjetër ndaj tij ose lirisë së tij;

f) sulmin e dhunshëm ndaj zyrës, banesës private ose mjetit të transportit të personit të mbrojtur ndërkombëtarisht, sipas nenit 9 të këtij Kodi, kur prej këtij sulmi rrezikohet personi ose liria e tij;

g) pengmarrjen ose rrëmbimin e personit dhe kanosjen për të vrarë, për të plagosur ose për të vazhduar mbajtjen e tij peng;

gj) marrjen në dorëzim, posedimin, përdorimin, transferimin, tjetërsimin, disponimin ose përhapjen e materialit bërthamor, me dashje dhe pa qenë i autorizuar ligjërisht, kur i shkaktohet ose mund t'i shkaktohet vdekja ose dëmtime të rënda çdo personi ose të dëmtohet rëndë prona;

h) vjedhjen, përvetësimin ose përfitimin nëpërmjet mashtrimit të materialeve bërthamore;

i) kërkimin e materialeve bërthamore, duke përdorur shtrëngimin, dhunën ose çdo formë tjetër kanosjeje;

j) prodhimin, mbajtjen, blerjen, transportin apo tregtimin e lëndëve plasëse, të armëve të zjarrit, biologjike, kimike apo bërthamore, si dhe kërkimin shkencor për prodhimin e armëve të shkatërrimit në masë;

k) kryerjen e akteve të dhunës, duke përdorur çdo pajisje, substancë ose armë, kundër një personi në një aeroport të aviacionit civil ndërkombëtar, kur këto akte shkaktojnë ose mund të shkaktojnë dëmtime të rënda ose vdekjen e personave;

l) shkatërrimin ose dëmtimin e rëndë të mjediseve apo të pajisjeve në një aeroport të aviacionit civil ndërkombëtar ose në një avion të vendosur në këtë aeroport që nuk është në fluturim ose ndërprerjen e shërbimeve të aeroportit, duke përdorur çdo pajisje ose armë, kur nga ky akt rrezikohet a mund të rrezikohet siguria e aeroportit;

ll) përhapjen, vendosjen, shkarkimin ose shpërthimin e lëndëve plasëse ose të pajisjeve të tjera vdekjeprurëse, në mjedise publike, në zyrat e një shteti ose qeverie, sistemin e transportit publik ose në infrastrukturën publike, si dhe shpërndarjen në mjedis të substancave të rrezikshme, shkaktimin e zjarreve, të përmytjeve, shpërthimeve, me qëllim shkaktimin e vdekjes ose dëmtimeve të rënda trupore ose me qëllim shkaktimin e shkatërrimeve masive të vendeve, mjediseve ose sistemeve të lartpërmendura, kur ky shkatërrim sjell a mund të sjellë humbje të mëdha ekonomike;

m) shkatërrimin e rëndë dhe në përmasa të mëdha të pronës publike, të infrastrukturës publike, të sistemit të transportit, të sistemit të informacionit e të pronës private, duke rrezikuar jetën e personave;

n) shkaktimin e ndërprerjes së furnizimit me ujë, energji elektrike ose çdo burim tjetër të rëndësishëm;

apo çdo vepër tjetër që synon të shkaktojë vdekjen ose plagosjen e rëndë të civilëve ose të çdo personi tjetër që nuk merr pjesë aktive në veprimet luftarake në një situatë konflikti të armatosur, e kryer për qëllimet e përcaktuara në paragrafin e parë të këtij neni.

Veprimet që shkaktojnë ndërprerjen e një shërbimi të rëndësishëm, një sistemi, një veprimtarie publike ose private, si rezultat i protestës, i mosbindjes civile, ose i grevës, nuk do të konsiderohen vepra me qëllime terroriste në kuptimin e këtij neni.

Neni 230/a

**Financimi i terrorizmit**

*(Shtuar me ligjin nr.9086, datë 19.6.2003, neni 7;  
ndryshuar me ligjin nr.23/2012, datë 1.3.2012, neni 28)  
(Shfuqizuar me ligjin nr.144/2013, datë 2.5.2013, neni 48)*

Dhënia ose grumbullimi i fondeve, me çdo mjet, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, me qëllimin që ato të përdoren ose duke ditur se ato do të përdoren, plotësisht ose pjesërisht:

- a) për të kryer vepra me qëllime terroriste;
- b) nga një organizatë terroriste;
- c) nga një terrorist i vetëm;

dënohet jo më pak se pesëmbëdhjetë vjet burgim ose me burgim të përjetshëm.

Dispozitat e këtij neni zbatohen:

a) për të gjitha fondet, ku përfshihen pasuri të çdo lloji, të trupëzuara ose të patrupëzuara, të luajtshme ose të paluajtshme, pavarësisht nga mënyra e fitimit të tyre, dhe dokumente ligjore ose instrumente të çdo lloji, edhe në formë elektronike ose digjitale, që tregojnë të drejta ose interesa mbi pasuri të tilla, përfshirë kreditë bankare, çeqet e udhëtarëve, çeqet bankare, urdhërpagesat, aksionet, letrat me vlerë, bonot, çeqet e garantuara bankare, letrat e kreditit, si dhe çdo instrument tjetër financiar, të ngjashëm me to;

b) pavarësisht nëse personi që kryen një nga veprat e parashikuara në paragrafin e parë të këtij neni, ndodhet në të njëjtin shtet a në një shtet të ndryshëm nga ai, në të cilin ndodhet organizata terroriste a terroristi i vetëm ose nga shteti në të cilin është kryer a do të kryhet vepra me qëllime terroriste;

c) në rastin e parashikuar nga paragrafi i parë i këtij neni, pavarësisht nëse fondet janë përdorur në fakt për të kryer veprën ose veprat, për të cilat ishin dhënë ose grumbulluar, apo nëse mund të vendoset një lidhje mes fondeve dhe një apo më shumë veprave konkrete me qëllime terroriste.

Dijenia dhe qëllimi, sipas paragrafit të parë të këtij neni, nxirren nga rrethana fakti objektive.

Neni 230/b

**Fshehja e fondeve dhe e pasurive të tjera, që financojnë terrorizmin**

*(Shtuar me ligjin nr.9275, datë 16.9.2004, neni 16)  
(Shfuqizuar me ligjin nr.144/2013, datë 2.5.2013, neni 48)*

Transferimi, konvertimi, fshehja, lëvizja ose tjetërsimi i fondeve dhe i pasurive të tjera, ndaj të cilave zbatohen masat kundër financimit të terrorizmit, për të shmangur zbulimin dhe vendndodhjen e tyre, dënohen me burgim nga katër deri në dymbëdhjetë vjet.

Kur kjo veprë kryhet gjatë ushtrimit të një veprimtarie profesionale, në bashkëpunim ose më shumë se një herë, dënohet me burgim nga shtatë deri në pesëmbëdhjetë vjet dhe me gjobë nga një milion deri në tetë milionë lekë, ndërsa kur kryerja e kësaj vepre ka sjellë pasoja të rënda, dënohet me burgim jo më pak se pesëmbëdhjetë vjet.

Neni 230/c

**Dhënia e informacioneve nga persona që ushtrojnë funksione publike ose në ushtrim të detyrës a profesionit**

*(Shtuar me ligjin nr.9275, datë 16.9.2004, neni 16)*

*(Shfuqizuar me ligjin nr.144/2013, datë 2.5.2013, neni 48)*

Vënia në dijeni e personave të shpallur ose e personave të tjerë për të dhënat për verifikimin ose hetimin e fondeve dhe pasurive të tjera, ndaj të cilave zbatohen masa kundër financimit të terrorizmit, nga persona që ushtrojnë funksione publike ose që janë në ushtrim të detyrës a profesionit, dënohet me burgim nga pesë deri në dhjetë vjet.

Neni 230/ç

**Kryerja e shërbimeve dhe veprimeve me persona të shpallur**

*(Shtuar me ligjin nr.9275, datë 16.9.2004, neni 16)*

*(Shfuqizuar me ligjin nr.144/2013, datë 2.5.2013, neni 48)*

Dhënia e fondeve dhe pasurive të tjera, kryerja e shërbimeve financiare, si dhe e transaksioneve të tjera me persona të shpallur, ndaj të cilëve zbatohen masa kundër financimit të terrorizmit, dënohen me burgim nga katër deri në dhjetë vjet.

Neni 230/d

**Grumbullimi i fondeve për financimin e terrorizmit**

*(Shtuar me ligjin nr.9686, datë 26.2.2007, neni 16;*

*shfuqizuar me ligjin nr.23/2012, datë 1.3.2012, neni 57)*

Neni 231

**Rekrutimi i personave për kryerjen e veprave me qëllimeve terroriste ose të financimit të terrorizmit**

*(Ndryshuar me ligjin nr.9686, datë 26.2.2007, neni 17)*

Rekrutimi i një ose më shumë personave për kryerjen e veprave me qëllime terroriste ose të financimit të terrorizmit, edhe kur këto vepra drejtohen kundër një shteti tjetër, institucioni apo organizate ndërkombëtare, nëse nuk përbën vepër tjetër penale, dënohet me burgim jo më pak se dhjetë vjet.

Neni 232

**Stërvitja për kryerjen e veprave me qëllime terroriste**

*(Ndryshuar me ligjin nr.9686, datë 26.2.2007, neni 18)*

Përgatitja, stërvitja dhe dhënia në çdo formë e udhëzimeve edhe në mënyrë anonime ose në rrugë elektronike, për prodhimin ose përdorimin e lëndëve eksplozive, armëve të zjarrit dhe municioneve luftarake, të armëve të tjera dhe lëndëve kimike, bakteriologjike apo bërthamore ose të çdo natyre tjetër, të dëmshme dhe të rrezikshme për njerëzit dhe pasurinë, si dhe të teknikave e të metodave të tjera për kryerjen e veprave me qëllime terroriste dhe pjesëmarrja në veprimtari të tilla, edhe kur këto vepra drejtohen kundër një shteti tjetër, institucioni apo organizate ndërkombëtare, nëse nuk përbën vepër tjetër penale, dënohen me burgim jo më pak se shtatë vjet.

Neni 232/a

**Nxitja, thirrja publike dhe propaganda për kryerjen e veprave me qëllime terroriste**

*(Shtuar me ligjin nr.9686, datë 26.2.2007, neni 19)*

Nxitja, thirrja publike, shpërndarja e shkrimeve ose propaganda në forma të tjera, që synon mbështetjen ose kryerjen e një apo më shumë veprave për qëllime terroriste dhe për financimin e terrorizmit, nëse nuk përbën vepër tjetër penale, dënohet me burgim nga katër deri në dhjetë vjet.

Neni 232/b

**Kanosja për kryerjen e veprave me qëllime terroriste**

*(Shtuar me ligjin nr.9686, datë 26.2.2007, neni 19)*

Kanosja serioze për kryerjen e veprave për qëllime terroriste, që i bëhet një autoriteti publik, edhe të një shteti tjetër, institucioni apo organizate ndërkombëtare, dënohet me burgim nga tetë deri në pesëmbëdhjetë vjet.

Neni 233

**Krijimi i turmave të armatosura**

Krijimi i turmave të armatosura për t'iu kundërvënë rendit publik me anë të veprimeve të dhunshme ndaj jetës, shëndetit, lirisë vetjake të personit, pasurisë, me qëllim ngjalljen e frikës e të pasigurisë në masë, dënohet me burgim gjer në dhjetë vjet.

Neni 234

**Prodhimi i armëve luftarake**

Prodhimi, mbajtja, transportimi i armëve luftarake, kimike, biologjike, bërthamore, me bazë helmuese ose eksplozive, me qëllim për të kryer vepra terrori, dënohen me burgim nga pesë gjer në pesëmbëdhjetë vjet.

Neni 234/a

**Organizata terroriste**

*(Shtuar me ligjin nr.9275, datë 16.9.2004, neni 17)*

Krijimi, organizimi, drejtimi dhe financimi i organizatës terroriste dënohen me burgim jo më pak se pesëmbëdhjetë vjet.

Pjesëmarrja në organizata terroriste dënohet me burgim nga shtatë deri në pesëmbëdhjetë vjet.

Neni 234/b

**Banda e armatosur**

*(Shtuar me ligjin nr.9275, datë 16.9.2004, neni 17)*

Krijimi, organizimi, drejtimi dhe financimi i bandës së armatosur dënohen me burgim nga dhjetë deri në pesëmbëdhjetë vjet.

Pjesëmarrja në bandën e armatosur dënohet me burgim nga pesë deri në dhjetë vjet.

KREU VIII  
KRIME KUNDËR AUTORITETIT TË SHTETIT

SEKSIONI I  
VEPRA PENALE KUNDËR VEPRIMTARISË SHTETËRORE TË KRYERA NGA SHTETASIT

Neni 235

**Kundërshtimi i punonjësit që kryen një detyrë shtetërore  
ose një shërbim publik**

*(Ndryshuar paragrafi II me ligjin nr.8733, datë 24.1.2001, neni 54)*

Kundërshtimi që i bëhet një punonjësi që kryen një detyrë shtetërore apo një shërbim publik, me qëllim për ta penguar atë për të kryer detyrën apo shërbimin sipas ligjit, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në gjashtë muaj.

Po kjo vepër, kur kryhet në bashkëpunim ose duke ushtruar dhunë fizike ose më shumë se një herë, dënohet me gjobë ose me burgim gjer në pesë vjet.

Neni 236

**Kundërshtimi i punonjësit të policisë së rendit publik**

*(Ndryshuar paragrafi i II me ligjin nr.8733, datë 24.1.2001, neni 55;  
ndryshuar paragrafi i dytë me ligjin nr.9686, datë 26.2.2007, neni 20)*

Kundërshtimi që i bëhet punonjësit të policisë së rendit publik, me qëllim për ta penguar atë për të kryer detyrën sipas ligjit, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në një vit.

Po kjo vepër, kur kryhet në bashkëpunim ose duke ushtruar dhunë fizike ose më shumë se një herë, dënohet me gjobë ose me burgim gjer në shtatë vjet.

Neni 237

**Goditjet për shkak të detyrës**

Goditjet ose vepra të tjera dhune që i bëhen punonjësit që kryen një detyrë shtetërore apo një shërbim publik, për shkak të veprimtarisë së tij shtetërore apo të shërbimit, dënohen me gjobë ose me burgim gjer në tre vjet.

Neni 238

**Kanosja për shkak të detyrës**

Kanosja serioze për vrasje apo për plagosje të rëndë, që i bëhet punonjësit që kryen një detyrë shtetërore apo një shërbim publik, për shkak të veprimtarisë së tij shtetërore ose të shërbimit, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në dy vjet.

Neni 239

**Fyerja për shkak të detyrës**

*(Ndryshuar me ligjin nr.8733, datë 24.1.2001, neni 56;  
shfuqizuar me ligjin nr.23/2012, datë 1.3.2012, neni 57)*

Neni 240

**Shpifja për shkak të detyrës**

*(Ndryshuar paragrafi II me ligjin nr.8733, datë 24.1.2001, neni 57;  
shfuqizuar me ligjin nr.23/2012, datë 1.3.2012, neni 57)*

Neni 241

**Shpifja ndaj Presidentit të Republikës**

*(Shfuqizuar me ligjin nr.23/2012, datë 1.3.2012, neni 57)*

Neni 242

**Mosbindja ndaj urdhrimit të punonjësit të policisë  
së rendit publik**

Mosbindja ndaj urdhrave të ligjshme të punonjësit të policisë së rendit publik përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në tre muaj.

Neni 243

**Goditjet ndaj pjesëtarëve të familjes së personit që kryen një detyrë shtetërore**

Goditjet ose vepra të tjera dhune që i bëhen pjesëtarit të familjes së një personi që kryen një detyrë shtetërore ose një shërbim publik, për të penguar në kryerjen e detyrës apo të shërbimit ose për shkak të kësaj veprimtarie, dënohen me gjobë ose me burgim gjer në pesë vjet.

Neni 244

**Korrupsioni aktiv i personave që ushtrojnë funksione publike**

*(Ndryshuar me ligjin nr.9275, datë 16.9.2004, neni 18)*

*(Shfuqizuar me ligjin nr.144/2013, datë 2.5.2013, neni 48)*

Premtimi, propozimi ose dhënia, drejtpërdrejt ose tërthorazi, i çfarëdo përfitimi të parregullt, personit që ushtron funksionin publik, për vete ose për persona të tjerë për të kryer ose mos kryer një veprim, që lidhet me detyrën ose funksionin e tij, dënohen me burgim nga gjashtë muaj deri në tre vjet.

Neni 244/a

**Korrupsioni aktiv i nëpunësve të huaj publikë**

*(Shtuar me ligjin nr.23/2012, datë 1.3.2012, neni 29)*

*(Shfuqizuar me ligjin nr.144/2013, datë 2.5.2013, neni 48)*

Premtimi, propozimi ose dhënia, drejtpërdrejt a tërthorazi, i çdo lloj përfitimi të parregullt, për vete ose për persona të tjerë, nëpunësit të huaj publik, nëpunësit të një organizate publike ndërkombëtare, anëtarit të një asambleje të huaj publike apo anëtarit të një asambleje ndërkombëtare parlamentare, për të kryer ose për të mos kryer një veprim, që lidhet me detyrën a funksionin e tij, dënohen me burgim, nga gjashtë muaj gjer në tre vjet.

Neni 245

### **Korrupsioni aktiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose të zgjedhurve vendorë**

*(Ndryshuar me ligjin nr.9275, datë 16.9.2004, neni 19)*

*(Shfuqizuar me ligjin nr.144/2013, datë 2.5.2013, neni 48)*

Premtimi, propozimi ose dhënia, drejtpërdrejt ose tërthorazi, i çfarëdo përfitimi të parregullt, funksionarëve të lartë shtetërorë ose të të zgjedhurve vendorë, për vete ose për persona të tjerë për të kryer ose mos kryer një veprim, që lidhet me detyrën a funksionin e tij, dënohen me burgim nga një deri në pesë vjet.

Neni 245/1

### **Ushtrimi i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike**

*(Shtuar me ligjin nr.9275, datë 16.9.2004, neni 20;*

*ndryshuar me ligjin nr.23/2012, datë 1.3.2012, neni 30)*

*(Shfuqizuar me ligjin nr.144/2013, datë 2.5.2013, neni 48)*

Premtimi, propozimi ose dhënia, drejtpërdrejt ose tërthorazi, i çfarëdo përfitimi të parregullt, për vete ose për persona të tjerë, personit që premtim ose siguron se është në gjendje të ushtrojë ndikim të paligjshëm në kryerjen e detyrës dhe marrjen e vendimeve nga personat që ushtrojnë funksione publike, shqiptarë ose të huaj, pavarësisht nëse është realizuar ushtrimi i ndikimit ose kanë ardhur apo jo pasojat e dëshiruara, dënohen me burgim nga gjashtë muaj deri në tre vjet.

Kërkimi, marrja ose pranimi, drejtpërdrejt ose tërthorazi, i çfarëdo përfitimi të parregullt, për veten e tij ose për persona të tjerë, duke premtuar ose siguruar aftësinë për të ushtruar ndikim të paligjshëm në kryerjen e detyrës nga persona që ushtrojnë funksione publike, shqiptarë ose të huaj, pavarësisht nëse është kryer ushtrimi i ndikimit ose kanë ardhur apo jo pasojat e dëshiruara, dënohen me burgim nga gjashtë muaj deri në katër vjet.

Neni 245/2

### **Përfshirimi nga vuajtja e dënimit**

*(Shtuar me ligjin nr.9275, datë 16.9.2004, neni 20)*

*(Shfuqizuar me ligjin 144/2013, datë 2.5.2013, neni 48)*

Neni 246

### **Përvetësimi i titullit apo i detyrës shtetërore**

Përvetësimi i një titulli apo detyre shtetërore i shoqëruar me kryerjen e veprimeve që i takojnë mbajtësit të titullit apo të detyrës, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në dy vjet.

Kur vepra kryhet me qëllim fitimi apo ka prekur lirinë, dinjitetin apo të drejta të tjera themelore të shtetasit, dënohet me gjobë ose me burgim gjer në pesë vjet.

Neni 246/a

### **Ushtrimi i profesionit të ekspertit kontabël dhe i shoqërisë audituese pa qenë i regjistruar**

*(Shtuar me ligjin nr.23/2012, datë 1.3.2012, neni 31)*



Përvetësimi i titullit profesional të ekspertit kontabël, ushtrimi i profesionit të ekspertit kontabël apo përdorimi i emërtimeve, si shoqëri audituese, pa qenë regjistruar më parë në regjistrin publik të ekspertëve kontabël, si dhe përdorimi i çfarëdo titulli, që synon të krijojë një ngjashmëri ose një konfuzion me këta tituj profesionalë apo emërtime, kur është dhënë më parë masë administrative, përbëjnë kundërvajtje penale dhe dënohen me gjobë ose me burgim gjer në dy vjet.

Neni 247

### **Mbajtja pa të drejtë e uniformës**

Mbajtja pa të drejtë e uniformës, e një dokumenti ose e një shenje dalluese, që tregojnë cilësinë e një punonjësi që kryen një detyrë shtetërore apo një shërbim publik, shoqëruar me veprime të paligjshme, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në dy vjet.

Kur vepra kryhet me qëllim fitimi ose ka prekur lirinë, dinjitetin apo të drejta të tjera themelore të shtetasit, dënohet me gjobë ose me burgim gjer në pesë vjet.

## **SEKSIONI II**

### **VEPRA PENALE KUNDËR VEPRIMTARISË SHTETËRORE TË KRYERA NGA PUNONJËSIT SHTETËRORE OSE NË SHËRBIM PUBLIK**

Neni 248

#### **Shpërdorimi i detyrës**

*(Ndryshuar me ligjin nr.9275, datë 16.9.2004, neni 21;*

*ndryshuar me ligjin nr.9686, datë 26.2.2007, neni 21)*

*(Shfuqizuar me ligjin nr.144/2013, datë 2.5.2013, neni 48)*

Kryerja ose moskryerja me dashje e veprimeve a e mosveprimeve në kundërshtim me ligjin, që përbën mospërbushje të rregullt të detyrës, nga personi që ushtron funksione publike, kur i kanë sjellë atij ose personave të tjerë përfitime materiale ose jomateriale të padrejta a kanë dëmtuar interesat e ligjshëm të shtetit, të shtetasve dhe të personave të tjerë juridikë, nëse nuk përbën vepër tjetër penale, dënohet me burgim deri në shtatë vjet.

Neni 248/a

#### **Dhënia në kundërshtim me ligjin e pensioneve ose e të ardhurave të tjera nga sigurimet shoqërore**

*(Shtuar me ligjin nr.23/2012, datë 1.3.2012, neni 32)*

*(Shfuqizuar me ligjin nr.144/2013, datë 2.5.2013, neni 48)*

Dhënia në kundërshtim me ligjin e pensioneve ose e të ardhurave të tjera nga sigurimet shoqërore prej punonjësit, që ka detyrë t'i japë ato, dënohet me burgim, nga gjashtë muaj gjer në shtatë vjet.

Neni 249

#### **Kryerja e funksionit pas dhënies fund të tij**

Vazhdimi i ushtrimit të funksionit shtetëror apo të shërbimit publik nga ana e personit që është vënë në dijeni të vendimit apo rrethanës që u ka dhënë fund ushtrimit të tyre, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në një vit.

Neni 250

### **Kryerja e veprimeve arbitrare**

Kryerja e veprimeve ose dhënia e urdhrave arbitrare, nga ana e punonjësit që kryen një funksion shtetëror ose një shërbim publik gjatë ushtrimit të detyrës së tij, të cilat prekin lirinë e shtetasve, dënohet me gjobë ose me burgim gjer në shtatë vjet.

Neni 251

### **Mosmarrja e masave për të ndërprerë gjendjen e paligjshme**

Mosmarrja e masave ose moskërkimi pranë personit kompetent, që të ndërpritet gjendja e paligjshmërisë si rezultat i një veprimi arbitrar, që ka prekur lirinë e shtetasit, nga ana e personit të ngarkuar me një funksion shtetëror ose në shërbim publik, që vjen në dijeni të asaj gjendjeje për shkak të funksionit apo shërbimit, dënohet me gjobë ose me burgim gjer në tre vjet.

Neni 252

### **Mbajtja në burg pa vendim**

Mbajtja në burg, pa vendim të organit kompetent ose tej afatit të caktuar në vendim apo në ligj, prej personit të ngarkuar me detyrën e administratorit të burgut, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në dy vjet.

Neni 253

### **Shkelja e barazisë së shtetasve**

*(Shtuar me ligjin 144/2013, datë 2.5.2013, neni 40)*

Kryerja për shkak të detyrës e në ushtrim të saj, nga ana e punonjësit me funksion shtetëror apo në shërbim publik, të dallimeve mbi bazë origjine, seksi, orientimi seksual ose identiteti gjinor, gjendjes shëndetësore, bindjeve fetare, politike, të veprimtarisë sindikale ose për shkak të përkatësisë në një etni, komb, racë apo fe të caktuar, që konsiston në krijimin e privilegjeve të padrejta ose në refuzimin e një të drejte ose përfitimi që buron nga ligji, dënohet me gjobë ose me burgim gjer në pesë vjet.

Neni 254

### **Shkelja e paprekshmërisë së banesës**

Hyrja në banesë, pa pëlqimin e personit që banon në të, prej punonjësit të ngarkuar me një funksion shtetëror apo në shërbim publik gjatë ushtrimit të detyrës së tij, veç rasteve kur lejohet nga ligji, dënohet me gjobë ose me burgim gjer në pesë vjet.

Neni 255

### **Pengimi dhe shkelja e fshehtësisë së korrespondencës**

Dhënia e urdhërave ose kryerja e veprimeve për asgjësimin, leximin dhe përhapjen e korrespondencës postare ose që prish, vështirëson, vë nën kontroll ose përgjon korrespondencën telefonike apo të çdo mjeti tjetër të komunikimit, nga ana e punonjësit të ngarkuar me funksion shtetëror ose në shërbim publik e në ushtrim të tyre, veç rasteve kur lejohet nga ligji, dënohet me gjobë ose me burgim gjer në tre vjet.

Neni 256

### **Shpërdorimi i kontributeve të dhëna nga shteti**

Shpërdorimi i kontributeve, subvencioneve ose financimeve të dhëna nga shteti ose institucione shtetërore, për t'u përdorur në vepra dhe veprimtari me interes publik, dënohet me gjobë ose me burgim gjer në tre vjet.

Neni 257

### **Përfitimi i paligjshëm i interesave**

Mbajtja, ruajtja ose marrja e drejtëpërdrejtë ose e tërthortë, nga persona me funksione shtetërore apo shërbim publik, i një interesi të çfarëdoshëm në një ndërmarrje ose operacion, në të cilat në momentin e kryerjes së veprimit ka pasur detyrën e mbikqyrjes, administrimit ose likuidimit, dënohen me gjobë ose me burgim gjer në katër vjet.

Neni 257/a

### **Refuzimi për deklarimin, mosdeklarimi, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë ose i çdo personi tjetër që ka detyrimin ligjor për deklarim**

*(Shtuar me ligjin nr.9030, datë 13.3.2003, neni 1; ndryshuar paragrafi i dytë me ligjin nr.9686, datë 26.2.2007, neni 22;*

*ndryshuar me ligjin nr.23/2012, datë 1.3.2012, neni 33)*

Refuzimi për deklarimin ose mosdeklarimi i pasurisë së personave të zgjedhur ose nëpunësve publikë ose i çdo personi tjetër që ka detyrimin ligjor për deklarim sipas ligjit, kur më parë janë marrë masa administrative, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim deri në 6 muaj.

Fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë ose i çdo personi tjetër që ka detyrimin ligjor për deklarim, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre vjet.

Neni 258

### **Shkelja e barazisë së pjesëmarrësve në tendera apo ankande publike**

*(Ndryshuar me ligjin nr.23/2012, datë 1.3.2012, neni 34)*

Kryerja nga personi i ngarkuar me funksione shtetërore apo në shërbim publik i veprimeve në kundërshtim me ligjet që rregullojnë lirinë e pjesëmarrjes dhe barazinë e shtetasve në tendera dhe ankande publike, për të krijuar avantazhe ose privilegje të padrejta për të tretët, dënohet me burgim gjer në tre vjet.

Neni 259

### **Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike**

*(Ndryshuar me ligjin nr.9275, datë 16.9.2004, neni 22)*

*(Shfuqizuar me ligjin nr.144/2013, datë 2.5.2013, neni 48)*

Kërkimi ose marrja, drejtëpërdrejt ose tërthorazi, i çdo lloj përfitimi të parregullt ose i një premtimi të tillë, për vete ose për persona të tjerë, ose pranimi i një oferte a premtimi që vjen nga përfitimi i

parregullt, nga personi që ushtron funksione publike, për të kryer ose mos kryer një veprim, që lidhet me detyrën a funksionin e tij, dënohet me burgim nga dy deri në tetë vjet.

Neni 259/a

**Korrupsioni pasiv i nëpunësve të huaj publikë**

*(Shtuar me ligjin nr.23/2012, datë 1.3.2012, neni 35)*

*(Shfuqizuar me ligjin nr.144/2013, datë 2.5.2013, neni 48)*

Kërkimi ose marrja, drejtpërdrejt a tërthorazi, i çdo lloj përfitimi të parregullt apo i një premtimi të tillë, për vete ose për persona të tjerë, ose pranimi i një oferte a premtimi që vjen nga përfitimi i parregullt, nga nëpunësi i huaj publik, nëpunësi i një organizate publike ndërkombëtare, anëtari i një asambleje të huaj publike apo anëtari i një asambleje ndërkombëtare parlamentare, për të kryer ose për të mos kryer një veprim, që lidhet me detyrën a funksionin e tij, dënohet me burgim nga dy gjer në tetë vjet.

Neni 260

**Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose i të zgjedhurve vendorë**

*(Ndryshuar me ligjin nr.9275, datë 16.9.2004, neni 23)*

*(Shfuqizuar me ligjin nr.144/2013, datë 2.5.2013, neni 48)*

Kërkimi ose marrja, drejtpërdrejt ose tërthorazi, i çdo lloj përfitimi të parregullt apo i një premtimi të tillë, për vete ose për persona të tjerë, ose pranimi i një oferte a premtimi që vjen nga përfitimi i parregullt, nga funksionari i lartë shtetëror ose i zgjedhuri vendor, për të kryer ose mos kryer një veprim që lidhet me detyrën a funksionin e tij, dënohet me burgim nga katër deri në dymbëdhjetë vjet.

**SEKSIONI III**

**VEPRA PENALE KUNDËR RENDIT DHE SIGURISË PUBLIKE**

Neni 261

**Pengimi në ushtrimin e të drejtës për t'u shprehur,  
grumbulluar apo manifestuar**

Kryerja e veprimeve për të penguar shtetasit për të ushtruar lirinë e shprehjes së mendimit, të grumbullimit apo manifestimit, përbëjnë kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në gjashtë muaj.

Kur veprimet shoqërohen me përdorimin e dhunës fizike, dënohen me gjobë ose me burgim gjer në tre vjet.

Neni 262

**Organizimi dhe pjesëmarrja në grumbullime  
e manifestime të paligjshme**

*(Shtuar paragrafi III me ligjin nr.8733, datë 24.1.2001, neni 59)*

Organizimi i grumbullimeve dhe i manifestimeve të personave në sheshe dhe vende të kalimit publik, pa marrë më parë lejen nga organi kompetent sipas dispozitave të veçanta apo kur nga organizatorët shkelen kushtet e parashtruara në kërkesën për dhënie të lejes, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në një vit.

Pjesëmarrja në një grumbullim apo manifestim të paligjshëm edhe pas paralajmërimit të bërë për shpërndarje, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në tre muaj.

Po kjo vepër, e kryer më shumë se një herë ose kur ka sjellë pasoja të rënda, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në dy vjet.

Neni 263

**Organizimi i grumbullimeve dhe manifestimeve të paligjshme  
me pjesëmarrje të personave të armatosur**

Organizimi i grumbullimeve dhe manifestimeve të paligjshme me pjesëmarrje të personave të armatosur dënohet me gjobë ose me burgim gjer në tre vjet.

Pjesëmarrja në grumbullime dhe manifestime të paligjshme e personave të armatosur përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në një vit.

Neni 264

**Detyrimi për të marrë pjesë ose jo në grevë**

Detyrimi i punonjësit që kundër vullnetit të marrë apo të mos marrë pjesë në grevë ose krijimi i pengesave dhe vështirësive për të vazhduar punën kur punonjësi dëshiron të punojë, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në tre muaj.

Neni 265

**Nxitja e urrejtjes ose grindjeve**

*(Ndryshuar neni me ligjin 144/2013, datë 2.5.2013, neni 41)*

Nxitja e urrejtjes dhe e grindjeve, për shkak të racës, etnisë, fesë ose orientimit seksual, si dhe përgatitja, përhapja ose ruajtja, me qëllim përhapjen e shkrimeve me përmbajtje të tilla, e kryer me çdo mjet ose formë, dënohet me burgim nga dy deri në dhjetë vjet.

Neni 266

**Thirrja për urrejtje nacionale**

*(Ndryshuar me ligjin 144/2013, datë 2.5.2013, neni 42)*

Vënia në rrezik e paqes publike duke bërë thirrje për urrejtje kundër pjesëve të popullsisë, duke i fyer ose shpifur për to, duke kërkuar përdorimin e dhunës ose të veprimeve arbitrare kundër tyre, dënohet me burgim nga dy deri në tetë vjet.

Neni 267

**Përhapja e informatave të rreme që ngjallin panik**

Përhapja e informatave apo njoftimeve të rreme, me fjalë, me shkrim apo me çdo mënyrë tjetër, me qëllim që të ngjallë një gjendje pasigurie dhe paniku te njerëzit, dënohet me gjobë ose me burgim gjer në pesë vjet.

Neni 268

**Poshtërimi i Republikës dhe i simboleve të saj**  
(Ndryshuar me ligjin nr.23/2012, datë 1.3.2012, neni 36)

Dëmtimi i qëllimshëm i flamurit ose i stemës së Republikës, të ekspozuara në institucionet shtetërore, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në tre muaj.

Poshtërimi botërisht i flamurit ose i himnit kombëtar, gjatë zhvillimit të një veprimtarie të organizuar nga autoritetet shtetërore, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në tre muaj.

Neni 269

**Pengimi me dhunë i veprimtarisë së partive politike**

Pengimi me dhunë i veprimtarisë së ligjshme të partive, organizatave apo shoqatave politike përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në dy vjet.

Neni 270

**Rebelimi i të burgosurve**

Përdorimi i dhunës, nga ana e të burgosurve ndaj punonjësit që kryen një detyrë shtetërore apo në shërbim publik, që bëhet për ta penguar në ushtrimin e detyrës apo të shërbimit ose për shkak të veprimtarisë, dënohet me gjobë ose me burgim gjer në pesë vjet.

Kur dhuna ushtrohet nga një grup personash ose shoqërohet me trazira e çrregullime apo me kërcënime e frikësime, dënohet me gjobë ose me burgim gjer në dhjetë vjet.

Neni 271

**Disinformimi i ekipeve të urgjencës**

Disinformimi me dashje i ekipeve të urgjencës për të prishur gatishmërinë e tyre, e bërë me çdo mjet lajmërimi e thirrjeje, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në një vit.

Neni 272

**Njoftimi i rremë në organet e rendit**

Njoftimi i rremë i bërë në organet e rendit, për kryerjen e një vepre penale, për t'i vënë ato në gjendje gatishmërie dhe alarmi, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në një vit.

Neni 273

**Largimi nga vendi i aksidentit**

Largimi nga vendi i aksidentit, i drejtuesit të automjetit apo të çdo mjeti të motorizuar, për t'u shmangur nga përgjegjësia penale, civile apo administrative, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në një vit.

Neni 274  
**Prishja e qetësisë publike**

Hedhja e gurëve apo sendeve të tjera në banesën e shtetasit, krijimi i zhurmave shqetësuese si, me anë të shkrepjes së armëve apo plasjeve të ndryshme, të përdorimit jashtë rregullave të sirenave të automjeteve, apo çdo lloj tjetër sjelljeje të papëlqyeshme, në rrugë, sheshe e vende publike, që cenojnë dukshëm qetësinë e moralin apo tregon mospërfillje të hapët për mjedisin, përbëjnë kundërvajtje penale dhe dënohen me gjobë ose me burgim gjer në dy vjet.

Neni 275  
**Përdorimi me keqdashje i thirrjeve telefonike**

Thirrjet telefonike keqdashëse që bëhen me qëllim për të prishur qetësinë e tjetrit, përbëjnë kundërvajtje penale dhe dënohen me gjobë ose me burgim gjer në një vit.

Neni 276  
**Përdorimi pa të drejtë i emblemës së Kryqit të Kuq**

Përdorimi pa të drejtë i emblemës së Kryqit të Kuq ose Gjysëm Hënës së Kuqe, kur ka sjellë pasoja të rënda materiale, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në dy vjet.

Kur nga vepra penale ka ndodhur vdekja apo dëmtimi i rëndë i shëndetit të njerëzve, dënohet me gjobë ose me burgim gjer në dhjetë vjet.

Neni 277  
**Vetëgjyqësia**

Ushtrimi i një të drejte prej personit që i përket ose që kujton se i përket dhe që nuk njihet nga tjetri pa iu drejtuar organit kompetent shtetëror, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në tre muaj.

Neni 278  
**Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe e municionit**  
*(Shtuar paragrafi I dhe II me ligjin nr.8279, datë 15.1.1998, neni 2;  
ndryshuar paragrafi I, II dhe III, si dhe shtuar paragrafi IV me ligjin nr.8733, datë 24.1.2001, neni 60)  
(Ndryshuar neni me ligjin 144/2013, datë 2.5.2013, neni 43)*

Prodhimi i armëve dhe i municioneve luftarake, lëndëve plasëse, i bombave apo minave, pa lejen e organeve kompetente shtetërore, dënohet me burgim nga pesë deri në pesëmbëdhjetë vjet.

Mbajtja e municioneve luftarake, pa lejen e organeve kompetente shtetërore, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim deri në dy vjet.

Mbajtja e armëve, i bombave apo minave ose lëndëve plasëse në banesë, pa lejen e organeve kompetente shtetërore, dënohet me burgim nga një deri në pesë vjet.

Mbajtja e armëve, i bombave apo minave, ose lëndëve plasëse në automjete apo në çdo mjet tjetër të motorizuar, në mjedise publike ose në mjedise të hapura për publikun, pa lejen e organeve kompetente shtetërore, dënohet me burgim nga shtatë deri në pesëmbëdhjetë vjet.

Kur vepra penale kryhet në sasi të mëdha, në bashkëpunim, më shumë se një herë, ose ka sjellë pasoja të rënda, dënohet me burgim nga dhjetë deri në njëzet vjet.

Neni 278/a

**Trafikimi i armëve dhe i municionit**

*(Shtuar me ligjin nr.8733, datë 24.1.2001, neni 61)*

*(Shtuar me ligjin 144/2013, datë 2.5.2013, neni 44)*

Importimi, eksportimi, tranzitimi dhe tregtimi, në kundërshtim me ligjin, i armëve dhe municionit luftarak ose i pjesëve përbërëse të tyre me qëllim fitimi material ose çdo përfitim tjetër, dënohet me burgim nga shtatë gjer në pesëmbëdhjetë vjet.

Po kjo vepër, kur kryhet në bashkëpunim ose më shumë se një herë ose sjell pasoja të rënda, dënohet me burgim nga dhjetë gjer në njëzet vjet.

Neni 279

**Prodhimi, mbajtja, blerja apo shitja pa leje e armëve të ftohta**

*(Ndryshuar neni me ligjin 144/2013, datë 2.5.2013, neni 45)*

Prodhimi, mbajtja, blerja apo shitja, e armëve të ftohta si shpatat, bajonetat, thikat dhe mjete të tjera të përgatitura e të destinuara posaçërisht për sulm kundër personave ose për vetëmbrojtje, pa lejen e organeve kompetente, dënohen me gjobë ose me burgim deri në tre vjet.

Mbajtja, blerja apo shitja në automjete apo në çdo mjet tjetër të motorizuar, në mjedise publike ose në mjedise të hapura për publikun, e armëve të ftohta si shpatat, bajonetat, thikat dhe mjete të tjera të përgatitura e të destinuara posaçërisht për sulm kundër personave ose për vetëmbrojtje, pa lejen e organeve kompetente, dënohen me burgim nga tre deri në tetë vjet.

Neni 280

**Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve të gjuetisë dhe sportive**

Prodhimi, mbajtja, shitja ose blerja e armëve të gjuetisë ose sportive, si dhe e municioneve të tyre, pa leje të organeve kompetente shtetërore, përbëjnë kundërvajtje penale dhe dënohen me gjobë ose me burgim gjer në dy vjet.

Neni 281

**Shkelja e rregullave mbi lëndët helmuese**

Shkelja e rregullave të caktuara për mbajtjen, prodhimin, përdorimin, ruajtjen, transportimin dhe shitjen e lëndëve helmuese me efekt të fortë, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në dy vjet.

Kur nga vepra penale ka ndodhur vdekja apo dëmtimi i rëndë i shëndetit të njerëzve ose kanë ardhur pasoja të rënda materiale, dënohet me gjobë ose me burgim gjer në dhjetë vjet.



Neni 282

**Shkelja e rregullave mbi lëndët plasëse, djegëse dhe radioaktive**

Shkelja e rregullave të caktuara për mbajtjen, prodhimin, përdorimin, ruajtjen, transportimin dhe shitjen e lëndëve plasëse, djegëse apo radioaktive, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në dy vjet.

Kur nga vepra penale ka ndodhur vdekja apo dëmtimi i rëndë i shëndetit të njerëzve ose kanë ardhur pasoja të rënda materiale, dënohet me gjobë ose me burgim gjer në dhjetë vjet.

Neni 282/a

**Trafikimi i lëndëve plasëse, djegëse, helmuese dhe radioaktive**

*(Shtuar me ligjin nr.8733, datë 24.1.2001, neni 62)*

Importimi, eksportimi, tranzitimi dhe tregtimi, në kundërshtim me ligjin i lëndëve plasëse, djegëse, helmuese dhe radioaktive, me qëllim fitimi material ose çdo përfitim tjetër, dënohet me burgim nga shtatë gjer në pesëmbëdhjetë vjet.

Po kjo veprë, kur kryhet në bashkëpunim ose më shumë se një herë ose sjell pasoja të rënda, dënohet me burgim nga dhjetë gjer në njëzet vjet.

Neni 282/b

**Stërvitja për prodhimin dhe përdorimin e paligjshëm të armëve e lëndëve të tjera të rrezikshme**

*(Shtuar me ligjin nr.9686, datë 26.2.2007, neni 23)*

Përgatitja, stërvitja dhe dhënia e udhëzimeve, në çdo formë, edhe në mënyrë anonime apo në rrugë elektronike, në kundërshtim me ligjin, për prodhimin ose përdorimin e lëndëve eksplozive, të armëve të zjarrit dhe municioneve luftarake, të armëve të tjera dhe lëndëve kimike, bakteriologjike, bërthamore apo të çdo natyre tjetër, të dëmshme dhe të rrezikshme për njerëzit dhe pasurinë, nëse nuk përbën veprë tjetër penale, dënohen me burgim nga dy deri në shtatë vjet.

Neni 283

**Prodhimi dhe shitja e narkotikëve**

*(Ndryshuar paragrafi I, shtuar paragrafi II me ligjin nr.8733, datë 24.1.2001, neni 63)*

Shitja, ofrimi për shitje, dhënia ose marrja në çdo formë, shpërndarja, tregtimi, transportimi, dërgimi, dorëzimi, si dhe mbajtja, përveç rastit të përdorimit vetjak dhe në doza të vogla, të substancave narkotike dhe psikotrope, si edhe i farërave të bimëve narkotike, në kundërshtim me ligjin ose në kapërcim të përmbajtjes së tyre, dënohet me burgim nga pesë gjer në dhjetë vjet.

Po kjo veprë, kur kryhet në bashkëpunim ose më shumë se një herë, dënohet me burgim nga shtatë gjer në pesëmbëdhjetë vjet.

Organizimi, drejtimi apo financimi i kësaj veprimtarie, dënohen me burgim nga dhjetë gjer në njëzet vjet.

Neni 283/a

**Trafikimi i narkotikëve**

*(Shtuar me ligjin nr.8279, 15.1.1998, neni 2;  
ndryshuar me ligjin nr.8733, datë 24.1.2001, neni 64)*

Importimi, eksportimi, tranzitimi dhe tregtimi, në kundërshtim me ligjin, i substancave narkotike ose psikotrope, si edhe i farërave të bimëve narkotike, dënohet me burgim nga shtatë gjer në pesëmbëdhjetë vjet.

Po kjo vepër, kur kryhet në bashkëpunim ose më shumë se një herë, dënohet me burgim nga dhjetë gjer në njëzet vjet.

Organizimi, drejtimi ose financimi i kësaj veprimtarie dënohen me burgim jo më pak se pesëmbëdhjetë vjet.

Neni 283/b

**Krijimi i lehtësirave për marrjen dhe përdorimin e drogës**

*(Shtuar me ligjin nr.8733, datë 24.1.2001, neni 65)*

Krijimi nga ana e personave, që për shkak të detyrës administrojnë substanca narkotike ose psikotrope, i lehtësirave për marrjen dhe përdorimin e këtyre substancave, në kundërshtim me dispozitat ligjore përkatëse, dënohet nga tre gjer në shtatë vjet.

Neni 284

**Kultivimi i bimëve narkotike**

*(Ndryshuar paragrafi I dhe III, shtuar paragrafi II me ligjin nr.8733,  
datë 24.1.2001, neni 66)*

Kultivimi i bimëve, që shërbejnë ose dihet se shërbejnë për prodhimin dhe nxjerrjen e lëndëve narkotike dhe psikotrope, pa leje dhe autorizim sipas ligjit, dënohet me burgim nga tre gjer në shtatë vjet.

Po kjo vepër, kur kryhet në bashkëpunim ose më shumë se një herë, dënohet me burgim nga pesë gjer në dhjetë vjet.

Organizimi, drejtimi apo financimi i kësaj veprimtarie, dënohen me burgim nga shtatë gjer në pesëmbëdhjetë vjet.

Neni 284/a

**Organizimi dhe drejtimi i organizatave kriminale**

*(Shtuar me ligjin nr.8279, datë 15.1.1998, neni 2)*

Organizimi, drejtimi dhe financimi i organizatave kriminale me qëllim kultivimin, prodhimin, fabrikimin ose trafikun e paligjshëm të narkotikëve dënohet me burgim nga 10 deri në 20 vjet.

Krijimi i kushteve apo lehtësirave për veprimtari të tilla nga persona me funksione shtetërore, dënohet me burgim nga 5 deri në 15 vjet.

Neni 284/b

### **Ndihma në zbulimin e krimeve**

*(Shtuar me ligjin nr.8279 datë 15.1.1998, neni 2)  
(Shfuqizuar me ligjin 144/2013, datë 2.5.2013, neni 48)*

Neni 284/c

#### **Prodhimi dhe fabrikimi i lëndëve narkotike dhe psikotrope**

*(Shtuar me ligjin nr.8733, datë 24.1.2001, neni 67)*

Prodhimi, fabrikimi, nxjerrja, rafinimi, përgatitja pa licencë ose në kapërcim të përmbajtjes së tij i lëndëve narkotike dhe psikotrope, dënohet me burgim nga pesë gjer në dhjetë vjet.

Po kjo veper, kur kryhet në bashkëpunim ose më shumë se një herë, dënohet me burgim nga shtatë gjer në pesëmbëdhjetë vjet.

Organizimi, drejtimi ose financimi i kësaj veprimtarie dënohen me burgim nga dhjetë gjer në njëzet vjet.

Neni 284/ç

#### **Prodhimi, tregtimi dhe përdorimi i paligjshëm i prekursorëve**

*(Shtuar me ligjin nr.8733, datë 24.1.2001, neni 67)*

Prodhimi, importimi, eksportimi, tranzitimi, tregtimi dhe mbajtja, në kundërshtim me dispozitat përkatëse ligjore, i prekursorëve të treguar me ligj në tabelat përkatëse, dënohet me burgim gjer në pesë vjet.

Po kjo veper, kur kryhet në bashkëpunim ose më shumë se njëherë, dënohet me burgim nga tre gjer në shtatë vjet.

Organizimi, drejtimi ose financimi i kësaj veprimtarie dënohen me burgim nga pesë gjer në pesëmbëdhjetë vjet.

Neni 285

#### **Mbajtja, prodhimi dhe transportimi i substancave kimike**

*(Ndryshuar me ligjin nr.8733, datë 24.1.2001, neni 68)*

Prodhimi, mbajtja, transportimi ose shpërndarja e substancave kimike bazë ose e substancave të tjera të çfarëdollojshme, e pajisjeve, e materialeve, në rast se dihet që ato përdoren ose do të përdoren për prodhimin ose trafikimin e paligjshëm të substancave narkotike a psikotrope, dënohet me burgim nga tre gjer në dhjetë vjet.

Neni 285/a

#### **Përshtatja e lokalit për përdorim droge**

*(Shtuar me ligjin nr.8733, datë 24.1.2001, neni 69)*

Përshtatja ose lejimi për përshtatjen e lokalit, banesës, mjeteve motorike dhe të çdo mjeti tjetër publik ose privat për grumbullimin e personave me qëllim që ata të konsumojnë substanca narkotike ose psikotrope, dënohet me burgim gjer në pesë vjet.

Neni 285/b

### **Hedhja ose braktisja e shiringave**

*(Shtuar me ligjin nr.8733, datë 24.1.2001, neni 69)*

Hedhja ose braktisja e shiringave, në vende publike ose të hapura për publikun, si dhe në mjedise private të përdorimit të përbashkët të shiringave ose instrumenteve të rrezikshëm, të përdorura për marrjen e substancave narkotike ose psikotrope, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në një vit.

Neni 286

### **Nxitja për përdorimin e drogës**

*(Ndryshuar me ligjin nr.8733, datë 24.1.2001, neni 70)*

Nxitja e të tjerëve për përdorimin e lëndëve narkotike dhe psikotrope ose dhënia në përdorim ose injektimi i tyre te të tjerët, pa dijeninë dhe pëlqimin e tyre, dënohet me burgim nga pesë gjer në dhjetë vjet.

Kur nxitja apo injektimi i detyruar bëhet ndaj fëmijëve apo në institucione penale, shkollore, sportive apo të çdo veprimtarie tjetër shoqërore dënohet me burgim jo më pak se pesëmbëdhjetë vjet.

Neni 286/a

### **Përdorimi i paligjshëm i teknologjise së lartë**

*(Shtuar me ligjin nr.8733, datë 24.1.2001, neni 71)*

Prodhimi dhe përdorimi i sistemeve telematike, mjeteve dhe pajisjeve të teknologjisë së lartë, në rastet e veprave penale të parashikuara në nenet 283 gjer në 286/a të këtij Kodi ose për të mundësuar ose lehtësuar konsumimin e lëndëve narkotike dhe psikotrope ose për të transmetuar a përhapur njoftime publicitare për stimulimin e përdorimit të tyre, dënohet me burgim gjer në pesë vjet.

Neni 287

### **Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale**

*(Ndryshuar me ligjin nr.9086, datë 19.6.2003, neni 8; shtuar shkronja "dh" me ligjin nr.9275, datë 16.9.2004, neni*

*24; ndryshuar shkronja "a" e pikës 1, shfuqizuar shkronja "ç" me ligjin nr.9686, datë 26.2.2007, neni 24;*

*ndryshuar me ligjin nr.23/2012, datë 1.3.2012, neni 37)*

*(Shfuqizuar me ligjin nr.144/2013, datë 2.5.2013, neni 48)*

Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale, nëpërmjet:

a) këmbimit ose transferimit të pasurisë, me qëllim fshehjen ose mbulimin e origjinës së paligjshme të saj, duke ditur se kjo pasuri është produkt i veprës penale ose i veprimtarisë kriminale;

b) fshehjes ose mbulimit të natyrës së vërtetë, burimit, vendndodhjes, disponimit, zhvendosjes, pronësisë ose të drejtave në lidhje me pasurinë, duke ditur që kjo pasuri është produkt i veprës penale ose i veprimtarisë kriminale;

c) fitimit të pronësisë, posedimit ose përdorimit të pasurisë, duke e ditur në çastin e marrjes në dorëzim të saj, që kjo pasuri është produkt i veprës penale ose i veprimtarisë kriminale;

ç) kryerjes së veprimeve financiare ose transaksioneve të copëzuara për shmangien nga raportimi, sipas legjislacionit për parandalimin e pastrimit të parave;

d) investimit në veprimtari ekonomike ose financiare të parave a sendeve, duke ditur se janë produkte të veprës penale ose veprimtarisë kriminale;

dh) këshillimit, ndihmës, nxitjes ose thirrjes publike për kryerjen e secilës prej veprave të përcaktuara më sipër;

dënohet me burgim nga pesë gjer në dhjetë.

Kur kjo vepër kryhet gjatë ushtrimit të një veprimtarie profesionale, në bashkëpunim ose më shumë se një herë, dënohet me burgim nga shtatë gjer në pesëmbëdhjetë vjet.

E njëjta vepër, kur ka sjellë pasoja të rënda, dënohet jo më pak se pesëmbëdhjetë vjet me burgim.

Dispozitat e këtij neni zbatohen edhe kur:

a) vepra penale, produktet e së cilës pastrohen, është kryer nga një person që nuk mund të merret si i pandehur ose që nuk mund të dënohet;

b) ndjekja penale për veprën, produktet e së cilës pastrohen, është parashkruar ose amnistuar;

c) personi që kryen pastrimin e produkteve është i njëjtë me personin që ka kryer veprën, nga e cila kanë rrjedhur produktet;

ç) për veprën penale, nga e cila kanë ardhur produktet, nuk është filluar asnjëherë çështja penale apo nuk është dhënë një dënim me vendim penal të formës së prerë;

d) vepra penale, produktet e së cilës pastrohen, është kryer nga një person, pavarësisht shtetësisë së tij, jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë dhe është njëkohësisht e dënueshme, si në shtetin e huaj, ashtu edhe në Republikën e Shqipërisë.

Dijenia dhe qëllimi, sipas paragrafit të parë të këtij neni, nxirren nga rrethana fakti objektive.

Neni 287/a

### **Çelja e llogarive anonime**

*(Ndryshuar me ligjin nr.9086, datë 19.6.2003, neni 9)*

*(Shfuqizuar me ligjin nr.144/2013, datë 2.5.2013, neni 48)*

Çelja e depozitave ose e llogarive bankare, anonime ose me emra fiktivë, dënohet me burgim deri në tre vjet.

Neni 287/b

### **Përvetësimi i parave ose mallrave që rrjedhin nga vepra penale ose veprimtaria kriminale**

*(Shtuar me ligjin nr.9686, datë 26.2.2007, neni 25;*

*ndryshuar me ligjin nr.23/2012, datë 1.3.2012, neni 38)*

*(Shfuqizuar me ligjin nr.144/2013, datë 2.5.2013, neni 48)*

Kushdo që blen, merr, fsheh apo, në një mënyrë tjetër, përvetëson për vete ose një palë të tretë, apo ndihmon në blerjen, marrjen, fshehjen ose përdorimin e parave apo mallrave të tjera, duke ditur se një person tjetër ka përfituar këto para apo mallra, si pasojë e kryerjes së një vepre penale ose veprimtarie kriminale, dënohet me burgim nga gjashtë muaj gjer në tre vjet.

Paragrafi i parë i këtij neni zbatohet pavarësisht ndalimit ligjor për të marrë në përgjegjësi penale personin që ka kryer veprën penale, nga e cila rrjedh përvetësimi i parave ose i mallrave të tjera.

Neni 288

### **Prodhimi dhe shitja e ushqimeve dhe e lëndëve të tjera të rrezikshme për shëndetin**

Prodhimi, importimi, ruajtja dhe shitja e ushqimeve, pijeve dhe lëndëve të tjera, e barnave të rrezikshme ose të dëmshme për jetën e shëndetin, si dhe futja në prodhim e kimikateve, materialeve dhe lëndëve shtesë në prodhimin e përpunimin e artikujve ushqimorë e të pijeve, kur nga këto vepra ka ardhur vdekja ose dëmtimi i rëndë i shëndetit të personit, dënohen me gjobë ose me burgim gjer në dhjetë vjet.

Kur nga vepra është shkaktuar vdekja ose dëmtimi i rëndë i shëndetit të disa personave, dënohet me burgim jo më pak se pesë vjet.

Neni 288/a

**Prodhimi i kundërligjshëm i artikujve dhe mallrave  
industrialë dhe ushqimorë**

*(Shtuar me ligjin nr.8733, datë 24.1.2001, neni 73)*

Prodhimi i kundërligjshëm i artikujve dhe mallrave industrialë dhe ushqimorë përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në dy vjet.

Po kjo veprë, kur kryhet në bashkëpunim, më shumë se një herë ose ka sjellë pasojë të rënda, dënohet me burgim nga tre gjer në dhjetë vjet.

Neni 289

**Shkelja e rregullave të mbrojtjes në punë**

Shkaktimi i vdekjes ose dëmtimi i rëndë i shëndetit të personit ardhur si pasojë e mosrespektimit të rregullave që kanë të bëjnë me punën, prodhimin, shërbimin, të përcaktuara në ligj, në aktet e Këshillit të Ministrave apo në rregulloret përkatëse të sigurimit teknik, të disiplinës teknike, të mbrojtjes në punë, të higjienës dhe sigurimit nga zjarri prej personave të ngarkuar me respektimin e rregullave dhe marrjen e masave në zbatim të tyre, dënohet me gjobë ose me burgim gjer në dhjetë vjet.

Kur nga vepra penale është shkaktuar vdekja ose dëmtimi i rëndë i shëndetit të disa personave, dënohet me burgim jo më pak se pesë vjet.

Neni 290

**Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor**

*(Ndryshuar neni me ligjin 144/2013, datë 2.5.2013, neni 46)*

Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor, kur ka shkaktuar plagosjen e lehtë të disa personave, dënohet me gjobë ose me burgim deri në një vit.

Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor, kur ka shkaktuar plagosjen e rëndë të një personi, dënohet me burgim nga një deri në pesë vjet.

Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor, kur ka shkaktuar vdekjen e një personi, dënohet me burgim nga dy deri në dhjetë vjet.

Kur nga vepra penale është shkaktuar vdekja ose plagosja e rëndë e disa personave, dënohet me burgim nga pesë deri në njëzet vjet.

Neni 291

**Drejtimi i automjeteve në mënyrë të parregullt**

*(Ndryshuar neni me ligjin 144/2013, datë 2.5.2013, neni 47)*

Drejtimi i automjeteve apo mjeteve të tjera të motorizuara në gjendje të dehur, nën efektin e lëndëve narkotike, apo pa dëshminë përkatëse të aftësisë, dënohet me burgim deri në tre vjet.

Neni 292

### **Shkelja e disiplinës së punës në transport**

Shkelja e disiplinës së punës në transportin hekurudhor, ujqor ose ajror prej punonjësve të këtij transporti, që ka shkaktuar vdekjen ose dëmtimin e rëndë të shëndetit të personit, dënohet me gjobë ose me burgim gjer në dhjetë vjet.

Kur nga vepra penale është shkaktuar vdekja ose dëmtimi i rëndë i shëndetit të disa personave, dënohet me burgim jo më pak se pesë vjet.

Neni 293

### **Pengimi i qarkullimit të mjeteve të transportit**

Vënia e pengesave dhe ndalimi me çdo mjet e mënyrë i qarkullimit të mjeteve të transportit automobilistik, hekurudhor, ujqor e ajror, dënohet me gjobë ose me burgim gjer në tre vjet.

Neni 293/a

### **Përgjimi i paligjshëm i të dhënave kompjuterike**

*(Shtuar me ligjin nr.10 023, datë 27.11.2008, neni 23)*

Përgjimi i paligjshëm me mjete teknike i transmetimeve jopublike, i të dhënave kompjuterike nga/ose brenda një sistemi kompjuterik, përfshirë emetimet elektromagnetike nga një sistem kompjuterik, që mbart të dhëna të tilla kompjuterike, dënohet me burgim nga tre deri në shtatë vjet.

Kur kjo vepër kryhet nga/ose brenda sistemeve kompjuterike ushtarake, të sigurisë kombëtare, të rendit publik, të mbrojtjes civile apo në çdo sistem tjetër kompjuterik, me rëndësi publike, dënohet me burgim nga shtatë deri në pesëmbëdhjetë vjet.

Neni 293/b

### **Ndërhyrja në të dhënat kompjuterike**

*(Shtuar me ligjin nr.10 023, datë 27.11.2008, neni 23)*

Dëmtimi, shtrembërimi, ndryshimi, fshirja apo suprimimi i paautorizuar i të dhënave kompjuterike dënohen me burgim nga gjashtë muaj deri në tre vjet.

Kur kjo vepër kryhet në të dhënat kompjuterike ushtarake, të sigurisë kombëtare, të rendit publik, të mbrojtjes civile, të shëndetësisë apo në çdo të dhënë tjetër kompjuterike, me rëndësi publike, dënohet me burgim nga tre deri në dhjetë vjet.

Neni 293/c

### **Ndërhyrja në sistemet kompjuterike**

*(Shtuar me ligjin nr.10 023, datë 27.11.2008, neni 23)*

Krijimi i pengesave serioze dhe të paautorizuara për të cenuar funksionimin e një sistemi kompjuterik, nëpërmjet futjes, dëmtimit, shtrembërimit, ndryshimit, fshirjes apo suprimimit të të dhënave, dënohet me burgim nga tre deri në shtatë vjet.

Kur kjo vepër kryhet në sistemet kompjuterike ushtarake, të sigurisë kombëtare, të rendit publik, të mbrojtjes civile, të shëndetësisë apo në çdo sistem tjetër kompjuterik, me rëndësi publike, dënohet me burgim nga pesë deri në pesëmbëdhjetë vjet.

Neni 293/ç

### **Keqpërdorimi i pajisjeve**

*(Shtuar me ligjin nr.10 023, datë 27.11.2008, neni 23)*

Prodhimi, mbajtja, shitja, dhënia në përdorim, shpërndarja apo çdo veprim tjetër, për vënien në dispozicion të një pajisjeje, ku përfshihen edhe një program kompjuterik, një fjalëkalim kompjuterik, një kod hyrjeje apo një e dhënë e tillë e ngjashme, të cilat janë krijuar ose përshtatur për hyrjen në një sistem kompjuterik ose në një pjesë të tij, me qëllim kryerjen e veprave penale, të parashikuara në nenet 192/b, 293/a, 293/b e 293/c të këtij Kodi, dënohen me burgim nga gjashtë muaj deri në pesë vjet.

## SEKSIONI IV

### VEPRA PENALE KUNDËR SEKRETIT DHE KUFIJVE SHTETËRORË

Neni 294

#### **Tregtimi i sekretit shtetëror nga personi që i është besuar**

Tregtimi, përhapja dhe informimi i fakteve, shifrave, përmbajtjes së dokumenteve apo materialeve që, sipas ligjit të njohur publikisht, përbëjnë sekret shtetëror, nga personi që i është besuar ose që ka mundur të vijë në dijeni për to për shkak të detyrës, dënohen me gjobë ose me burgim gjer në pesë vjet.

Po kjo vepër, e bërë botërisht, dënohet me gjobë ose me burgim gjer në dhjetë vjet.

Neni 295

#### **Tregtimi i sekretit shtetëror nga shtetasit**

Tregtimi, përhapja dhe informimi i fakteve, shifrave, përmbajtjes së dokumenteve apo materialeve që, sipas ligjit të njohur publikisht, përbëjnë sekret shtetëror, nga cilido që ka mundur të vijë në dijeni për to, dënohen me gjobë ose me burgim gjer në tre vjet.

Po kjo vepër, e bërë botërisht, dënohet me gjobë ose me burgim gjer në pesë vjet.

Neni 295/a

#### **Zbulimi i akteve ose të dhënave sekrete**

*(Shtuar me ligjin nr.9686, datë 26.2.2007, neni 26;  
ndryshuar me ligjin nr.23/2012, datë 1.3.2012, neni 56)*

Zbulimi ndaj të tretëve i të dhënave ose ndihma për të zbuluar të dhënat, të cilat ligji i përcakton si sekret, nga ana e një funksionari publik ose e një personi të ngarkuar me një shërbim publik, në kundërshtim me përmbushjen e rregullt të detyrës ose duke abuzuar me cilësitë e veta, dënohet me gjobë ose me burgim deri në pesë vjet.

Zbulimi ndaj të tretëve i të dhënave, të cilat përbëjnë sekret tregtar industrial ose profesional, nga ana e personave publikë, që kanë detyrë ruajtjen e tyre, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre vjet.



Zbulimi i akteve sekrete ose i të dhënave, që përmbajnë aktet sekrete, nga prokurori ose oficeri i policisë gjyqësore, si dhe mosrespektimi i detyrimeve të përcaktuara në nenin 103 të Kodit të Procedurës Penale, dënohet me burgim nga një deri në pesë vjet.

Zbulimi i akteve sekrete ose i të dhënave të përmbajtura në aktet sekrete nga persona të tjerë, që kanë dijeni për të dhëna për procedimin penal e që janë paralajmëruar nga prokurori ose oficeri i policisë gjyqësore për moszbulimin e tyre, dënohet me burgim deri në tre vjet.

Zbulimi i të dhënave sekrete, që kanë lidhje me identitetin, procesin e bashkëpunimit, të mbrojtjes ose për vendndodhjen e dëshmitarëve e të bashkëpunëtorëve të drejtësisë, të cilët përfitojnë mbrojtje të veçantë, sipas ligjeve në fuqi, dënohet me burgim nga dy deri në gjashtë vjet.

Zbulimi i sekretit që ka sjellë si pasojë vdekjen, plagosjen e rëndë ose ka rrezikuar seriozisht jetën apo shëndetin e dëshmitarëve ose të bashkëpunëtorëve të drejtësisë, të familjarëve të tyre apo të punonjësve të policisë, të ngarkuar me mbrojtjen e tyre, dënohet me burgim nga tre deri në tetë vjet.

Neni 295/b

### **Shfrytëzimi i paligjshëm i të dhënave tregtare**

*(Shtuar me me ligjin nr.23/2012, datë 1.3.2012, neni 39)*

Tregtimi i një malli apo ofrimi i një shërbimi nëpërmjet përdorimit të informacionit ose të dhënave që përbëjnë sekret tregtar ose informacion të privilegjuar nga persona që e kanë ose duhet ta kenë këtë informacion apo të dhënë, dënohet me gjobë ose me burgim gjer në katër vjet.

Neni 296

### **Humbja e dokumenteve sekrete**

Humbja e dokumenteve apo materialeve të tjera që, sipas ligjit të njohur publikisht, përbëjnë sekret shtetëror, nga personi që i janë besuar për ruajtje apo për përdorim, dënohet me gjobë ose me burgim gjer në tre vjet.

Neni 297

### **Kalimi i paligjshëm i kufirit shtetëror**

*(Shtuar me ligjin nr.8279, datë 15.1.1998, neni 2;  
ndryshuar me ligjin nr.9188, datë 12.2.2004, neni 8)*

Kalimi i paligjshëm i kufijve shtetërorë përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në dy vjet.

Neni 298

### **Ndihma për kalim të paligjshëm të kufijve**

*(Ndryshuar me ligjin nr.9188, datë 12.2.2004, neni 9; ndryshuar titulli dhe paragrafi i parë me ligjin nr.9686, datë 26.2.2007, neni 27;*

*ndryshuar me ligjin nr.23/2012, datë 1.3.2012, neni 56)*

*(Shfuqizuar me ligjin nr.144/2013, datë 2.5.2013, neni 48)*

Strehimi, shoqërimi, vënia në dispozicion ose përdorimi i mjeteve të lundrimit, të fluturimit ose i mjeteve të tjera të transportit apo çdo ndihmë tjetër, me qëllim kalimin e paligjshëm të kufirit të Republikës së Shqipërisë ose për hyrjen e paligjshme të një personi në një shtet tjetër, pa qenë shtetas i tij ose që nuk ka leje qëndrimi në atë shtet, dënohet me burgim nga një deri në katër vjet.

Kur ndihma jepet për qëllime fitimi, dënohet me burgim nga tre deri në shtatë vjet.

Kur kjo veprë kryhet në bashkëpunim ose më shumë se një herë, apo ka sjellë pasoja të rënda, dënohet me burgim nga pesë deri në dhjetë vjet.

Kur vepra ka sjellë si pasojë vdekjen e të dëmtuarit, dënohet me burgim jo më pak se pesëmbëdhjetë vjet ose me burgim të përjetshëm.

Kur vepra penale kryhet nëpërmjet shfrytëzimit të funksionit shtetëror ose shërbimit publik, dënimi me burgim shtohet me ¼ e dënimit të dhënë.

Neni 299

### **Shkelja e rregullave mbi fluturimet**

Shkelja e rregullave mbi fluturimet ndërkombëtare si, hyrja ose dalja nga territori i Republikës së Shqipërisë pa leje fluturimi, mosrespektimi i vijave të fluturimit, i vendeve të zbritjes, i korridoreve ajrore apo lartësisë të caktuar të fluturimit, dënohet me gjobë ose me burgim gjer në pesë vjet.

KREU IX

### **VEPRA PENALE KUNDËR DREJTËSISË**

Neni 300

### **Moskallëzimi i krimit**

Moskallëzimi në organet e ndjekjes penale, në gjykatë, në organet e rendit publik, të pushtetit ose të administratës, i një krimi që është duke u kryer apo që është kryer, dënohet me gjobë ose me burgim gjer në tre vjet.

Përfshihen nga detyrimi për kallëzim të paralindurit dhe të paslindurit, vëllezërit dhe motrat, bashkëshorti, adoptuesi dhe të adoptuarit, si edhe personat që janë të detyruar të ruajnë një sekret të njohur për shkak të detyrës apo profesionit.

Neni 301

### **Veprime që pengojnë zbulimin e së vërtetës**

Kryerja e veprimeve për të ndryshuar vendin e kryerjes së veprës penale duke prishur, ndryshuar apo fshirë gjurmët e saj ose duke lëvizur, fshehur, asgjësuar, vjedhur, falsifikuar një send apo një dokument me qëllim për të vështirësuar dhe penguar zbulimin e veprës penale dhe të autorit të saj, dënohet me gjobë ose me burgim gjer në tre vjet.

Neni 302

### **Përkrahja e autorit të krimit**

*(Shtuar paragrafi II me ligjin nr.9275, datë 16.9.2004, neni 25;*

*shtuar paragrafi II me ligjin nr.9686, datë 26.2.2007, neni 28)*

Furnizimi i autorit të një krimi me ushqime, me mjete të tjera për jetesë ose sigurimi i një banese, vendqëndrimi ose me çdo mënyrë tjetër me qëllim që t'i shpëtojë kërkimit, kapjes ose arrestimit, dënohet me gjobë ose me burgim gjer në pesë vjet.

Po kjo vepër kur kryhet në lidhje me veprat penale, të parashikuara në nenet 73, 74, 75, 79, 219, 220, 221, 230, 230/a, 230/b, 231, 232, 232/a, 234/a, 234/b, 284/a, 333 e 333/a të këtij Kodi, dënohet me burgim nga dy deri në shtatë vjet.

Përfshihen nga përgjegjësia penale të paralindurit dhe të paslindurit, vëllezërit dhe motrat, bashkëshorti, adoptuesit dhe të adoptuarit.

Neni 303

### **Fshehja ose asgjësimi i kufomës**

Fshehja ose asgjësimi i kufomës së një personi, viktimë e vrasjes apo të veprave të tjera të dhunshme, e bërë me qëllim për të ndihmuar autorin e krimit që t'i shpëtojë kërkimit, kapjes dhe arrestimit, dënohet me gjobë ose me burgim gjer në pesë vjet.

Neni 304

### **Detyrimi për të kallëzuar provën**

Mosparaqitja menjëherë për të kallëzuar ose dëshmuar para organeve të prokurorisë, gjykatës apo organeve të rendit, për provën e njohur që e bën të pafajshëm një person tjetër që akuzohet ose është dënuar për një vepër penale, dënohet me gjobë ose me burgim gjer në pesë vjet.

Përfshihen nga detyrimi për kallëzim autori i veprës penale, si dhe personat që vijnë në dijeni të provës për shkak të detyrës apo profesionit dhe janë të detyruar të mos kallëzojnë e dëshmojnë për të.

Neni 305

### **Kallëzimi i rremë**

Kallëzimi për kryerjen e një krimi që dihet se nuk është kryer ose për kryerjen e një krimi nga një person që dihet se nuk e ka kryer atë, si edhe, krijimi i provave të rreme me qëllim që të bëhen ndjekje penale, dënohen me gjobë ose me burgim gjer në pesë vjet.

Neni 305/a

### **Deklaratat e rreme përpara prokurorit**

*(Shtuar me ligjin nr.9686, datë 26.2.2007, neni 29)*

Kushdo që, gjatë hetimeve apo procedimeve penale, i pyetur nga një prokuror që të japë informacionin e duhur lidhur me hetimin, jep të dhëna, me gojë ose me shkrim, që ai e di se janë, tërësisht ose pjesërisht, të rreme apo fsheh fakte ose prova, dënohet me gjobë ose me burgim deri në një vit.

Dispozitat e këtij neni nuk janë të zbatueshme në rast se akti është kryer në çdo fazë të procedimit penal nga një person i dyshuar ose i pandehur për veprën penale ose nga dikush, që duhet të ishte përfshuar nga kërkesa për informacion apo për të dëshmuar, për çdo arsye të ligjshme, ose që nuk ishte paralajmëruar për të drejtën për të mos dëshmuar apo për t'iu përgjigjur pyetjeve.

Neni 305/b

### **Deklaratat e rreme përpara oficerit të policisë gjyqësore**

*(Shtuar me ligjin nr.9686, datë 26.2.2007, neni 29)*

Kushdo që, gjatë hetimit, i pyetur nga një oficer i policisë gjyqësore që të japë informacionin e duhur, jep të dhëna, me gojë ose me shkrim, që ai i di se janë, tërësisht ose pjesërisht, të rreme apo fsheh fakte ose prova, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim deri në gjashtë muaj.

Dispozitat e këtij neni nuk janë të zbatueshme në rast se akti është kryer në çdo fazë të procedimit penal nga një person i dyshuar ose i pandehur për veprën penale ose nga dikush, që duhej të ishte përjashtuar nga kërkesa për informacion apo për të dëshmuar, për çdo arsye të ligjshme, ose që nuk ishte paralajmëruar për të drejtën për të mos dëshmuar apo për t'iu përgjigjur pyetjeve.

Neni 306

#### **Dëshmia e rreme**

*(Ndryshuar paragrafi I me ligjin nr.8733, datë 24.1.2001, neni 75;  
shtuar paragrafi III me ligjin nr.9275, datë 16.9.2004, neni 26;  
ndryshuar paragrafi III me ligjin nr.9686, datë 26.2.2007, neni 30)*

Dëshmia e rreme e bërë përpara gjykatës përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në dy vjet.

Kur dëshmia e rreme bëhet me qëllim fitimi apo çdo interes tjetër të dhënë apo të premtuar, dënohet me gjobë ose me burgim gjer në tre vjet.

Po kjo vepër kur kryhet në lidhje me veprat penale të parashikuara në nenet 234/a, 234/b, 284/a 333 e 333/a të këtij Kodi, dënohet me burgim nga dy deri në gjashtë vjet.

Neni 307

#### **Refuzimi për të dëshmuar**

*(Ndryshuar paragrafi II, shtuar paragrafi i fundit me ligjin nr.9686,  
datë 26.2.2007, neni 31)*

Refuzimi për t'iu përgjigjur pyetjeve rreth dijenisë për kryerjen e një vepre penale apo të autorit të saj, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në një vit.

Kur refuzimi për të dëshmuar bëhet me qëllim fitimi apo çdo interes tjetër të dhënë apo të premtuar, dënohet me burgim nga një deri në katër vjet.

Dispozitat e këtij neni nuk janë të zbatueshme në rast se akti është kryer në çdo fazë të procedimit penal nga një person i dyshuar ose i pandehur për veprën penale ose nga dikush, që duhej të ishte përjashtuar nga kërkesa për informacion apo për të dëshmuar, për çdo arsye të ligjshme, ose që nuk ishte paralajmëruar për të drejtën për të mos dëshmuar apo për t'iu përgjigjur pyetjeve.

Neni 308

#### **Përkthimi i rremë**

Shtrembërimi me dashje i përmbajtjes së një dokumenti apo shkrimi të dhënë për përkthim nga organet e ndjekjes penale apo gjykata ose përkthimi i rremë përpara tyre, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në dy vjet.

Kur përkthimi i rremë bëhet me qëllim fitimi apo çdo interes tjetër të dhënë apo të premtuar, dënohet me gjobë ose me burgim gjer në tre vjet.

Neni 309

#### **Ekspertimi i rremë**

Dhënia me dashje e rezultateve të rreme në raportet e ekspertimit të bëra me shkrim apo me gojë përpara organeve të ndjekjes penale ose gjykatës, dënohet me gjobë ose me burgim gjer në tre vjet.

Kur ekspertimi i rremë bëhet me qëllim fitimi apo çdo interes tjetër të dhënë apo të premtuar, dënohet me gjobë ose me burgim gjer në pesë vjet.

Neni 310

### **Mosparaqitja e dëshmitarit, ekspertit apo përkthyesit**

Mosparaqitja e dëshmitarit, ekspertit apo përkthyesit, pa shkaqe të arsyeshme ose mospranimi prej tyre për të kryer detyrat e caktuara nga organi i ndjekjes penale ose gjykata, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në gjashtë muaj.

Neni 311

### **Kanosja për të mos kallëzuar**

*(Ndryshuar me ligjin nr.9686, datë 26.2.2007, neni 32;*

*ndryshuar me ligjin nr.23/2012, datë 1.3.2012, neni 56)*

Kanosja, që i bëhet të dëmtuarit nga vepra penale, me qëllim që të mos kallëzojë, të ankohet apo të tërheqë kallëzimin ose ankimin e bërë, dënohet me burgim nga një deri në katër vjet.

Neni 312

### **Korrupsioni aktiv i dëshmitarit, i ekspertit ose përkthyesit**

*(Ndryshuar me ligjin nr.9275, datë 16.9.2004, neni 27)*

*(Shfuqizuar me ligjin nr.144/2013, datë 2.5.2013, neni 48)*

Premtimi, propozimi ose dhënia, drejtpërdrejt ose tërthorazi, i çfarëdo përfitimi të parregullt, për vete ose për persona të tretë, dëshmitarit, ekspertit ose përkthyesit, për të siguruar deklarime ose dëshmi, ekspertim ose përkthim të rremë ose për të refuzuar kryerjen e detyrimeve të tyre përpara organeve të ndjekjes penale dhe gjykatës, dënohen me burgim deri në katër vjet.

Neni 312/a

### **Kanosja për deklarime a dëshmi, ekspertim ose përkthim të rremë**

*(Shtuar me ligjin nr.9275, datë 16.9.2004, neni 28;*

*ndryshuar me ligjin nr.9686, datë 26.2.2007, neni 33)*

Kanosja ose vepra të tjera dhune, që i bëhen personit për të siguruar deklarime a dëshmi, ekspertim ose përkthim të rremë ose për të refuzuar kryerjen e detyrave të tyre përpara organeve të ndjekjes penale dhe gjykatës dënohet me burgim nga një deri në katër vjet.

Neni 313

### **Fillimi i paligjshëm i ndjekjes penale**

Fillimi i paligjshëm i ndjekjes penale nga prokurori kundër një personi që dihet se është i pafajshëm dënohet me gjobë ose me burgim gjer në pesë vjet.

Neni 313/a

**Zhdukja ose humbja e fashikullit**

*(Shtuar me ligjin nr.8733, datë 24.1.2001, neni 77)*

Zhdukja ose humbja me çdo mënyrë e fashikullit të hetimit ose të gjykimit, si dhe heqja prej tyre e dokumenteve, shkresave ose të dhënave të tjera që ndodhen të bashkuara me to, kur ka sjellë pasoja të rënda në dëm të interesave të shtetasve ose të shtetit, dënohet me gjobë ose me burgim gjer në pesë vjet.

Neni 313/b

**Ndalimi i dhënies dhe i shpalljes së të dhënave në kundërshtim me ligjin**

*(Shtuar me ligjin nr.9275, datë 16.9.2004, neni 29;*

*ndryshuar me ligjin nr.23/2012, datë 1.3.2012, neni 56 )*

1. Bërja publike, edhe në organe të medias, në kundërshtim me ligjin e të dhënave me karakter të klasifikuar dhe konfidencial, që rrezikojnë jetën, integritetin fizik ose lirinë e personave të mbrojtur, sipas ligjit nr.9205, datë 15.3.2004 “Për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe të bashkëpunëtorëve të drejtësisë”, dënohet me gjobë ose me burgim deri në dy vjet dhe, kur nga kryerja e kësaj vepre kanë ardhur pasoja të rënda për shëndetin e tyre, me burgim nga 6 muaj deri në tre vjet.

2. Kur kjo vepër kryhet nga njëri prej personave që kanë përgjegjësinë për të ruajtur karakterin e klasifikuar dhe konfidencial të të dhënave, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre vjet dhe, kur nga kryerja e kësaj vepre kanë ardhur pasoja të rënda për shëndetin e tyre, me burgim nga dy deri në pesë vjet.

3. Kur vepra ka sjellë si pasojë vdekjen dënohet me burgim nga tre deri në dhjetë vjet.

Neni 314

**Përdorimi i dhunës gjatë hetimeve**

Përdorimi i dhunës nga personi i ngarkuar me zhvillimin e hetimeve për ta detyruar shtetasin të bëjë deklaratë, të dëshmojë ose të pohojë pafajësinë e tij a të një tjetri, dënohet me burgim nga tre gjer në dhjetë vjet.

Neni 315

**Dhënia e një vendimi të padrejtë**

*(Shfuqizuar me vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.11, datë 2.4.2008)*

Neni 316

**Kundërshtimi dhe goditja e gjyqtarit**

Kundërshtimi me dhunë, goditjet dhe vepra të tjera dhune që i bëhen gjyqtarit apo anëtarëve të trupit gjykues, prokurorit, avokatit, ekspertëve, çdo arbitri të caktuar për një çështje, për ta penguar në kryerjen e detyrës apo për shkak të saj, dënohen me gjobë ose me burgim gjer në shtatë vjet.

Neni 318

**Fyerja e gjyqtarit**

*(Ndryshuar me ligjin nr.23/2012, datë 1.3.2012, neni 40)*

Fyerja e gjyqtarit apo anëtarëve të trupit gjykues, prokurorit, avokatit ose anëtarit të arbitrazhit, për shkak të veprimtarisë së tyre në një çështje, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në tre muaj.

Neni 319

**Korrupsioni aktiv i gjyqtarit, prokurorit dhe i funksionarëve të tjerë të drejtësisë**

*(Ndryshuar me ligjin nr.9275, datë 16.9.2004, neni 30)*

*(Shfuqizuar me ligjin nr.144/2013, datë 2.5.2013, neni 48)*

Premtimi, propozimi ose dhënia, drejtpërdrejt ose tërthorazi, i çfarëdo përfitimi të parregullt, për vete ose për persona të tjerë, gjyqtarit, prokurorit ose çdo punonjësi tjetër të organeve të drejtësisë, për të kryer ose mos kryer një veprim, që lidhet me detyrën a funksionin e tij, dënohen me burgim nga një vit deri në katër vjet.

Neni 319/a

**Korrupsioni aktiv i gjyqtarit ose i zyrtarit të gjykatave ndërkombëtare**

*(Shtuar me ligjin nr.23/2012, datë 1.3.2012, neni 42)*

*(Shfuqizuar me ligjin nr.144/2013, datë 2.5.2013, neni 48)*

Premtimi, propozimi ose dhënia, drejtpërdrejt a tërthorazi, i çfarëdo përfitimi të parregullt, për vete ose për persona të tjerë, gjyqtarit ose zyrtarit të gjykatave ndërkombëtare, për të kryer apo për të mos kryer një veprim, që lidhet me detyrën a funksionin e tij, dënohen me burgim nga një vit gjer në katër vjet.

Neni 319/b

**Korrupsioni aktiv i arbitrit vendas dhe të huaj**

*(Shtuar me ligjin nr.23/2012, datë 1.3.2012, neni 42)*

*(Shfuqizuar me ligjin nr.144/2013, datë 2.5.2013, neni 48)*

Premtimi, propozimi ose dhënia, drejtpërdrejt a tërthorazi, i çfarëdo përfitimi të parregullt, për vete ose për persona të tjerë, arbitrit vendas ose të huaj, për të kryer apo për të mos kryer një veprim, që lidhet me detyrën a funksionin e tij, dënohen me burgim nga një vit gjer në katër vjet.

Neni 319/c

**Korrupsioni aktiv i anëtarëve të jurive gjyqësore të huaja**

*(Shtuar me ligjin nr.23/2012, datë 1.3.2012, neni 42)*

*(Shfuqizuar me ligjin nr.144/2013, datë 2.5.2013, neni 48)*

Premtimi, propozimi ose dhënia, drejtpërdrejt a tërthorazi, i çfarëdo përfitimi të parregullt, për vete ose për persona të tjerë, i anëtarëve të jurive gjyqësore të huaja, për të kryer apo për të mos kryer një veprim, që lidhet me detyrën a funksionin e tij, dënohen me burgim nga një vit gjer në katër vjet.

Neni 319/ç

**Korrupsioni pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë**

*(Shtuar me ligjin nr.9275, datë 16.9.2004, neni 31;*

*numërtuar me ligjin nr.23/2012, datë 1.3.2012, neni 41)*

*(Shfuqizuar me ligjin nr.144/2013, datë 2.5.2013, neni 48)*

Kërkimi ose marrja, drejtpërdrejt ose tërthorazi, i çdo lloj përfitimi të parregullt ose i një premtimi të tillë, për vete ose për persona të tjerë, ose pranimi i një oferte a premtimi, që vjen nga përfitimi i

parregullt, nga gjyqtari, prokurori ose funksionarë të tjerë të organeve të drejtësisë, për të kryer ose mos kryer një veprim që lidhet me detyrën e funksionin e tij, dënohen me burgim nga tre deri në dhjetë vjet.

Neni 319/d

**Korrupsioni pasiv i gjyqtarit ose i zyrtarit të gjykatave ndërkombëtare**

*(Shtuar me ligjin nr.23/2012, datë 1.3.2012, neni 43 )*

*(Shfuqizuar me ligjin nr.144/2013, datë 2.5.2013, neni 48)*

Kërkimi ose marrja, drejtpërdrejt a tërthorazi, i çdo lloj përfitimi të parregullt ose i një premtimi të tillë, për vete ose për persona të tjerë, apo pranimi i një oferte a premtimi që vjen nga përfitimi i parregullt, nga gjyqtari ose zyrtari i një gjykate ndërkombëtare, për të kryer apo për të mos kryer një veprim, që lidhet me detyrën a funksionin e tij, dënohet me burgim nga tre gjer në dhjetë vjet.

Neni 319/dh

**Korrupsioni pasiv i arbitrit vendas dhe të huaj**

*(Shfuqizuar me ligjin nr.144/2013, datë 2.5.2013, neni 48)*

Kërkimi ose marrja, drejtpërdrejt a tërthorazi, i çdo lloj përfitimi të parregullt ose i një premtimi të tillë, për vete ose për persona të tjerë, apo pranimi i një oferte a premtimi që vjen nga përfitimi i parregullt, nga arbitri vendas ose i huaj për të kryer apo për të mos kryer një veprim, që lidhet me detyrën a funksionin e tij, dënohet me burgim nga dy gjer në tetë vjet.

Neni 319/e

**Korrupsioni pasiv i anëtarëve të jurive gjyqësore të huaja**

*(Shtuar me ligjin nr.23/2012, datë 1.3.2012, neni 43)*

*(Shfuqizuar me ligjin nr.144/2013, datë 2.5.2013, neni 48)*

Kërkimi ose marrja, drejtpërdrejt a tërthorazi, i çdo lloj përfitimi të parregullt ose i një premtimi të tillë, për vete a për persona të tjerë, apo pranimi i një oferte a premtimi që vjen nga përfitimi i parregullt, nga një anëtar i jurive gjyqësore të huaja, për të kryer apo për të mos kryer një veprim, që lidhet me detyrën a funksionin e tij, dënohet me burgim nga dy gjer në tetë vjet.

Neni 320

**Pengime për ekzekutimin e vendimeve të gjykatës**

Fshehja, tjetërsimi, konsumimi, dëmtimi apo shkatërrimi i sendeve për të cilat është marrë një vendim prej gjykatës, ose kryerja e veprimeve të tjera të bëra me qëllim që të mos ekzekutohet ose të pengohet ekzekutimi i vendimit gjyqësor, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në dy vjet.

Neni 320/a

**Mosekzekutimi pa shkaqe të përligjura i vendimit të gjykatës**

*(Shtuar me ligjin nr.8733, datë 24.1.2001, neni 78)*

Mosekzekutimi pa shkaqe të përligjura i një vendimi penal ose civil të gjykatës, nga punonjësi i ngarkuar me ekzekutimin e vendimeve, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në dy vjet.



Kur kjo vepër kryhet me qëllim fitimi ose çdo interes tjetër të dhënë ose të premtuar, si dhe për të favorizuar persona që kanë interes për mosekzekutimin e vendimit, dënohet me gjobë ose me burgim gjer në tre vjet.

Neni 321

**Veprime në kundërshtim me vendimin e gjykatës**

*(Shtuar paragrafi me ligjin nr.23/2012, datë 1.3.2012, neni 44)*

Kryerja e veprimeve në kundërshtim me vendimin e gjykatës në lidhje me detyrimet e lindura nga dënimet plotësuese të dhëna prej saj, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në dy vjet.

Kryerja e veprimeve në kundërshtim me vendimin e gjykatës, në lidhje me detyrat e lindura nga urdhrat e mbrojtjes të dhëna prej saj, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me burgim gjer në dy vjet.

Neni 322

**Prishja e vulave dhe shenjave**

Prishja me dashje e vulave dhe shenjave të tjera të vendosura mbi sende të ndryshme nga organet e ndjekjes penale dhe gjyqësore, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në gjashtë muaj.

Neni 323

**Largimi i të burgosurit nga vendi i qëndrimit**

Largimi i të ndaluarit, arrestuarit apo të dënuarit me burgim nga vendi i qëndrimit të detyrueshëm ose gjatë transportimit të tij nga një vend në tjetrin, dënohet me burgim gjer në pesë vjet.

Kur vepra penale kryhet me dhunë ose me përdorim të armëve, substancave zjarrvënëse, eksplozive dhe helmuese dënohet me burgim nga pesë gjer në pesëmbëdhjetë vjet.

Neni 324

**Dhënia ndihmë një të burgosuri për largim**

Dhënia e këshillave, informatave, mjeteve, të ndaluarit, të arrestuarit apo të burgosurit, me qëllim për t'u larguar nga vendi i qëndrimit të detyruar, dënohet me burgim gjer në tre vjet.

Kur dhënia ndihmë bëhet nga i ngarkuari me ruajtjen, mbikqyrjen apo transportimin, ose që për shkak të funksionit ka të drejtë të hyjë në institucione burgimi apo të ketë lidhje me të ndaluar, arrestuar apo të burgosur, dënohet me burgim nga pesë gjer në dhjetë vjet.

KREU X

**VEPRA PENALE QË PREKIN ZGJEDHJET E LIRA DHE SISTEMIN DEMOKRATIK TË ZGJEDHJEVE**

Neni 325

**Pengimi i subjekteve zgjedhore**

*(Ndryshuar me ligjin nr.23/2012, datë 1.3.2012, neni 45)*

Pengimi me anë të kanosjes, dhunës, apo me çdo mënyrë tjetër i subjekteve zgjedhore apo i kandidatëve për të zhvilluar veprimtarinë e tyre në përputhje me ligjin gjatë fushatës zgjedhore, dënohet me burgim nga tre muaj gjer në tre vjet.

Neni 326

**Falsifikimi i materialit zgjedhor dhe rezultateve të zgjedhjeve**

*(Ndryshuar me ligjin nr.23/2012, datë 1.3.2012, neni 46)*

*(Shfuqizuar me ligjin nr.144/2013, datë 2.5.2013, neni 48)*

Falsifikimi, shpërndarja ose përdorimi i fletëve të votimit, i dokumenteve dhe materialit zgjedhor, me qëllim ndryshmin e rezultatit të zgjedhjeve nëpërmjet paraqitjes në to të të dhënave, që dihen se janë të pasakta, zëvendësimi i të saktave me të rreme ose nëpërmjet futjes në kuti të fletëve të votimit në mënyrë të paligjshme dënohet me burgim nga një gjer në pesë vjet.

Po kjo vepër kur kryhet nga personat që kanë për detyrë të administrojnë procesin zgjedhor, ose ka sjellë pasoja të rënda në mbarëvajtjen e votimit, ka cenuar integritetin e rezultatit të zgjedhjeve apo ka sjellë pavlefshmërinë e tyre, dënohet me burgim nga tre gjer në shtatë vjet.

Neni 326/a

**Dëmtimi me dashje i materialit zgjedhor**

*(Shtuar me ligjin nr.23/2012, datë 1.3.2012, neni 47)*

*(Shfuqizuar me ligjin nr.144/2013, datë 2.5.2013, neni 48)*

Dëmtimi, prishja, shkatërrimi me dashje, apo zëvendësimi në kundërshtim me ligjin i pajisjeve, vulave, kodeve të sigurisë apo çdo materiali tjetër zgjedhor të parashikuar nga ligji, dënohet me burgim nga gjashtë muaj gjer në pesë vjet.

Po këto vepra kur kryhen nga personat përgjegjës për administrimin zgjedhor ose në bashkëpunim, ose më shumë se një herë, apo kur kanë sjellë pasoja të rënda në mbarëvajtjen e zgjedhjeve, kanë sjellë pavlefshmërinë e tyre apo kanë cenuar rezultatit të votimit, dënohen me burgim nga tre gjer në tetë vjet.

Neni 327

**Shkelja e fshehtësisë së votimit**

*(Ndryshuar me ligjin nr.23/2012, datë 1.3.2012, neni 48)*

Shkelja e rregullave që garantojnë fshehtësinë e votimit nga ana e personave të ngarkuar me zgjedhjet, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me burgim nga tre muaj gjer në dy vjet.

Neni 327/a

**Votimi më shumë se një herë ose pa u identifikuar**

*(Shtuar me ligjin nr.23/2012, datë 1.3.2012, neni 49)*

Votimi më shumë se një herë në të njëjtat zgjedhje, votimi për persona të tjerë, duke paraqitur dokumente identifikimi të rreme apo duke përdorur dokumente të zgjedhësve të tjerë dënohet me burgim nga një gjer në tre vjet.

Lejimi me dashje i kryerjes së kësaj vepre nga komisionerët zgjedhorë dënohet me burgim nga një gjer në pesë vjet.

Lejimi me dashje nga komisionerët zgjedhorë i votimit, pa kryer identifikimin e shtetasit sipas ligjit, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me burgim nga tre muaj gjer në një vit.

Neni 328

**Dhënia e shpërblimeve dhe e premtimeve**

*(Ndryshuar me ligjin nr.23/2012, datë 1.3.2012, neni 50)*

Ofrimi ose dhënia e të hollave apo të mirave materiale, bërja e premtimeve për vende pune ose për favorizime të tjera në cilëndo formë, me qëllim që të marrë firmën për paraqitjen e kandidatit, për të votuar në një mënyrë të caktuar apo për të marrë pjesë ose jo në votime, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me burgim nga gjashtë muaj gjer në dy vjet.

Pranimi i të hollave, të mirave materiale, premtimeve dhe favorizimeve të tjera kundërsht kryerjes së veprimeve të mësipërme, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë.

Neni 328/a

**Detyrimi për pjesëmarrje në veprimtari politike**

*(Shtuar me ligjin nr.23/2012, datë 1.3.2012, neni 51)*

Detyrimi i shtetasve nën varësi administrative, kundër vullnetit të tyre apo nën kanosjen e përdorimit të masave administrative, për të marrë pjesë në veprimtari zgjedhore të një subjekti zgjedhor përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në gjashtë muaj.

Detyrimi apo organizimi për të marrë pjesë në veprimtari elektorale të një subjekti zgjedhor i nxënësve të arsimit parauniversitar nga punonjës që kryejnë një detyrë shtetërore në arsimin publik, ose detyrë a funksion në arsimin jopublik, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me burgim nga tre muaj gjer në një vit.

Neni 329

**Kanosja apo dhunimi ndaj pjesëmarrësve në zgjedhje**

*(Ndryshuar me ligjin nr.23/2012, datë 1.3.2012, neni 52)*

Kanosja që i bëhet zgjedhësit për të votuar në një mënyrë të caktuar apo për të marrë pjesë ose jo në votime, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet nga tre muaj gjer në dy vjet.

Kanosja apo përdorimi i dhunës që i bëhet komisionerit, vëzhguesit, numëruesit si dhe çdo zyrtari tjetër të ngarkuar me zgjedhjet për ta penguar në kryerjen e detyrës apo për shkak të veprimtarisë së tij në administrimin zgjedhor dënohet me burgim nga gjashtë muaj gjer në tre vjet.

Kur kjo vepër kryhet në bashkëpunim ose më shumë se një herë dënohet me burgim nga një gjer në pesë vjet.

Neni 330

**Pengimi i zgjedhësit**

*(Ndryshuar me ligjin nr.23/2012, datë 1.3.2012, neni 53)*

Pengimi i zgjedhësit për të votuar në qendrën e tij të votimit, duke shkelur rregullat e votimit, duke i marrë apo dëmtuar dokumentin e tij të identifikimit, apo në çdo formë tjetër, dënohet me burgim nga gjashtë muaj gjer në një vit.

Kur kjo vepër kryhet më shumë se një herë, ndaj më shumë se një zgjedhësi apo kur kryhet nga komisionerët zgjedhorë, dënohet me burgim nga një gjer në pesë vjet.

Neni 330/a  
**Braktisja e detyrës nga anëtarët e komisioneve të zgjedhjeve**  
*(Shtuar me ligjin nr.23/2012, datë 1.3.2012, neni 54)*

Braktisja e detyrës apo refuzimi për të kryer detyrën nga personat e ngarkuar me administrimin e procesit të votimit dhe të numërimit, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me burgim nga gjashtë muaj gjer në dy vjet.

Kur veprimet e mësipërme kryhen duke marrë me vete ose duke zhdukur materialet zgjedhore, ose kur kanë sjellë pasoja të rënda për procesin e votimit apo kanë çuar në pavlefshmërinë e zgjedhjeve, dënohet me burgim nga dy gjer në pesë vjet.

Neni 331  
**Shkelja e së drejtës së zgjedhjes**  
*(Ndryshuar me ligjin nr.23/2012, datë 1.3.2012, neni 55)*  
*(Shfuqizuar me ligjin nr.144/2013, datë 2.5.2013, neni 48)*

Mospërfshirja me dashje në listat e zgjedhësve e personave që e kanë të drejtën e zgjedhjes ose regjistrimi me dashje në to i personave që nuk e kanë këtë të drejtë, dënohet me burgim nga një gjer në pesë vjet.

Po kjo veprë e kryer në bashkëpunim, kur ka sjellë pasoja të rënda për interesat e zgjedhësve apo mbarëvajtjen e procesit zgjedhor dënohet me burgim nga dy gjer në pesë vjet.

Neni 332  
**Shpërdorimi i autoritetit ushtarak**

Shpërdorimi i autoritetit ushtarak nga oficeri ose kuadri ushtarak për të influencuar në votim tek ushtarakët e tjerë që ka në varësi, me dhënie urdhërash, këshilla apo me çfarëdo lloj propagande, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në dy vjet.

KREU XI  
VEPRA PENALE TË KRYERA NGA BANDA E ARMATOSUR DHE ORGANIZATA KRIMINALE

Neni 333  
**Organizata kriminale**  
*(Ndryshuar me ligjin nr.9275, datë 16.9.2004, neni 32)*

Krijimi, organizimi ose drejtimi i organizatave kriminale dënohen me burgim nga pesë deri në pesëmbëdhjetë vjet.

Pjesëmarrja në një organizatë kriminale dënohet me burgim nga katër deri në tetë vjet.

Nëse organizata kriminale është e armatosur dhe pjesëtarët e saj zotërojnë armë dhe lëndë shpërthyesë për qëllime të përmbushjes së veprimtarisë së saj kriminale, edhe nëse ato janë të fshehura ose të mbajtura në vende të veçanta, dënimi me burgim shtohet me një të tretën.

Kur veprimtaritë ekonomike, të ndërmarra ose të kontrolluara nga pjesëtarë të organizatës kriminale, financohen tërësisht ose pjesërisht me produkte të veprave penale, masa e dënimit, sipas paragrafëve të sipërpërmendur në këtë nen, shtohet me një të tretën deri në një të dytën e tij.

Neni 333/a

**Grupi i strukturuar kriminal**

*(Shtuar me ligjin nr.9275, datë 16.9.2004, neni 33)*

Krijimi, organizimi ose drejtimi i një grupi të strukturuar kriminal për kryerjen e veprave penale dënohen me burgim nga tre deri në tetë vjet.

Pjesëmarrja në grupin e strukturuar kriminal dënohet me burgim nga dy deri në pesë vjet.

Neni 334

**Kryerja e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal**

*(Ndryshuar me ligjin nr.8733, datë 24.1.2001, neni 79;*

*ndryshuar me ligjin nr.9275, datë 16.9.2004, neni 34)*

1. Kryerja e veprave penale nga pjesëtarë të organizatës kriminale dhe të grupit të strukturuar kriminal dënohet sipas dispozitave penale përkatëse, duke i shtuar dënimit për veprën penale të kryer edhe pesë vjet burgim, si dhe gjobën në masën një të tretën, por pa kaluar kufirin maksimal të dënimit me burgim.

2. Kur dispozita përkatëse referuese përmban dënim me burgim apo me burgim të përjetshëm, dënohet me njëzet e pesë vjet burgim ose me burgim të përjetshëm.

3. Kur dispozita përkatëse referuese përmban vetëm dënim me burgim të përjetshëm, dënohet me burgim të përjetshëm.

Neni 334/1

*(Shtuar me ligjin nr.9017, datë 6.3.2003, neni 1)*

Pavarësisht nga neni 278, përjashtohen nga ndjekja penale për armëmbajtje pa leje të armëve dhe municioneve luftarake personat që në përputhje me legjislacionin në fuqi, dorëzojnë vullnetarisht armët deri më datën 31.5.2005.

Në çdo rast nuk përjashtohen nga ndjekja penale për armëmbajtje pa leje personat që kanë kryer veprë penale, duke përdorur si mjet për këtë qëllim armë dhe municione luftarake.

Nuk përjashtohen nga ndjekja penale edhe personat të cilët, pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, deklarojnë se nuk kanë armë e municione luftarake dhe nga kontrollet e ushtruara në mbështetje të dispozitave përkatëse të Kodit të Procedurës Penale u gjenden armë e municione të fshehura.

Neni 335

Ky kod hyn në fuqi më 1 qershor 1995. Aktet ligjore që shfuqizohen, si dhe efektet dhe mënyra e hyrjes së tij në fuqi, do të caktohet me ligj të veçantë.

**Dispozitë kalimtare**

*(E parashikuar me ligjin nr.23/2012, datë 1.3.2012)*

Pushohen ndjekjet penale për çështjet në hetim, për çështjet e pashqyrtuara nga gjykatat, si dhe për kallëzimet, që ndodhen në këto organe dhe në organet e rendit publik, për veprat penale, të cilat shfuqizohen me hyrjen në fuqi të këtij ligji.

## LIGJE PËR NDRYSHIME DHE SHITESA NË KODIN PENAL

	Fletore	Faqe
Ligji nr.8175, datë 23.12.1996	29	965
Ligji nr.8204, datë 10.4.1997	4	78
Ligji nr.8279, datë 15.1.1998	1	10
Ligji nr.8733, datë 24.1.2001	4	100
Ligji nr.9017, datë 6.3.2003	21	641
Ligji nr.9030, datë 13.3.2003	23	729
Ligji nr.9086, datë 19.6.2003	57	2432
Ligji nr.9188, datë 12.2.2004	13	541
Ligji nr.9275, datë 16.9.2004	69	4589
Ligji nr.9686, datë 26.2.2007	27	489
Ligji nr.9859, datë 21.1.2008	10	301
Ligji nr.10 023, datë 27.11.2008	190	9395
Ligji nr.23/2012, datë 1.3.2012	26	1298
Ligji nr.144/2013, datë 2.5.2013	83	3526
Vendim i GJK nr.11, datë 2.4.2008	52	2352
Vendim i GJK nr.19, datë 1.6.2011	77	3149
Vendimi GJK nr.47, datë 26.7.2012	101	5493

## VENDIME TË KOLEGJEVE TË BASHKUARA TË GJYKATËS SË LARTË PËR DISPOZITAT E KODIT PENAL

	Faqe
Vendim nr.4, datë 27.3.2003 - për nenin 3	11
Vendim nr.1, datë 26.3.2002 - për nenin 25-27	22
Vendim nr.7, datë 11.10.2002 - për nenin 66 dhe 68	43
Vendim nr.5, datë 11.11.2003 - për nenin 134	74
Vendim nr.1, datë 26.3.2002 - për nenin 171-179	90
Vendim nr.19, datë 1.6.2011 - për nenin 34	3149

## TREGUESI ALFABETIK I KODIT PENAL

- A -

<b>Amnisti</b> - kuptimi	71
-----------------------------	----

**Armë**

- prodhim e mbajtje pa leje	278
- trafikim	278/a
- të ftohta	279
- armë gjahu e sportive	280
- stërvitja për prodhimin dhe përdorimin e paligjshëm të armëve dhe lëndëve të tjera të rrezikshme	282/b
<b>Atentat</b>	
- kuptimi	219
- B -	
<b>Bandë e armatosur</b>	
- kuptimi	28/3
- krijimi, pjesëmarrja	234/b
<b>Bashkëjetesë</b>	
- shtrëngim	130
<b>Bashkëpunëtor</b>	
- kuptimi	26
<b>Bashkëpunimi</b>	
- forma të veçanta	28
<b>Bashkim</b>	
- i dënimeve	56
<b>Botim</b>	
- i veprës së tjetrit	149
<b>Braktisje</b>	
- e fëmijëve të mitur	124
- e detyrës nga anëtarët e komisioneve të zgjedhjeve	330/a
<b>Burgim</b>	
- dënimi	32
- i të miturit	52
- i përjetshëm	31
- mënyra e vuajtjes	33
- copëzimi	58
- pezullimi	59
<b>Bursë</b>	
- regjistrimi i titujve në mënyrë të paautorizuar	143/a/5

- C -

**Caktim**

- i dënimeve për disa veprave penale 55

- D -

**Dashja**

- kuptimi 15

**Deklarata të rreme**

- përpara prokurorit 305/a

- përpara oficerit të policisë gjyqësore 305/b

**Detyrë**

- shpërdorim 248

**Detyrim**

- gjatë kohës së provës 61

- për të marrë pjesë në grevë 264

- për të kallëzuar provën 304

**Dëmtime**

- të tjera me dashje 90

- të objekteve mbrojtëse 215

- me dashje i materialit zgjedhor 326/a

**Dënim**

- kryesor 29

- plotësues 30

- me burgim të përjetshëm 31

- me burgim 32

- me gjobë 34

- me burgim për të mitur 51

- ulja nën kufij 53

- caktimi 55

- bashkimi 56

- në provë 59-61

- përjashtimi nga dënimi 254/2

- qëndrimi në shtëpi 59/a

**Dëshmi**

- e rreme 306

- refuzimi 307

**Disinformim**



- i ekipeve të urgjencës	271
<b>Dokumente</b>	
- vjedhje	192/a
<b>Dorëzim</b>	
- i territorit	208
- i forcave të armatosura	209
<b>Drejtim</b>	
- i automjetit në mënyrë të parregullt	291
 - DH -	
<b>Dhënie</b>	
- e mjeteve për ndërprerje të shtatzanisë	95
- e informacioneve të rreme	168
- e informatave sekrete	213
- e shpërblimeve punonjësve shtetëror	245
- ndihme për kalim të paligjshëm të kufirit	298
<b>Dhuna</b>	
- në familje	130/a
<b>Dhunim</b>	
- i banesës	112
- i varreve	118
 - E -	
<b>Ekspertim</b>	
- i rremë	309
<b>Ekstradim</b>	
- kur lejohet	11
<b>Emetim</b>	
- i parregullt i aksioneve	166
 - F -	
<b>Faji</b>	
- kuptimi	14
<b>Falimentim</b>	
- i provokuar	193

- fshehje e gjendjes	194
- fshehje e pasurisë	195
- shkelje detyrimesh	196
<b>Falja</b>	
- kuptimi	70
<b>Falsifikimi</b>	
- i nënshkrimeve	165
- i monedhave	183
- i letrave me vlerë	184
- prodhimi i mjeteve	185, 192
- i dokumenteve	187
- i dokumenteve shkollore	187
- i dokumenteve shëndetësore	188
- i letërnjoftimeve dhe vizave	189
- i vulave, stampave dhe formularëve	190
- i akteve të gjendjs civile	191
- i dokumenteve dhe rezultateve të zgjedhjeve	326
- kompjuterik	186/a
<b>Fëmijë</b>	
- braktisja e të miturve	124
- keqtrajtimi i të miturve	124/b
- mosdhënia e mjeteve për jetesë	125
- marrja e padrejtë	127
- ndërrimi	128
- fshehja	128/a
- trafikimi	128/b
- shtytje në krim	129
<b>Fillimi</b>	
- i paligjshëm i ndjekjes penale	313
<b>Fshehja</b>	
- e pronësisë	143/a/6
- e të ardhurave	180
- e gjendjes së falimentimit	194
- e pasurisë pas falimentimit	195
- e kufomës	303
<b>Fuqi</b>	
- e vendimeve penale të huaja	10
<b>Fyerje</b>	
- e gjyqtarit	318
- me motive racizmi ose ksenofobie	

nëpërrmjet sistemit kompjuterik - G -	119/b
<b>Genocid</b> - kuptimi	73
<b>Goditje</b> - për shkak të detyrës - ndaj pjesëtarëve të familjes	237 243
<b>Grupi i strukturuar kriminal</b> - krijimi pjesëmarrja	333/1
- GJ -	
<b>Gjakmarrje</b> - nxitja	83/b
<b>Gjyqtar</b> - kundërshtim e goditje - kanosja - fyerja	316 317 318
- H -	
<b>Heqje</b> - dorë nga vepra penale - e të drejtës për detyra publike - e dekoratave dhe titujve - e të drejtës së veprimtarisë - e të drejtës së detyrave drejtuese - e paligjëshme e lirisë	24 35 38 39 40 110
<b>Humbje</b> - e dokumenteve sekrete - e përgjegjësisë prindërore	296 43/a
- J -	
<b>Jeta private</b> - ndërhyrje e padrejtë - përhapje sekretesh	121 122

**Juridiksioni**

- universal 7/a

- K-

**Kalimi**

- i paligjshëm i kufirit 297

**Kallëzimi**

- i rremë 305

**Kanosja**

- për hakmarrje ose gjakmarrje 83/a  
- për vrasje 84  
- për shkak të detyrës 238  
- për të mos kallzuar 311  
- për dëshmi të rreme 312/a  
- e gjyqtarit 317  
- e zgjedhësit 329  
- e kandidatit 330  
- për kryerjen e veprave me qëllime terroriste 232/b  
- për të moskallëzuar 311  
- me motive racizmi dhe ksenofobie  
nëpërmjet sistemit kompjuterik 84/a

**Kërkim**

- për dhënie mite 259  
- i shpërblimit 319

**Kodi Penal**

- parimet 1/c  
- veprimi në kohë 3

**Komplot**

- kuptimi 220

**Konfiskim**

- i mjeteve të kryerjes së veprës penale 36

**Kondrabandë**

- me mallra të ndaluar 171  
- me mallra për të cilat paguhet akcizë 172  
- me mallra të licencuara 173  
- me mallra të tjera 174  
- nga punonjës të doganave 175

- e vlerave kulturore	176	
- me mallra me regjim të ndërmjetëm	177	
- tregtimi e transporti	178	
- ruajtja e depozitimi	179	
<b>Korrespondencë</b>		
- pengim ose shkelje e fshehtësisë		123, 255
<b>Korrupsioni</b>		
- aktiv privat	164/a	
- pasiv privat	164/b	
- aktiv i personave publikë	244	
- aktiv i punonjësve të huaj publikë	244/a	
- aktiv i funksionarëve të lartë	245	
- pasiv i personave publikë	259	
- pasiv i nëpunësve të huaj publikë	259/a	
- pasiv i funksionarëve të lartë	260	
- aktiv i dëshmitarit, ekspertit dhe përkthyesit	312	
- aktiv i gjyqtarit, prokurorit etj	319	
- aktiv i gjyqtarit ose i zyrtarit të gjykatave ndërkombëtare	319/a	
- aktiv i arbitrit vendas dhe të huaj	319/b	
- aktiv i anëtarëve të jurive gjyqësore të huaja	319/c	
- pasiv i gjyqtarit ose i zyrtarit të gjykatave ndërkombëtare	319/d	
- pasiv i arbitrit vendas dhe të huaj	319/dh	
- pasiv i anëtarëve të jurive gjyqësore të huaja	319/e	
- pasiv i gjyqtarit, prokurorit etj	319/ç	
<b>Korruptim</b>		
- për të dëshmuar	312	
<b>Krijim</b>		
- i partive antikushtetuese	224	
- i turmave të armatosura	233	
- i bandës së armatosur	333	
- i skemave mashtruese lidhur me tatimin mbi vlerën e shtuar		144/a
<b>Krime</b>		
- kundër njerëzimit	74	
- të luftës	75	
- moskallëzim	300	
- përkrahje autorësh	302	

## Kryengritje

- kuptimi	221	
<b>Kryerje</b>		
- e veprës penale në gjendje të dehur	18	
- e funksionit pas dhënies fund të tij		249
- e veprimeve arbitrare	250	
- e krimeve nga banda	224	
<b>Kufi</b>		
- kalimi i paligjshëm	297	
- dhënie ndihme	298	
<b>Kultivim</b>		
- i bimëve narkotike	284	
<b>Kundërshtim</b>		
- i punonjësit shtetëror	235	
- i punonjësit të policisë		236
- i gjyqtarit	316	
<b>Kuptim</b>		
- i tentativës	22	
- i bashkëpunimit	25	
- L -		
<b>Largim</b>		
- nga vendi i aksidentit	273	
- i të burgosurit		323
<b>Legjislacioni penal</b>		
- bazat	1/a	
- detyrat	1/b	
- parimet	1/c	
- zbatimi për shtetas të huaj	7, 7/a, 9, 9/a	
- zbatimi për persona pa shtetësi	8	
<b>Lëndë të rrezikshme</b>		
- stërvitja për prodhimin dhe përdorimin e paligjshëm të armëve e lëndëve të tjera të rrezikshme	282/b	
<b>Ligji penal</b>		
- zbatimi	1-11	
<b>Lirim</b>		
- para kohe me kusht	64, 65	

- LL -

**Llogaritje**

- e paraburgimit 57

**Llotari**

- e palejuar 197  
- përdorim lokalesh 198

- M -

**Manifestimi**

- pengimi 261  
- i paligjshëm 262  
- me të armatosur 263

**Manipulim**

- i tregut 143/a/1  
- i çmimeve dhe përhapje e informacionit  
të rremë 143/a/3

**Marrëdhënie seksuale**

- me dhunë me të mitur 100  
- me dhunë me të mitur 14-18 vjeç 101  
- me dhunë me të rritura 102  
- homoseksuale me dhunë me të rritur  
mbrojtur 103 102/a - me të pazotë për t'u  
- me kërcënim me armë 104  
- duke shpërdoruar detyrën 105  
- me persona në gjini ose nën kujdestari 106  
- në vende publike 107  
- dhuna seksuale 107/a

**Marrëveshje**

- për dorëzim territori 210  
- për ndërhyrje të armatosur 212

**Marrje**

- e padrejtë e fëmijës 127  
- e shpërblimeve 217  
- e mitës 260

**Masë**

- penale për personat juridik	45	
- mjekësore dhe edukuese	46	
- e vënies në provë	60	
- për të hequr dorë nga përdorimi i alkoolit ose drogës	60/a	

### **Mashtrim**

- me gënjeshtër	143/1	
- në bashkëpunim	143/2	
- ndaj disa personave	143/2	
- më se një herë	143/2	
- në skema piramidale	143/a	
- në subvencione		144
- në sigurime	145	
- në kredi	146	
- për veprat e artit	147	
- botimi i veprës së tjetrit në emër të vet	148	
- riprodhimi i padrejtë i veprës së tjetrit	149	
- kompjuterik	143/b	

### **Mbajtje**

- e lokaleve për prostitucion	15	
- e padrejtë e dy cilësive	167	- e padrejtë e uniformës
	247	
- në burg pa vendim	252	
- e pajisjeve për prodhim narkotikësh	285	

### **Mbrojtja e nevojshme**

- kuptimi	19	
-----------	----	--

### **Mënyrë**

- e vuajtjes së dënimit	35	
- e vuajtjes së dënimeve plotësuese	44	
- e caktimit të dënimit	47	

### **Mita**

- kërkim për dhënie	259	
- marrja	260	

### **Mjekim**

- i pakujdesshëm	96	
------------------	----	--

### **Mosbindje**

- ndaj urdhërit të policit	242	
----------------------------	-----	--

### **Mosdënim**

- pa ligj	2	
-----------	---	--

### **Mosdhënie**



- e ndihmës	97
- e ndihmës oga kapiteni i anijes	98
- e mjeteve për jetesë	125
<b>Moskallëzim</b>	
- i krimi	300
<b>Mosmarrje</b>	
- e masave për gjendjen e paligjshme	251
<b>Mosnjofitim</b>	
- i ndryshimit të vendimit	126
<b>Mosnjohje e ligjit</b>	
- kuptimi	4
<b>Mospagim</b>	
- i taksave	181
<b>Mosparaqitje</b>	
- e dëshmitarit, ekspertit a përkthyesit	310
<b>Mosparashkrimi i ndjekjes penale</b>	
- nuk i nënshtrohen	67
<b>Moshë</b>	
- për përgjegjësi penale	12
- N -	
<b>Narkotikë</b>	
- prodhim e shitje	283
- trafikim	283/a
- lehtësi përdorimi	283/b
- kultivimi	284
- fabrikimi	284/c
- përshtatje lokale për prodhim	285/a
- hedhje shiringash	285/b
- nxitja për përdorim	286
- përdorimi i teknologjisë	286/a
<b>Nevojë ekstreme</b>	
- kuptimi	20
<b>Ndalim</b>	

- për të drejtuar automjete	37
- për të qëndruar në njësi administrative	41
<b>Ndarje</b>	
- e veprave penale	1
<b>Ndërhyrje</b>	
- të padrejta në jetën private	121
<b>Ndërprerje</b>	
- e shtatzanisë pa pëlqimin e gruas	93
- e shtatzanisë e kryer në vende të ndaluara	94
<b>Ndërrim</b>	
- i fëmijëve	128
<b>Ndihmë</b>	
- mosdhënia	97
- nga kapiteni i anijes	98
<b>Ndotje</b>	
- e ajrit	201
- e ujërave	203
<b>Ndryshim</b>	
- në aparatet matëse	182
<b>Nxitje</b>	
- e urrejtjes ose grindjeve kombëtare	265
- për përdorim droge	286
- për gjakmarrje ose hakmarrje	83/b
<b>Nxjerrje</b>	
- jashtë territorit të Republikës	42
- Nj -	
<b>Njoftim</b>	
- i rremë në organet e rendit	272
- O -	
<b>Organe</b>	
- heqje e shitje	89/a
<b>Organizatë kriminale</b>	
- kuptimi	28/1

- krijimi, pjesëmarrja	333
<b>Organizatë terroriste</b>	
- kuptimi	28/2
- krijimi, pjesëmarrja	234/a
<b>Organizim</b>	
- i llotarive të palejuara	197
- e pjesëmarrje në grumbullime të paligjshme	262
- i grumbullimeve të paligjshme nga persona të armatosur	263
- P -	
<b>Pakujdesi</b>	
- kuptimi	16
<b>Papërgjegjshmëri</b>	
- për shkak të gjendjes mendore	17
<b>Paraburgim</b>	
- llogaritja	57
<b>Paraqitje</b>	
- e të dhënave të rreme dhe shpërndarje e paautorizuar e tyre	143/a/4
<b>Parashkrim</b>	
- i ndjekjes penale	66
- i ekzekutimit të dënimit	68
<b>Peshkim</b>	
- i ndaluar	204
<b>Pengim</b>	
- i fshehtësisë së korrespondencës	123
- i veprimtarive të organizatave fetare	131
- i ceremonive fetare	133
- me dhunë i veprimtarive të partive politike	269
- shkelja e fshehtësisë së korrespondencës	255
- në ushtrimin e të drejtës për t'u shprehur	261
- i qarkullimit të mjeteve të transportit	293
- për ekzekutimin e vendimeve të gjykatës	320
- i subjekteve për zgjedhjet në organet përfaqësuese	325

**Pezullim**

- i ekzekutimit të vendimit me burgim dhe vënia në provë 59
- i detyrimit për kryerje të një pune 63

**Përdorim**

- me keqdashje i thirrjeve telefonike 275
- pa të drejtë i emblemës së Kruqit të Kuq 276
- i dhunës gjatë hetimeve 314

**Përfitim**

- i paligjshëm i interesave 257

**Përgjegjësi**

- për personat e huaj që gëzojnë imunitet 9/a
- mosha 12
- për tentativën 23
- e bashkëpunëtorëve 27

**Përhapje**

- e sekreteve vetjake 122
- e informatave të rreme që ngjallin panik 267

**Përvajtje**

- i të miturit nga dënimi 52
- ose ulja e dënimit për bashkëpunëtorët e drejtësisë dhe viktimat 52/a

**Përkrahje**

- e autorit të krimit 302

**Përkthim**

- i rremë 308

**Përpilim**

- i deklaratave të rreme 163

**Përvetësim**

- i titullit apo detyrës shtetërore 246
- i parave ose mallrave të vjedhura 287/b

**Plagosje**

- e rëndë me dashje 88
- e rëndë në tronditje psikike 88/a
- e rëndë në kapërcim të mbrojtjes së nevojshme 88/b
- e lehtë me dashje 89
- e rëndë nga pakujdesia 91
- e lehtë nga pakujdesia 92

<b>Pornografi</b>	
- prodhimi, shpërndarja dhe shitja	117
<b>Poshtërim</b>	
- i Republikës dhe simboleve të saj	268
<b>Pranim</b>	
- i pagimit të gjobës	54
<b>Prerje</b>	
- e paligjshme e pyjeve	205
- e drurëve dekorativë dhe frutorë	206
<b>Prishje</b>	
- e qetësisë publike	274
- e vulave dhe shenjave	322
- e shenjave të bllokimit apo pezullimit të veprimtarisë tregtare	182/a
<b>Prodhim</b>	
- i mjeteve për falsifikim	185
- i mjeteve për falsifikim të dokumenteve	192
- i armëve luftarake	234
- dhe mbajtja e armëve luftarake	278
- dhe mbajtja e armëve të ftohta	279
- dhe mbajtja e armëve të gjuetisë	280
- dhe shitja e narkotikëve	283
- dhe shitja e ushqimeve dhe lëndëve të rrezikshme për shëndetin	288
<b>Propozim</b>	
- për shpërblim	244
<b>Prostitucion</b>	
- ushtrimi	113
- shfrytëzimi	114
- mbajtja e lokaleve	115
<b>Provokim</b>	
- i luftës	211
<b>Publikim</b>	
- i vendimit gjyqësor	43
<b>Punësim</b>	
- i paligjshëm	170/a

- R -

**Rebelim**

- i të burgosurve 270

**Refuzim**

- për të dëshmuar 307

**Rehabilitim**

- kuptimi 69

**Rekrutimi**

- i personave për kryerjen e veprave  
me qëllime terroriste ose të financimit  
të terrorizmit 231

**Riprodhim**

- pa të drejtë i veprës së tjetrit 149

**Ruajtje**

- apo depozitim i mallrave kontrabandë 179

- Rr -

**Rrahje** 90

**Rrethanë**

- lehtësuese 48

- rënduese 50

**Rrëmbim**

- i personit 109

- në rrethana lehtësuese 109/a

- i armëve, anijeve dhe mjeteve të tjera 111

- zhdukja me force 109/c

- S -

**Sigurim**

- i kushteve dhe mjeteve për vrasje 81

- i kushteve dhe mjeteve për vjedhje 102

- i informatave 214

- i mjeteve për shkatërrim 216

**Sigurime shoqërore**

- dhënia në kundërshtim me ligjin e pensioneve  
ose e të ardhurave të tjera 248/a

### **Stërvitja**

- për kryerjen e veprave me qëllime  
terroriste 232

- për prodhimin dhe përdorimin  
e paligjshëm të armëve e lëndëve  
të tjera të rrezikshme 282/b

- SH -

### **Shkaktim**

- i vetvrasjes 99

### **Shkatërrim i pronës**

- ose dëmtim i objekteve të kultit 132

- e të drejtave të pronësisë industriale 149/a

- e të drejtave të topografisë të qarkut  
të gjysmëpërçuesit 149/b

- me dashje i lehtë 150

- me zjarr 151

- me eksploziv 152

- me përmbytje 153

- me mjete të tjera 154

- i rrugëve 155

- i rrjetit elektrik 156

- i rrjetit të ujitjes 157, 158

- i rrjetit të ujësjellësit 159

- i veprave kulluese 160

- i pronës nga pakujdesia 161

- i mjeteve të transportit masiv 162

### **Shkelje**

- e detyrimeve 196

- e karantinës 207

- e barazisë së shtetasve 253

- e paprekshmërisë së banesës 254

- e barazisë së pjesëmarrësve në tendera 258

- e rregullave mbi lëndët helmuese 281

- e rregullave mbi lëndët plasëse e djegëse 282

- e rregullave të mbrojtjes në punë 289

- e rregullave të qarkullimit rrugor 290

- e disiplinës në transport 292

- e rregullave të fluturimit 299

- e fshehtësisë së votimit 327

- e së drejtës së zgjedhjes 331

- e kushteve dhe e detyrimeve gjatë kohës së provës	62
<b>Shpërblim</b>	
- propozimi	244
- dhënia	245
<b>Shpërdorim</b>	
- i kompetencave	164
- i tokës	199
- i detyrës	248
- i kontributeve	256
- i autoritetit ushtarak	332
<b>Shpërndarje</b>	
- e shkrimeve antikushtetuese	225
- shpërndarje kompjuterike e materialeve pro gjenocid ose krimeve kundër njerëzimit	74/a
- e materialeve raciste ose ksenofobike nëpërmjet sistemit kompjuterik	119/a
<b>Shpifje</b>	
- kuptimi	120
- për shkak të detyrës	240
- ndaj Presidentit të Republikës	241
<b>Shtatzania</b>	
- ndërpreje pa pëlqim	93
- ndërpreje pa autorizim	94
- dhënie mjetesh	95
<b>Shtrëngim</b>	
- ose pengim për të bashkëjetuar	130
<b>Shtytje</b>	
- e të miturve në krim	129
- T -	
<b>Territor</b>	
- i Republikës	5
- dorëzimi	208
- marrëveshja	210
<b>Terrorizëm</b>	
- financimi	230/a



<b>Tjetërsim</b>	
- i pasurisë	287
<b>Toka</b>	
- shpërdorimi	199
- pushtimi	200
<b>Torturë</b>	
- kuptimi	86
- me pasoja të rënda	87
<b>Trafikim</b>	
- i personave të rritur	110/a
- përfitimi apo përdorimi i shërbimeve të ofruar nga personat e trafikuar	110/b
- veprimet që lehtësojnë trafikimin	110/c
- mbajtje lokalesh	115
- i veprave të artit dhe të kulturës	138/a
- i mjeteve motorike	141/a
- i armëve	278/a
- i lëndëve plasëse dhe helmuese	282/a
- i narkotikëve	283/a
<b>Transportim</b>	
- i mbeturinave toksike	202
<b>Tregim</b>	
- i sekretit shtetëror nga personi i autorizuar	294
- i sekretit shtetëror nga shtetasi	295
<b>Tregtim</b>	
- i paligjshëm i titujve	143/a/7
- i mallrave që janë kontrabandë	178
- Th -	
<b>Thirrje</b>	
- për armatosje	222
- publike për veprime të dhunshme	223
- për urrejtje nacionale	266
- U-	
<b>Ulje</b>	
- e dënimit nën minimum	53

**Ushtrim**

- i një të drejte apo përmbushjeje të detyrës 21
- i profesionit të ekspertit kontabël dhe i shoqërisë audituese pa qenë i regjistruar 246/a

- V -

**Vepër**

- e turpshme 108
- ngacim seksual 108/a
- e dhunshme ndaj të huajve 226
- e dhunshme ndaj vendeve të punës 228
- me qëllime terroriste
- 230

**Vepra me qëllime terroriste**

- kuptimi 230
- rekrutimi i personave për kryerjen e veprave me qëllime terroriste ose për financimin e terrorizmit 231
- stërvitja për kryerjen 232
- nxitja, thirrja publike dhe propaganda për kryerjen 232/a
- kanosja për kryerjen 232/b

**Vepra penale**

- ndarja 1
- pastrim i produkteve 287

**Veprim**

- në kohë i ligjit penal 3
- që pengon zbulimin e së vërtetës 301
- në kundërshtim me vendimin e gjykatës 320

**Veprimtari bankare**

- ushtrimi pa licencë 170/c

**Veprimtari financiare**

- ushtrimi pa licencë 170/c

**Vetëgjyqësi**

- kuptimi 277

**Vetëvrasje**

- shkaktimi 99

**Vënie**

- në dispozicion e lokaleve	198
- në shërbim të shteteve të huaja	218

**Vjedhje**

- e thjeshtë	134/1
- në bashkëpunim	134/2
- më se një herë	134/2
- me pasoja të rënda	134/2
- duke shpërdoruar detyrën	135
- e bankave dhe arkave të kursimit	136
- e energjisë elektrike dhe impulseve telefonike	137
- e rrjetit të komunikimeve elektronike	137/a
- e veprave të artit e kulturës	138
- me dhunë	139
- me armë	140
- me pasojë vdekjeje	141
- e dokumenteve	192/a

**Votim**

- më shumë se një herë ose pa u identifikuar	127/a
--	-------

**Vrasje**

- me dashje	76
- me dashje në lidhje me një krim tjetër	77
- me paramendim	78
- në rrethana cilësuese	79
- ndaj funksionarëve publikë	79/a
- ndaj punonjësve të Policisë së Shtetit	79/b
- për shkak të marrëdhënieve familjare	79/c
- sigurim kushtesh	80
- e foshnjës	81
- në gjendje tronditjeje psikike	82
- me kapërcim të kufijve të mbrojtjes së nevojshme	83
- nga pakujdesia	85
- Z -	

**Zbatim**

- i ligjit penal për vepra të kryera nga shtetas shqiptarë	6
- i ligjit penal për vepra të kryera nga të huaj	7
- i ligjit penal për vepra të kryera nga persona pa shtetësi	8

**Zbulim**

- i sekreteve të shoqërisë
- i akteve ose të dhënave sekrete

169

295/a